

RAPORT VJETOR

2025



Përmbajtja

1. Cilët jemi ne

2. Mesazhi i Kryetarit të Këshillit Drejtues

3. Mesazhi i Drejtores së Përgjithshme Ekzekutive

4. Banka dhe Aksionarët e saj

4.1 Historiku i Union Bank

4.2 Aksionarët e Union Bank

4.3 Informacion mbi strukturën e organizimit, administrimit dhe të funksionimit të Bankës

4.4 Organet Drejtuese të Bankës

4.5 Informacion i përgjithshëm mbi Grupin e konsoliduar

5. Mjedisi makroekonomik dhe sistemi bankar në Shqipëri

5.1 Mjedisi makroekonomik i jashtëm

5.2 Mjedisi makroekonomik në vend

5.3 Sektori bankar në Shqipëri

6. Performanca në Union Bank

6.1 Treguesit kryesorë financiarë

7. Klienti në qendër të strategjisë së bankës

7.1 Klientët Individë

7.2 Klientët Biznes

8. Raporti i Produkteve dhe Shërbimeve

8.1 Produktet për Individë

8.2 Kreditë e dhëna për klientët

8.3 Kanalet Alternative

9. Zhvillimi i Operacioneve të Brendshme

10. Zhvillimi dhe Menaxhimi i Rrjetit

10.1 Roli i degëve dhe zhvillimi i prezencës fizike (Degë dhe ATM)

11. Menaxhimi i Rrezikut

12. Burimet Njerëzore, trajnimi dhe zhvillimi i stafit

12.1 Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

12.2 Rekrutimi dhe përzgjedhja e stafit

12.3 Programi i Praktikës

12.4 Trajnime dhe edukimi i mëtejshëm

12.5 Politikat e shpërblimeve

12.6 Rreziku dhe siguria në punë

13. Aktivitetet Marketing dhe Përgjegjësia Sociale

14. Planet për vitin 2026

14.1 Planet Strategjike

14.2 Planet dhe performanca financiare

15. Deklarata e Oresit /Tolerancës ndaj Rrezikut të ndërmarrë

16. Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2025

1. Cilët Jemi Ne

Misioni ynë

Union Bank është angazhuar që të jetë një institucion financiar i fortë dhe i qëndrueshëm, duke ofruar produkte lehtësisht të aksesueshme dhe të diferencuara, si dhe eksperiencë të shkëlqyer bankare për të gjithë klientët tanë.

Vizioni

Ne qëndrojmë në treg të fortë, për t'i ofruar klientëve tanë, kolegëve dhe komunitetit, mundësi për të bërë më shumë në jetë.

Vlerat tona themelore

- Çmojmë **integritetin** si organizatë dhe si individë.
- Kërkojmë të krijojmë **marrëdhënie besimi dhe respekti** me klientët tanë.
- Vlerësojmë **profesionalizmin dhe përkushtimin** e punonjësve si si asetin më të çmuar.
- Vlerësojmë **dedikimin pa kompromis** për të kuptuar dhe plotësuar nevojat financiare të klientëve tanë si dhe për të nxitur rritje të qëndrueshme.
- **Përqafojmë ndryshimin** dhe do të vazhdojmë të kërkojmë mënyra të reja për të siguruar cilësi, shërbime me kosto efektive që plotësojnë apo tejkalojnë pritshmëritë e klientëve tanë.
- Jemi të përkushtuar për të ofruar **shërbimin më të mirë të mundshëm** për klientët tanë.
- Për t'i shërbyer aksionarëve tanë dhe për të pasur mbështetjen e tyre, ne jemi të përkushtuar **për një komunikim transparent të strategjisë sonë**, qeverisje të kujdesshme dhe kthime të qëndrueshme dhe afatgjata.

Viti 2025 në pamje të shpejtë


POZICIONIM I MIRË NË TREG¹

Rritje vjetore asetesh në total prej **13.2%** i ndikuar fort nga rritja e depozitave me klientë, si burimi kryesor për fonde për bankën.

Portofoli i Kredisë me rritje **16.4%**, duke ruajtur diversifikim të mirë mes segmenteve dhe valutave, tregues i një prezence në treg me një larmishmëri ofertash për publikun në një vit të mirë për Bankën dhe të qëndrueshëm për sistemin.

Depozitat me rritje prej **11.9%**, të diversifikuara në një bazë të konsiderueshme klientësh mbi **140 mijë**.

Kapitalizim optimal, ndjeshëm përtej kërkesave rregullatore, me një Raport Mjaftueshmërie prej **17.5%**.



¹Për tu shënuar që rënia e kursit të këmbimit ka impaktuar treguesit e rritjes, pasi shtesa reale është më e lartë.



PERFORMANCA FINANCIARE STABËL

Kthimi mbi kapitalin rezulton **12.4%**, duke reflektuar një performancë të qëndrueshme në krahasim me vitin paraardhës. Ky rezultat ndikohet nga faktorë të përgjithshëm sektorialë, por edhe nga performanca e bankës në një mjedis ekonomik dhe financiar dinamik. Gjithashtu, investimet teknologjike kanë kontribuar në këto rezultate vitet e fundit.

Ky rezultat pozitiv reflektohet edhe tek kthimi mbi asetet e bankës, me një përmirësim në raport me vitin e kaluar.

Për sa i përket Raportit Kosto mbi të Ardhurat, ky raport ka shënuar një rritje në krahasim me vitin e kaluar, në linjë me investimet e vazhdueshme që Banka po kryen në drejtim të forcimit të strukturave dhe zhvillimit të kapaciteteve të saj.

Ndërkohë, aktivet për degë kanë shënuar përmirësim, në linjë me rritjen e përgjithshme të aktivitetit.



PLANET PËR 2026

Rritje të shëndetshme të portofoleve të kredive/investimeve ndërmjet kufijve **10–12%**, planifikuar po në të njëjtat nivele rritjeje edhe për fondet.

Ruajtja e një modeli biznesi fitimprurës dhe të qëndrueshëm, me fokus tek klienti, duke vijuar transformimin dhe konsoliduar zgjerimin e kanaleve alternative (ATM–POS–Mobile banking).

Parashikimi për Kthim mbi Kapitalin mbi nivelet aktuale, në linjë me zhvillimin e aktivitetit dhe investimet strategjike.

Forcim i mëtejshëm i strukturës sonë të degëve me shërbim më cilësor dhe profesional.

Investime të vazhdueshme në teknologji, të cilat do të mbështesin planet e biznesit dhe do të kontribuojnë në ruajtjen e sigurisë së të dhënave, automatizimin dhe modernizimin e operacioneve në të gjithë rrjetin e degëve.

Përtej rritjes organike, Banka vijon të vlerësojë mundësitë e zgjerimit në përputhje me dinamikën e tregut dhe zhvillimet e sektorit bankar shqiptar.

Mesazh i Kryetarit të Këshillit Drejtues



Edmond LEKA
Kryetar i Këshillit Drejtues

Të nderuar aksionerë, klientë dhe partnerë,

Viti 2025 u zhvillua në një mjedis ku sektori bankar shqiptar u përball me ndryshime të shpejta teknologjike, rritje të konkurrencës, kërkesa më të larta rregullatore dhe një proces gjithnjë e më të qartë për afrimi me standardet europiane. Në këtë kontekst, Union Bank vijoi të zhvillohet mbi baza të shëndosha, duke ruajtur stabilitetin financiar, disiplinën në administrimin e kapitalit dhe orientimin drejt krijimit të vlerës afatgjatë.

Për Këshillin Drejtues, viti 2025 konfirmoi rëndësinë e një drejtimi të balancuar: midis ambicies për rritje dhe përgjegjësisë për qëndrueshmëri; midis inovacionit dhe kontrollit; midis transformimit të nevojshëm dhe ruajtjes së besimit që përbën themelin e marrëdhënies sonë me klientët, aksionerët dhe partnerët.

Gjatë vitit, Këshilli Drejtues ka mbikëqyrur nga afër zbatimin e prioriteteve strategjike të bankës, performancën financiare, cilësinë e portofolit, projektet kryesore të transformimit dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Vëmendje e veçantë iu kushtua përdorimit eficient të kapitalit, menaxhimit të kujdesshëm të rrezikut dhe sigurimit që vendimmarrja në çdo nivel të mbetet në përputhje me objektivat afatgjata të bankës.

Në vitin 2025, Union Bank ndërmori hapa të rëndësishëm në modernizimin e platformave dhe proceseve të saj. Përfundimi i përmirësimit të platformës së bankingut online, progresi në projektet e pagesave dhe për afrimit me SEPA, avancimi i projekteve të Origjinimit të Kredive (LO) dhe Data Warehouse (DWH), si dhe investimet në sigurinë kibernetike dhe analitikën e të dhënave, përbëjnë elementë të rëndësishëm të transformimit të bankës. Këto zhvillime nuk janë qëllim në vetvete; ato synojnë të krijojnë një bankë më të shpejtë, më të sigurt, më efikase dhe më pranë klientit.

Një prioritet i rëndësishëm mbeti forcimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore të bankës. Investimet në teknologji duhet të shoqërohen me zhvillimin e aftësive, përgjegjshmërisë dhe kulturës së bashkëpunimit brenda organizatës. Për një institucion financiar, reputacioni dhe besimi nuk ndërtohen vetëm përmes rezultateve financiare, por përmes mënyrës se si merret vendimi, si menaxhohet rreziku dhe si trajtohet klienti në çdo pikë kontakti.

Rrugëtimi i Shqipërisë drejt Bashkimit European po ndryshon standardet me të cilat operojnë bankat. Kërkesat për transparencë, mbrojtje të konsumatorit, siguri të pagesave, menaxhim kapitali, raportim dhe qëndrueshmëri institucionale po rriten. Union Bank e sheh këtë zhvillim jo vetëm si detyrim rregullator, por si mundësi për të forcuar më tej qeverisjen, disiplinën, konkurrueshmërinë dhe besueshmërinë e saj afatgjatë.

Viti 2026 do të jetë një moment i veçantë në historinë e Union Bank, pasi banka feston 20-vjetorin e themelimit. Ky përvjetor është një mundësi për të vlerësuar rrugëtimin e deritanishëm, sfidat e kapërcyera dhe kontributin e bankës në mbështetjen e individëve, bizneseve dhe ekonomisë shqiptare. Por, mbi të gjitha, është një pikënisje për fazën e ardhshme: ndërtimin e një banke më të fortë, më moderne, më të orientuar nga klienti dhe më të aftë për të konkurruar në një treg që ndryshon me shpejtësi.

Në emër të Këshillit Drejtues, dëshiroj të shpreh mirënjohjen për Drejtorinë Ekzekutive, ekipin drejtues dhe të gjithë punonjësit e Union Bank për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë vitit. Falënderim i veçantë u drejtohet klientëve tanë, aksionerëve dhe partnerëve, besimi i të cilëve mbetet baza mbi të cilën ndërtojmë të ardhmen.

Jam i bindur se Union Bank do të vijojë të zhvillohet si një institucion i qëndrueshëm, i përgjegjshëm dhe i besuar, duke mbështetur rritjen ekonomike të vendit dhe duke krijuar vlerë afatgjatë për të gjitha palët e interesuara.

Edmond Leka
Kryetar i Këshillit Drejtues

Mesazh i Drejtores së Përgjithshme Ekzekutive



Flutura Veipi

Drejtores e Përgjithshme dhe Kryetare
e Drejtorisë Ekzekutive

Të nderuar aksionerë, klientë, partnerë dhe kolegë,

Viti 2025 ishte një vit që shënoi jo vetëm vazhdimësinë e rritjes së Union Bank, por edhe përshpejtimin e transformimit të saj. Në një mjedis ekonomik dhe bankar që po ndryshon me ritme të shpejta, ne vazhduam të ndërtojmë një bankë më të fortë, më moderne dhe më pranë klientëve tanë, duke ruajtur të njëjtën disiplinë në menaxhimin e rrezikut dhe të kapitalit që ka karakterizuar gjithmonë Union Bank.

Rezultatet e këtij viti konfirmojnë se strategjia jonë po jep rezultatet e pritshme. Union Bank konsolidoi më tej pozicionin e saj në treg, duke përfaqësuar rreth 5.3% të aktiveve të sistemit bankar, 6.3% të portofolit të kredive dhe rreth 4.8% të depozitave të tregut. Kthimi mbi kapitalin (ROE) prej 16.6%, mbi mesataren e sektorit, dëshmon se rritja mund të arrihet duke ruajtur njëkohësisht stabilitetin financiar, efikasitetin operacional dhe një profil të shëndetshëm rreziku.

Këto rezultate nuk janë produkt i një viti të vetëm. Ato janë rezultat i një pune të vazhdueshme për të ndërtuar marrëdhënie të forta me klientët tanë, për të mbështetur bizneset shqiptare dhe për të krijuar një organizatë që përshtatet shpejt me ndryshimet e tregut dhe të teknologjisë.

Gjatë vitit 2025 përshpejtuam një nga transformimet më të rëndësishme në historinë e bankës. Për ne, transformimi digjital nuk nënkupton thjesht implementimin e teknologjive të reja; ai nënkupton krijimin e një eksperience më të thjeshtë, më të shpejtë dhe më të sigurt për klientët tanë. Përmirësimi i platformës sonë të bankingut online, zgjerimi i shërbimeve Banking 24H, investimet në rrjetin ATM, Vivex, POS dhe E-commerce, si dhe zhvillimi i zgjidhjeve të reja si Union Change, janë pjesë e një vizioni më të gjerë për të ndërtuar një bankë ku teknologjia i shërben marrëdhënies me klientin dhe jo e zëvendëson atë.

Në të njëjtën kohë, kemi vijuar investimet në modernizimin e proceseve të brendshme, automatizimin, analitikën e të dhënave, sigurinë kibernetike dhe infrastrukturën teknologjike. Këto

investime krijojnë themelet për një organizatë më efikase, më elastike dhe më të përgatitur për kërkesat e një tregu që po evoluon drejt standardeve europiane.

Një tjetër prioritet i rëndësishëm gjatë vitit ishte forcimi i kapaciteteve tona organizative. Besoj fort se transformimi nuk realizohet vetëm përmes teknologjisë; ai realizohet mbi të gjitha nga njerëzit. Për këtë arsye kemi vijuar të investojmë në zhvillimin profesional të punonjësve tanë, në kulturën e bashkëpunimit dhe në krijimin e një organizate ku inovacioni, përgjegjësia dhe orientimi drejt klientit janë pjesë e përditshmërisë sonë.

Ndërkohë, procesi i integritit evropian po ndryshon mënyrën se si operojnë bankat shqiptare. Harmonizimi me standardet europiane, zhvillimet në fushën e pagesave, Open Banking, sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së konsumatorit nuk përbëjnë vetëm kërkesa rregullatore. Ne i shohim ato si mundësi për të rritur cilësinë e shërbimeve tona, për të forcuar besimin e klientëve dhe për të ndërtuar një bankë më konkurruese për të ardhmen.

Viti 2026 ka një domethënie të veçantë për Union Bank, pasi shënon 20-vjetorin e themelimit të saj. Dy dekada më parë filluam me ambicien për të krijuar një bankë shqiptare të qëndrueshme dhe të besueshme. Sot, falë besimit të klientëve tanë, përkushtimit të punonjësve dhe mbështetjes së aksionerëve, kemi ndërtuar një institucion me themele të forta dhe me potencial të madh zhvillimi.

Megjithatë, 20-vjetori nuk është vetëm një moment për të reflektuar mbi rrugëtimin tonë. Ai shënon fillimin e një faze të re zhvillimi. Strategjia jonë për vitet 2026–2030 synon ta pozicionojë Union Bank si një nga bankat më të besuara dhe më inovative në Shqipëri, duke kombinuar fuqinë e teknologjisë me vlerën e marrëdhënieve njerëzore, duke mbështetur rritjen e biznesit shqiptar dhe duke ofruar një përvojë bankare që është njëkohësisht moderne, e personalizuar dhe e përgjegjshme.

Në emër të Drejtorisë Ekzekutive, dëshiroj të falënderoj sinqerisht punonjësit tanë për profesionalizmin, përkushtimin dhe energjinë që sjellin çdo ditë në punën e tyre. Falënderoj gjithashtu klientët, aksionerët dhe partnerët tanë për besimin e vazhdueshëm. Besimi është aseti ynë më i vlefshëm dhe përgjegjësia jonë më e madhe.

Jam e bindur se themelet që kemi ndërtuar gjatë këtyre njëzet viteve do të na lejojnë të hyjmë në dekadën e ardhshme me më shumë ambicie, më shumë aftësi dhe një vizion të qartë për të krijuar vlerë të qëndrueshme për klientët, aksionerët, punonjësit dhe ekonominë shqiptare.

Flutura Veipi
Drejtoreshë e Përgjithshme Ekzekutive dhe Kryetare e Drejtorisë Ekzekutive

4. Banka dhe Aksionarët e saj

4.1 Historiku i Union Bank

Union Bank është licensuar nga Banka e Shqipërisë në vitin 2005 dhe, në janar të vitit 2006 hapi dyert për herë të parë. Union Bank është regjistruar si shoqëri aksionare, e cila ofron një gamë të gjerë shërbimesh bankare për individë dhe biznese në Republikën e Shqipërisë.

Në vitin 2006, Banka e nisi aktivitetin e saj me hapjen e 7 degëve në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fushë Krujë dhe Fier, duke ofruar një paketë të plotë shërbimesh për depozita, kredi dhe pagesa. Më tej, rrjeti i degëve u zgjerua edhe në Kukës, Berat, Korçë, Shkodër, Pogradec, Lezhë, Lushnjë, Laç dhe Rrogozhinë. Union Bank plotësoi portofolin e saj të produkteve dhe shërbimeve duke përfshirë kartat e debitit Maestro, kartat e kreditit Mastercard, si dhe në *platformën digjitale UB Online*.

Në vitin 2008, është shtuar në strukturën aksionare të Union Bank dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), e cila zotëroi 12.5 % të aksioneve të saj.

Në vitin 2009, rrjeti i degëve të Union Bank arriti në 30 degë dhe 39 ATM. Ky ishte edhe viti i parë, në të cilin banka realizoi fitim vjetor. Më tej, në përgjigje të rritjes së Bankës në madhësi dhe kompleksitet, si dhe për t'i dhënë fokus ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Union Bank nënshkroi në vitin 2011 marrëveshjen me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për një linjë kredie në mbështetje të SME-ve.

Për të diversifikuar aktivitetin dhe portofolin e saj, në vitin 2014, Union Bank bleu 100% të aksioneve të Landeslease sha, një kompani *leasing*.

Prej fundit të vitit 2023 e në vijim, Union Bank zotëron 81% të aksioneve të Landeslease sha.

Në vitin 2017, Union Bank u rendit ndër gjashtë bankat e para nga 16 banka në treg për rritjen e portofolit të kredive dhe ndër tre më të mirat për performancën më të mirë në vend për rritjen e fondeve. Po këtë vit, Banka përfitoi nga BERZH një linjë financimi 5 milionë Euro për Programin e Nxitjes së Tregtisë.

Viti 2018 shënoi firmosjen nga Union Bank të marrëveshjes për blerjen e 100% të aksioneve të Bankës Ndërkombëtare Tregtare (ICB). Banka vazhdoi me rritje vjetore dyshifrore të asetëve dhe në kthim kapitali. Gjithashtu, po këtë vit Union Bank firmosi me BERZH një marrëveshje për një linjë kredie, në mbështetje të zbatimit të Projektit Green Economy Financing Facility (GEFF) në Shqipëri.

Union Bank përfundoi me sukses blerjen dhe përthithjen e Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. (ICB) në vitin 2019. Me këtë përthithje pjesa e tregut për asetet mbërriti në rreth 5%. Aktivet totale të Bankës kalojnë 540 milionë Euro, me një kthim kapitali prej mbi 15.3%. Rrjeti i degëve të Bankës në këtë vit u shtua me 3 njësi të reja. Në muajin gusht 2019 filloi implementimi i *upgrade* të platformës digjitale *UB Online*.

Në vitin 2019 Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) nënshkroi marrëveshjen dalëse si aksionare e Bankës Union, e cila u kompletua në dhjetor 2021.

Në mars 2025, banka nënshkroi kontratën e blerjes së kuotave të shoqërisë AFI. Në nëntor 2025 u formatizua kalimi i kuotave të AFI në pronësi të Union Bank.

E pranishme në tregun lokal prej rreth 19 vjetësh tashmë, Union Bank ka një rritje të qëndrueshme, duke shtuar ndjeshëm prezencën tonë thuajse në gjithë Shqipërinë nëpërmjet degëve dhe agjencive tona si dhe zgjeruar gamën e produkteve dhe shërbimeve tona për të qenë sa më pranë nevojave të klientëve tanë.

4.2 Aksionarët e Bankës

Aksionarët e Union Bank dhe njëkohësisht mbështetësit kryesorë të aktivitetit të Bankës, janë një institucion financiar dhe disa sipërmarrës të suksesshëm.

Struktura e kapitalit të nënshkruar është si më poshtë:

Struktura e kapitalit	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Unioni Financiar Tiranë Sh.a (UFT)	96.46%	96.46%
Edmond Leka	1.77%	1.77%
Niko Leka	1.77%	1.77%

Më poshtë paraqiten lëvizjet në kapitalin e paguar në vitet 2024⁵ dhe 2023⁴. Në datë 27 Korrik 2022 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve miratoi zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Bankës, nëpërmjet fitimeve të akumuluar, me një shumë prej 10 Milionë Euro (kundravlehtë 1,166,000 Mijë Lekë).

	31 Dhjetor 2025		31 Dhjetor 2024	
	Nr. i aksioneve	Vlera e aksioneve	Nr. i aksioneve	Vlera e aksioneve
Gjendja në fillim të vitit	2,097,143	3,883,813	2,097,143	3,883,813
Rritja e kapitalit gjatë vitit	-	-	-	-
Kapitali i paguar	2,097,143	3,883,813	2,097,143	3,883,813

Kapitali i paguar përbëhet nga aksione të zakonshme dhe nuk ka asnjë kufizim mbi to apo dallim ndërmjet tyre.

Unioni Financiar Tiranë (UFT)

Unioni Financiar Tiranë (UFT ose “Kompania Mëmë”) është aksionari kryesor i Union Bank dhe është Institucioni Financiar Jobankar më i suksesshëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor. UFT përfaqëson Western Union në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Kroaci dhe Zvicër. UFT është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC që nga viti 1995, i cili ushtron veprimtarinë e transfertave të parave si dhe ndërmjetësimit e arkëtimeve dhe pagesave të ndryshme, atë të këmbimit valutor, atë të agentit apo këshillimit financiar, të konsulencës në fushën e biznesit dhe të administrimit, të emetimit të parasë elektronike.

“UFT” është një kompani me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS J62424002G, regjistruar në bazë të vendimit të Gjykatës Tiranë No. 9406, datë 6 Mars 1995. UFT është një institucion financiar që ushtron aktivitetin në Shqipëri dhe autoriteti mbikëqyrës i kësaj veprimtarie është Banka e Shqipërisë. Selia e UFT-së është në Rrugën “Ismail Qemali”, Nr. 32, Kati 3, Tiranë. Kapitali i UFT-së është 60 milionë Lekë.

Aksionarët e UFT kanë këtë përqindje investimi në të:

31 Dhjetor 2025

Edmond Leka	35%
Niko Leka	35%
Varuzhan Piranjani	10%
Gjergji Misha*	10%
Eduard Shima*	10%

*) aksionarë pa të drejtë vote

Edmond Leka

Z. Edmond Leka ka një eksperiencë të gjatë në aktivitete të ndryshme financiare. Ai është Kryetar i Bordit Drejtues të Unionit Financiar Tiranë (UFT) që nga marsi i vitit 1998 dhe nga viti 2006 është Kryetar i Këshillit Drejtues të Union Bank.

Z. Leka ka qenë gjithashtu Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Bankës Italo-Shqiptare nga marsi 1996 – shkurt 2002 dhe ka kryer me pare funksionet e Kryetarit të Bordit të AMC-së (Albanian Mobile Communication) 1995-1998.

Gjatë periudhës shtator 2000-2008, z. Leka ka qenë Zëvendës-President i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri. Ai është gjithashtu Kryetar i Bordit të Fondacionit Harry Fultz Institute (HFI) nga viti 2003 dhe i Fondacionit të Institutit të Teknologjisë në Tirane (TIT) nga viti

Niko Leka

Z. Niko Leka ka një eksperiencë të gjatë dhe solide në sektorin financiar, në menaxhim si dhe në aktivitetet e biznesit. Aktualisht ai është nënkryetari Bordit Drejtues i Unionit Financiar Tiranë (UFT), nga viti 2015 e në vijim, dhe ka qenë Administrator prej vitit 1996 deri në vitin 2015. Nga viti 2014 deri në 2017 ka mbajtur pozicionin e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të Landeslease.

Gjatë periudhës 1994-1995, z.Niko Leka ka qenë Drejtor i Departamentit të Kreditit Urban (institucion mikrofinancë) në Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe gjatë periudhës 1999-2002 ka qenë Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Fondit Besa (institucion financiar i mikrokredisë).

Informacion mbi filialet e Bankës

Në 22 Dhjetor 2014, Union Bank bleu 100% të aksioneve të Landeslease Sh.a. Pas marrjes së miratimeve përkatëse, në Tetor 2023, Banka rriti investimin e saj në filial duke blerë 124,434 aksione të reja në vlerën 124,434 mijë Lekë. Pas këtij transaksioni dhe ndryshimit të strukturës aksionere të filialit, më 31 Dhjetor 2023, investimet në filial arrijnë në 258,436 mijë Lekë dhe përfaqësojnë 81% të kostos së të gjitha aksioneve të Landeslease Sh. a (shih shënimin 1) (2022: 161,002 mijë Lekë ose 100%). 19% e aksioneve të filialit zotërohen nga UFT.

Më 31 Dhjetor 2023, kapitali aksionar i filialit i nënshkruar dhe i shlyer tërësisht, është 520,000 Mijë Lekë që përbëhet nga 520,000 (pesëqind e njëzet mijë) aksione me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë secili. Banka ka akorduar në total kredi për shumën 22.8 Milionë Euro filialit, duke respektuar limitet rregullatore dhe të brendshme për këtë ekspozim.

Edhe në vitin 2024, Union Bank zotëron 81% të aksioneve të filialit dhe 19% e aksioneve zotërohet nga UFT.

Landeslease Sh.a është një shoqëri anonime me NUIS K51629002M, që ushtron aktivitetin e qirasë financiare dhe është nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Selia e Landeslease është në Rrugën “Mine Peza”, Nd. 8, Nj. Ap.9, Tiranë.

Landeslease Sh.a

Landeslease Sh.a është filial i Union Bank, në të cilin Banka zotëron 81% të aksioneve në datën 31 dhjetor 2025, ndërsa 19% zotërohen nga UFT. Shoqëria operon nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë dhe ushtron aktivitetin e qirasë financiare dhe qirasë operationale, duke ofruar zgjidhje financimi për individë dhe biznese.

Filiali përfaqëson një komponent të rëndësishëm të strategjisë së Grupit për diversifikimin e produkteve financiare dhe zgjerimin e pranisë në segmentin e financimit të aktiveve, automjeteve, pajisjeve dhe investimeve të bizneseve. Gjatë vitit 2025, Landeslease vijoi aktivitetin e saj në përputhje me objektivat e zhvillimit të Grupit, me fokus në rritjen e qëndrueshme të portofolit, ruajtjen e cilësisë së aktiveve dhe forcimin e eficiencës operationale.

Në datën 31 dhjetor 2025, investimi i Bankës në Landeslease paraqitet në vlerën 460,671 mijë Lekë.

Albanian Financial Institution Sh.a. (AFI)

Gjatë vitit 2025, Union Bank realizoi një hap të rëndësishëm strategjik përmes blerjes së 100% të aksioneve të Albanian Financial Institution (“AFI”), institucion financiar jobankar i licencuar nga Banka e Shqipërisë. Miratimi rregullator për këtë transaksion u mor më 2 tetor 2025, në vijim të marrëveshjes së nënshkruar më 28 mars 2025.

AFI ushtron veprimtarinë e saj kryesisht në segmentin e mikrokredisë dhe huadhënies, si edhe në aktivitetin e qirasë financiare, duke krijuar mundësi shtesë për zgjerimin e ofertës së Grupit në segmente të specializuara të tregut.

Integrimi i këtij institucioni mbështet strategjinë e Bankës për zgjerimin e platformës së shërbimeve financiare, rritjen e pranisë në segmente me potencial zhvillimi dhe adresimin më të gjerë të nevojave të klientëve individë dhe biznese të vogla.

Pas konsolidimit të strukturave menaxheriale, operationale dhe teknologjike, pritët shfrytëzimi i mëtejshëm i potencialit të AFI si një platformë e dedikuar për zhvillimin e produkteve të reja, rritjen e aktivitetit në mikrokredi dhe forcimin e pranisë së Grupit në tregun financiar vendas.

Në datën 31 dhjetor 2025, investimi i Bankës në AFI paraqitet në vlerën 332,284 mijë Lekë.


Shoqëria	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Landeslease Sh.a (LL)	460,671	460,671
Albanian Financial Institution Sh.p.k. (AFI)	332,284	-
TOTALI	792,955	460,671

Përmbledhje: Totali i investimeve në fund të vitit 2025 arriti në 792,955 krahasuar me 460,671 në vitin 2024.

4.3 Informacion mbi strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të Bankës

Struktura Organizative e Union Bank

Union Bank operon në përputhje me parimet bazë të një menaxhimi të përgjegjshëm dhe efektiv, sipas kërkesave të Rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për parimet bazë të menaxhimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre.



4.4 Organet Drejtuese të Bankës

Qeverisja e Bankës bazohet në një strukturë të mirë përcaktuar organesh drejtuese, të cilat sigurojnë një ndarje të qartë të përgjegjësi dhe një funksionim të qëndrueshëm të aktivitetit. Në përputhje me statutin dhe kuadrin rregullator, organet kryesore drejtuese të Bankës janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve
- Këshilli Drejtues
- Komiteti i Kontrollit
- Drejtoria Ekzekutive.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

Përfaqëson organin më të lartë vendimmarrës të Bankës, përmes së cilës aksionarët ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë proporcionale me pjesëmarrjen në kapital. Ajo luan një rol thelbësor në përcaktimin e drejtimit strategjik dhe në marrjen e vendimeve kyçe që ndikojnë zhvillimin e Bankës. Në këtë kuadër, Asambleja miraton politikat dhe strategjitë kryesore, pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e performancës, si dhe vendos për çështje të rëndësishme si emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të organeve drejtuese dhe të kontrollit, shpërblimet e tyre dhe përfaqësimin e Bankës në procese ligjore, si dhe çdo çështje tjetër që përcaktohet nga ligji.

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues i Union Bank është një organ vendimmarrës, përgjegjës për përcaktimin e objektivave afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe për hartimin e strategjive dhe politikave kryesore të saj. Në të njëjtën kohë, ai mbikëqyr zbatimin e këtyre strategjive dhe politikave, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, duke siguruar një drejtim të qëndrueshëm dhe efektiv të veprimtarisë së Bankës. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Këshilli Drejtues emëron Drejtorinë Ekzekutive dhe monitoron nga afër zbatimin e politikave të Bankës, si dhe ecurinë e përgjithshme të operacioneve dhe aktivitetit të saj. Ai gjithashtu ofron mbështetje për Drejtorinë Ekzekutive përmes këshillimit strategjik dhe orientimit në vendimmarrje.

Këshilli Drejtues mblidhet rregullisht, duke zhvilluar 5 (pesë) mbledhje të planifikuara gjatë vitit, si dhe mbledhje të ndërmjetme sipas nevojës. Në këto mbledhje trajtohen çështje që lidhen me miratimin e strategjisë së përgjithshme dhe drejtimin e Bankës, vendimmarrje të rëndësishme organizative, përfshirë fushat e kreditimit dhe buxhetimit, si dhe monitorimin e ecurisë së veprimtarisë, me fokus të veçantë në performancën dhe menaxhimin e rreziqeve. Në mënyrë periodike, Këshilli shqyrton dhe miraton politikat e Bankës dhe dokumentet e tjera të kërkuara nga kuadri rregullator dhe rregulloret e brendshme. Vendimet e tij merren mbi bazën e shumicës së anëtarëve të pranishëm, ndërsa për vendime të caktuara me rëndësi të veçantë kërkohet një shumicë e cilësuar prej dy të tretash (2/3) të votave. Në rastet e konfliktit të interesit, anëtarët përkatës përjashtohen nga diskutimi dhe votimi.

Anëtarët e Këshillit Drejtues përzgjidhen me kujdes, duke siguruar një kombinim optimal të kualifikimeve, përvojës dhe ekspertizës profesionale, me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes strategjike dhe efektive. Emërimi i tyre miratohet gjithashtu nga autoritetet përkatëse rregullatore. Këshilli kryen rregullisht vlerësimin e performancës së tij dhe të strukturave drejtuese, duke garantuar përmirësim të vazhdueshëm dhe përputhshmëri me standardet më të mira të qeverisjes.

Për të rritur efikasitetin në ushtrimin e përgjegjësi, Këshilli Drejtues ka ngritur komitete të specializuara, të cilat mbështesin funksionin e tij mbikëqyrës dhe vendimmarrës. Këto përfshijnë

- Komitetin e Kontrollit,
- Komitetin e Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore,
- Komitetin e Strategjisë, dhe
- Komitetin e Rrezikut.

Gjatë vitit raportues, Këshilli Drejtues ka ushtruar funksionet e tij me një përbërje prej 9 (nëntë) anëtarësh, duke kontribuar në mënyrë aktive në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e aktivitetit të Bankës.

KËSHILLI DREJTUES



Edmond LEKA
Kryetar i Këshillit Drejtues



Niko LEKA
Zv. Kryetar i Këshillit Drejtues



Flutura VEIPI
Anëtare e Këshillit Drejtues
dhe Drejtore e Përgjithshme
Ekzekutive



Varuzhan PIRANJANI
Anëtar i Këshillit Drejtues



Henry RUSSELL
Anëtar i Këshillit Drejtues



Teuta BALETA
Anëtare e Këshillit Drejtues



Gazmend KADRIU
Anëtar i Këshillit Drejtues



Kreshnik DIBRA
Anëtar i Këshillit Drejtues



Mergim CAHANI
Anëtar i Këshillit Drejtues

Në tabelën si më poshtë, paraqitet kalendari i mbledhjeve dhe pjesëmarrjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues për vitin 2025:

Kalendari i mbledhjeve dhe pjesëmarrja në Këshillin Drejtues gjatë Vitit 2025		
Nr. & Tipi i Mbledhjeve *	Data e Mbledhjes	Nr. i anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje
Mbledhja kryesore nr.1	31.01.2025	9/9 (100%)
Mbledhje e ndermjetme Nr. 1.1	10.03.2025	9/9 (100%)
Mbledhje e ndermjetme Nr. 1.2	21.03.2025	7/9 (78%)
Mbledhja kryesore nr.2	25.04.2025	9/9 (100%)
Mbledhje e ndermjetme Nr. 2.1	30.05.2025	9/9 (100%)
Mbledhja kryesore nr.3	27.06.2025	9/9 (100%)
Mbledhje e ndermjetme Nr. 3.1	02.07.2025	9/9 (100%)
Mbledhje e ndermjetme Nr. 3.2	23.07.2025	9/9 (100%)
Mbledhja kryesore nr.4	26.09.2025	7/9 (78%)
Mbledhje e ndermjetme Nr. 3.1	13.10.2025	9/9 (100%)
Mbledhja kryesore nr.5	05.12.2025	9/9 (100%)

Këshilli Drejtues me qëllim realizimin sa më të plotë të përgjegjësisë së tij ka themeluar komitete të përhershme dhe të përkohshme, si Komitetin e Kontrollit, Komitetin e Strategjisë (i përkohshëm) dhe Komitetin e Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore.

Komiteti i Kontrollit i Union Bank përbëhet nga tre anëtarë, nga të cilët njëri është Kryetar. Anëtarësia në Komitet sipas kërkesave rregullatore është e pavarur, njëri prej tyre është ekspert i jashtëm dhe nuk është pjesë e Këshillit Drejtues të Bankës, ndërsa Kryetari i Komitetit është edhe anëtar i Këshillit Drejtues.

Përbërja e Komitetit të Kontrollit është si në vijim:

- Teuta Baleta Kryetar
- Sonila Biçaku Anëtar, ekspert i jashtëm
- Kreshnik Dibra * Anëtar

Në përbërje të Komitetit të Kontrollit mund të angazhohet është shtuar edhe “anëtar i asociuar”, në funksion të plotësimin të profilit profesional dhe planit të vijueshmërisë.

Ai është Kreshnik Dibra, njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës.

Detyrat kryesore të Komitetit të Kontrollit janë të asistojë Këshillin Drejtues në mbikëqyrjen e:

- Integritetit të raporteve financiare të Bankës;
- Përputhshmërinë e Bankës me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Procesit të përzgjedhjes dhe të performancës së audituesve të jashtëm;
- Performancës së njësisë së brendshme të auditit.

Në tabelën si më poshtë, paraqitet kalendari i mbledhjeve dhe pjesëmarrjes së anëtarëve të Komitetit të Kontrollit për vitin 2025:

Kalendari i Mbledhjeve dhe Pjesëmarrja në Komitetin e Kontrollit - 2025

Nr.	Tipi i mbledhjes	Data	Pjesëmarrja
1	Ndërmjetme nr.1.1	23.01.2025	4/4 (100%)
2	Kryesore nr.1.1	27.02.2025	4/4 (100%)
3	Kryesore nr.2 (2 sesione)	17.04.2025 & 12.05.2025	4/4 (100%)
4	Ndërmjetme nr.2.2	17.06.2025	4/4 (100%)
5	Kryesore nr.3 (2 sesione)	03.07.2025 & 24.07.2025	4/4 (100%)
6	Ndërmjetme nr.3.1	11.09.2025	4/4 (100%)
7	Kryesore nr.4	06.11.2025	4/4 (100%)
8	Kryesore nr.5	19.12.2025	4/4 (100%)

Komiteti i Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore (KSHBNJ)

Detyrat kryesore të Komitetit të Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore (KSHBNJ) është të asistojë dhe mbështesë Këshillin Drejtues të Union Bank në përgjegjësitë që Këshilli ka lidhur me çështje të Burimeve Njerëzore, të tilla si:

- Vendosijen dhe rishikimin e politikës së shpërblimeve në Union Bank në fusha si kompensimet dhe përfitimet e punonjësve;
- Politikat dhe procedurat që lidhen me punësimin dhe largimin nga puna të punonjësve në nivele të larta të Bankës;
- Shqyrtimin dhe rishikimin e zhvillimeve të rëndësishme në çështje si Kodi i Sjelljes;
- Politika që asistojnë në afrimin, mbajtjen, planet e zëvendësimit dhe zhvillimin e punonjësve të Union Bank.

Në përbërje të Komitetit të Shpërblimeve dhe Burimeve Njerëzore, sipas rregullores përkatëse, të paktën 1/3 është ekspert i jashtëm dhe të tjerët emërohen nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

Përbërja e KSHBNJ është si në vijim:

- Varuzhan Piranjani* Kryetar
- Teuta Baleta Anëtar
- Elton Çollaku Anëtar, ekspert i jashtëm

Z. E. Leka dorëhiqet nga funksioni i Kryetarit dhe Anëtarit të KRBNIJ dhe prezenca e tij është deklaruar deri më datë 25.06.2025. Z. V. Piranjani emërohet Kryetar i KSHBNJ pas dorëheqjes së z. Leka.

Komiteti i Shpërblimeve dhe Burimeve Njerëzore i Union Bank mbledhet periodikisht të paktën në 3 mbledhje kryesore në vit dhe sipas nevojës në mbledhje të ndërmjetme midis dy mbledhjeve kryesore.

Në tabelën më poshtë, paraqitet kalendari i mbledhjeve dhe pjesëmarrjes së anëtarëve të KSHBNJ për vitin 2025:

Kalendari i mbledhjeve dhe pjesëmarrja në Komitetin e Burimeve Njerëzore dhe të Remunerimit gjatë vitin 2025		
Nr. & Lloji i mbledhjeve *	Data e mbledhjes	Nr. i anëtarëve të komitetit - pjesëmarrës në mbledhje.
Mbledhja kryesore nr.1	24.02.2025	3/3 (100%)
Mbledhja e ndërmjetme 1.1	14.04.2025	3/3 (100%)
Mbledhja kryesore nr.2 (dy sesione)	16 & 23.06.2025	3/3 (100%)
Mbledhja kryesore nr.3	18.09.2025	3/3 (100%)
Mbledhja kryesore nr.4	18.11.2025	3/3 (100%)

Komiteti i Strategjisë

Komiteti ka si qëllim që të këshillojë Këshillin Drejtues ose të përgatisë vendimet e tij në lidhje me çështje ose aktivitete që bien nën këtë fushë kryesore të vendimeve strategjike. Të tilla mund të jenë:

- Rishikimi i strategjisë së Bankës;
- Ristrukturim madhor i brendshëm i Bankës;
- Mundësi blerjeje (*acquisition*);
- Planifikim i hapjes së një filiali; etj.

Komiteti Strategjik ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë duke përfshirë Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e KD-së si dhe Drejtorin e Përgjithshëm.

- Edmond Leka Kryetar
- Flutura Veipi Anëtar
- Henry Russell Anëtar
- Niko Leka Anëtar
- Gazmend Kadriu Anëtar

Në tabelën si më poshtë, paraqitet kalendari i mbledhjeve dhe pjesëmarrjes së anëtarëve të Komitetit Strategjisë për vitin 2025:

Kalendari i mbledhjeve dhe pjesëmarrja ne Komitetin e Strategjise gjate Vitit 2025*		
Nr. & Lloji i Mbledhjeve	Data e Mbledhjeve	Nr. i anetareve te komitetit - pjesmarres ne mbledhje.
Mbledhja kryesore nr.1 (dy sesione)	20.03 & 09.04.2025	5/5 (100%)
Mbledhja kryesore nr.2 (dy sesione)	25.09 & 26.09.2025	5/5 (100%)

Komiteti i Rrezikut

Komiteti i Rrezikut ka si qëllim kryesor të shqyrtojë dhe diskutojë dokumentet që lidhen me menaxhimin e rrezikut, të përgatitura nga Drejtoria Ekzekutive. Kjo tregon për rëndësinë që i jepet trajtimit të çështjeve të rrezikut, duke mundësuar një analizë më të thelluar dhe më të përqendruar sesa ajo që do të ishte e mundur në mbledhjet e zakonshme të Këshillit Drejtues. Puna e këtij komiteti zhvillohet në tri nivele:

- Fokusohet në çështjet që kërkohen drejtpërdrejt nga Këshilli Drejtues dhe që janë përcaktuar si prioritare.
- Trajton tema të tjera të lidhura me rrezikun të propozuara nga Drejtoria Ekzekutive, nëse kjo pranohet nga vetë Komiteti i Rrezikut.
- Adreson edhe çështje të tjera të lidhura me rrezikun që dalin gjatë punës së tij.

Komiteti i Rrezikut ka në përbërje kryetarin dhe 3 (tre) anëtarë:

- Gazmend Kadriu Kryetar
- Elda Demneri Anëtar
- Artiola Agalliu Anëtar

Në tabelën si më poshtë, paraqitet kalendari i mbledhjeve dhe pjesëmarrjes së anëtarëve të Komitetit Rrezikut për vitin 2025

Kalendari i mbledhjeve dhe pjesëmarrja ne Komitetin e Risk gjate Vitit 2025		
Nr. & Lloji i Mbledhjeve	Data e Mbledhjeve	Nr. i anetareve te komitetit - pjesmarres ne mbledhje.
Mbledhja kryesore nr.1*	26.08.2025	2/2 (100%)
Mbledhja kryesore nr.2	02.12.2025	3/3 (100%)

Drejtoria Ekzekutive

Drejtoria Ekzekutive (DE), është përgjegjëse për administrimin e aktivitetit të Bankës në tërësi, kontrollin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të zbatueshmërisë së kuadrit rregullativ të Bankës, ndër të cilat përfshihet standardizimi i rregulloreve dhe procedurave, administrimi i çështjeve të administrimit të rrezikut dhe të kontrollit të brendshëm në përputhje me kuadrin e brendshëm rregullativ, rregulloret e Bankës së Shqipërisë dhe praktikat më të mira.

DE organizon veprimtarinë e përditshme të Bankës, përcakton përgjegjësitë e funksioneve të Bankës si dhe të linjave të kontrollit. Po ashtu, ky funksion organizon proceset që sigurojnë identifikimin, vlerësimin e saktë të rreziqeve si dhe masat e nevojshme për administrimin e rreziqeve të Bankës.

DE përmbledh dhe propozon për miratim në Këshillin Drejtues planin, buxhetet dhe projeksionet e biznesit, të përgatitura nga njësitë përgjegjëse të Bankës, të cilat më tej do të përdoren, ndër të tjera, edhe për qëllime të planifikimit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të likuiditetit.

Gjithashtu, DE është përgjegjës për identifikimin e rreziqeve materiale dhe i komunikon rezultatet Këshillit Drejtues për aprovim, në kuadër të politikave specifike dhe Kuadrin e Oreksit të Rrezikut.

Për një monitorim më efikas, analiza më të plota, dhe strukturë vendimmarrëse më të gjerë me qëllim administrimin sa më efektiv të proceseve/aktivitetit dhe administrimin e rrezikut, DE ka krijuar komitete të veçanta që mbulojnë rreziqe individuale.

DREJTORIA EKZEKUTIVE



Flutura VEIPI

Drejtoresh e Përgjithshme
Ekzekutive dhe Kryetare e
Drejtorisë Ekzekutive



Suela BOKSHI

Drejtoresh e Divizionit të
Operacioneve dhe Anëtare e
Drejtorisë Ekzekutive



Arten ZIKAJ

Drejtor i Divizionit të Financës
dhe Anëtar i Drejtorisë
Ekzekutive



Alban BURAZERI

Drejtor i Zyrës së Transformimit
dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive

Qeverisja Korporative

Union Bank është e angazhuar të zbatojë standardet më të larta të qeverisjes së korporatës, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe sjellje etike në të gjitha veprimtaritë e saj. Ky angazhim synon të sigurojë përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbështetjen e përmbushjes së qëllimeve afatgjata në përputhje me planin strategjik dhe të biznesit të Bankës.

Praktikat e qeverisjes së Bankës bazohen në parimet e drejtimit të brendshëm dhe synojnë ndërtimin e një kulture përgjegjësie, integriteti dhe besimi të ndërsjellë ndërmjet aksionarëve, organeve drejtuese dhe menaxhimit. Këto praktika kontribuojnë në mbrojtjen e interesave të palëve të interesuara dhe në mbështetjen e arritjes së objektivave strategjike të Bankës.

Banka i kushton rëndësi të veçantë transparencës, duke siguruar që palët e interesuara të kenë akses në informacion të qartë, të saktë dhe gjithëpërfshirës në lidhje me operacionet, performancën dhe strukturat e qeverisjes. Në këtë kuadër, Banka ofron informacion të detajuar mbi performancën financiare, iniciativat strategjike dhe kuadrin e saj të qeverisjes, në përputhje me praktikrat më të mira të raportimit.

Raporti vjetor i Bankës përfshin deklaratën e oreksit ndaj rrezikut si dhe një informacion të detajuar mbi veprimtarinë dhe takimet e Këshillit Drejtues gjatë periudhës raportuese, duke synuar rritjen e transparencës dhe informimin e plotë të palëve të interesuara mbi performancën dhe qeverisjen e Bankës.

Kodi ynë i Etikës përcakton parimet e integritetit dhe ndershmërisë që udhëheqin veprimtarinë e të gjithë punonjësve dhe anëtarëve të Bordit. Ai shërben si udhërrëfyes për mënyrën se si veprimtarinë dhe marrim vendime në marrëdhëniet tona me klientët, palët e interesuara dhe brenda organizatës, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Nëpërmjet zbatimit të këtij Kodi, ne synojmë të ndërtojmë dhe të ruajmë një kulturë transparence, përgjegjshmërie dhe respekti, ku etika është pjesë integrale e çdo vendimmarrjeje.

Politikat e konfliktit të interesit synojnë të sigurojnë që të gjitha transaksionet dhe vendimmarrjet të kryhen në mënyrë transparente, të paanshme, në interesin më të mirë të Bankës dhe palëve të saj të interesuara. Banka zbaton mekanizma të qarta për identifikimin, deklarimin dhe menaxhimin e konflikteve aktuale ose të mundshme të interesit, në përputhje me kërkesat ligjore, rregullatore dhe politikat e brendshme. Banka publikon tepricat dhe veprimet me palët e lidhura me të, si pjesë e raportimit të pasqyrave financiare (Seksioni 36 më poshtë raportimi 31.12. 2025).

Ruajtja e integritetit në të gjitha operacionet mbetet një element thelbësor i qasjes sonë të qeverisjes. Banka zbaton standarde të larta etike dhe siguron që proceset e vendimmarrjes të mbështeten nga kontrole të brendshme efektive dhe praktika të mira të menaxhimit të rrezikut. Çdo çështje etike ose konflikt interesi trajtohet në kohë dhe në mënyrë transparente, me qëllim mbrojtjen e interesave të Bankës, klientëve dhe palëve të tjera të interesuara.

Llogaridhënia dhe përgjegjësia individuale janë përbërës themelorë të praktikave tona të qeverisjes dhe përforcohen në të gjitha nivelet e organizatës.

Kuadri i qeverisjes së Bankës mbështetet në një ndarje të qartë të përgjegjësive ndërmjet Këshillit Drejtues, Drejtorise Ekzekutive dhe funksioneve të kontrollit, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe mbikëqyrje efektive. Kjo ndarje është thelbësore për funksionimin optimal të kuadrit të qeverisjes së Bankës.

Këshilli Drejtues, nëpërmjet komiteteve të tij – përfshirë Komitetin e Kontrollit, Komitetin e Strategjisë dhe Komitetin e Riskut (keto dy të fundit si komitete ad-hock) – mbikëqyr performancën, realizimin e strategjisë, menaxhimin e rrezikut dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Drejtimi Ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e strategjisë dhe politikave të miratuara nga Këshilli, ndërsa funksionet e kontrollit ushtrojnë role të pavarura të monitorimit dhe raportimit, në përputhje me parimin e tre linjave të kontrollit.

Kjo mbikëqyrje mbështetet nga auditimet e rregullta të brendshme dhe të jashtme, të cilat kontribuojnë në ruajtjen dhe forcimin e standardeve të larta të qeverisjes.

Efektiviteti i Këshillit Drejtues dhe i komiteteve të tij vlerësohet çdo vit përmes proceseve të strukturuar të vetëvlerësimit dhe vlerësimeve të jashtme, në përputhje me kërkesat rregullatore, duke mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të qeverisjes.

Nëpërmjet kodit të brendshëm të drejtimit, qeverisja korporative e Bankës siguron:

- ndarje të qartë të detyrave ndërmjet strukturave që menaxhojnë rreziqet, atyre që i mbikëqyrin dhe funksioneve që ofrojnë siguri të pavarur;
- komunikim dhe raportim efektiv ndërmjet tre linjave të kontrollit, në përputhje me objektivat strategjike dhe oreksin ndaj rrezikut;
- respektimin e parimeve të drejtësisë, përgjegjësisë dhe efektivitetit, të integruara në kuadrin e qeverisjes dhe strukturën organizative të Bankës.

4.5 Informacion i përgjithshëm mbi Grupin e konsoliduar

Në strukturën e Grupit të UFT janë në përbërje edhe këto kompani të renditura më poshtë:

Unioni Financiar Prishtinë Shpk (“UFP”) UFP është një kompani me përgjegjësi të kufizuar që operon në Kosovë. Ai është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC në Kosovë dhe ushtron aktivitetin që nga 1 janari 2004. UFP është një institucion financiar që ushtron aktivitetin e transfertave të parave dhe është nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Kosovës. Selia e UFP është në Rr. Perandori Justinian IE, Qyteza Pejton, Prishtinë, Kosovë.

Unija Finansiska Skopje Doo (“UFS”) UFS është një kompani me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Republikën e Maqedonisë me vendim të Gjykatës së Shkupit Nr. 5710/03, datë 16 janar 2004. NUIS i tij është NIT4030004498497 dhe është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC në Maqedoninë e Veriut. Ai ushtron aktivitetin e transfertave të parave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe autoriteti mbikëqyrës i kësaj veprimtarie është Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut.

Selia e UFS është në Rr. Goce Dellcev, Shkup, Maqedoni e Veriut.

Union of Financial Corners (“UFC”) UFC është një institucion financiar i themeluar në 1 maj 2005 në Gjenevë, Zvicër dhe ka NUIS CHE112 349585. UFC është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC në Zvicër dhe ofron shërbimin e transfertave të parasë. Autoriteti mbikëqyrës është ARIF.


Selia e UFC është në Gjenevë, Zvicër.

Union Net Kroaci i cili u themelua më 10 Mars 2016 në Zagreb, Kroaci. UFT zotëron 100.00% të kapitalit të tij aksionar. Union Net Kroaci është Përfaqësues Kontraktual i Western Union Financial Services INC.

Paylink Sha (“Paylink”) Paylink është një kompani financiare e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer shërbimet e procesimit të kartave si dhe shërbimeve të tjera lidhur me to. NUIS i tij është L22112003M dhe ka filluar aktivitetin në Shtator 2012. Selia e Paylink sha është në Autostradën Tiranë-Durrës, km 8, Tiranë.

Auto City Sha (“Auto city”) Investimi në Auto City është bërë në 26 Dhjetor 2012. Auto City është një kompani që nuk operon në sektorin financiar dhe ka NUIS K81918006B. Selia e Auto City është në autostradën Tiranë-Durrës, km 6, Tiranë. Kjo kompani ofron shërbime për utilitete si dhe ekspozim, ambiente me qira, etj.

Landeslease sh.a. duke zotëruar 19% të aksioneve prej fundit të vitit 2023 (detaje më sipër, seksioni “Informacion mbi filialet e Bankës”).



5. Mjedisi makroekonomik dhe sistemi bankar në Shqipëri

5.1 Mjedisi makroekonomik i jashtëm²

Ekonomia botërore u karakterizua nga rritje e moderuar gjatë vitit 2025, ndërkohë që aktiviteti ekonomik global vijoi të mbështetet kryesisht nga sektori i shërbimeve dhe konsumi. Megjithatë, ritmet e rritjes ekonomike mbetën të ndryshme ndërmjet ekonomive të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim, ndërsa pasiguritë në tregjet financiare ndërkombëtare vijuan të mbeten të larta. Perspektiva ekonomike globale është ndikuar nga tensionet tregtare, konfliktet gjeopolitike dhe luhatjet në tregjet ndërkombëtare të energjisë dhe lëndëve të para. Përkeqësimi i ndjesisë në tregjet financiare globale dhe përshkallëzimi i tensioneve në tregtinë ndërkombëtare mund të ndikojnë negativisht në zinxhirët globalë të furnizimit, investimet dhe konsumin.

Normat e inflacionit në ekonomitë kryesore vijuan trajektoren rënëse gjatë pjesës më të madhe të vitit, megjithëse presionet inflacioniste mbetën të pranishme në disa sektorë të ekonomisë. Rritja e çmimeve të energjisë dhe e nënprodukteve të saj, si edhe tensionet në Lindjen e Mesme, vlerësohen të kenë potencial për të ushtruar presione të reja inflacioniste në periudhën afatmesme. Madhësia e këtij ndikimi mbetet e lidhur me kohëzgjatjen dhe intensitetin e konflikteve gjeopolitike.

Ekonomia e Eurozonës u ngadalësua gjatë periudhës, për shkak të dobësisë së aktivitetit ekonomik në vendet kryesore anëtare. Aktiviteti ekonomik u mbështet kryesisht nga konsumi dhe sektori i shërbimeve, ndërkohë që investimet private dhe eksportet vijuan të ndikohen negativisht nga dobësia e kërkesës dhe pasiguritë në mjedisin ndërkombëtar. Sipas projeksioneve të institucioneve ndërkombëtare, rritja ekonomike e Eurozonës pritet të jetë rreth 1.3% gjatë vitit 2026 dhe rreth 1.4% në vitet pasuese.

Megjithëse inflacioni në Eurozonë vijoi të bjerë gradualisht gjatë periudhës, presionet inflacioniste mbetën të pranishme, të ndikuara kryesisht nga tregu i punës, zhvillimet në çmimet e energjisë dhe efektet e vonuara të rritjeve të mëparshme të çmimeve në disa sektorë të ekonomisë. Në fund të periudhës, norma e inflacionit në Eurozonë rezultoi rreth 2.0%, ndërsa norma e papunësisë mbeti në nivele relativisht të ulëta, rreth 6.2%.

Banka Qendrore Evropiane vijoi të ndjekë një qasje të kujdesshme në drejtim të politikës monetare, duke mbetur e fokusuar në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetit financiar. Megjithëse kushtet monetare janë lehtësuar gradualisht krahasuar me periudhat e mëparshme, tregjet financiare evropiane vijnë të karakterizohen nga luhatshmëri, veçanërisht në segmentet afatgjata të tregut.

Rënia e normave të interesit është reflektuar pjesërisht në kushtet e kreditimit, por rritja e kreditimit në Eurozonë mbetet relativisht e dobët dhe poshtë pritshmërive të tregut.

Ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor vijuan të regjistrojnë rritje ekonomike pozitive gjatë periudhës, të mbështetura kryesisht nga konsumi dhe tregu i punës.

² Marrë nga Raporti i Stabilitetit Financiar 6MII2024 Seksioni 1.2.

Megjithatë, ritmet e rritjes mbeten të ndjeshme ndaj zhvillimeve në ekonominë e Eurozonës, ecurisë së inflacionit dhe pasigurive në tregjet ndërkombëtare. Në shumicën e vendeve të rajonit, sektori bankar vijon të ruajë tregues të mirë të kapitalizimit dhe likuiditetit, ndonëse rreziqet që burojnë nga mjedisi i jashtëm ekonomik dhe zhvillimet gjeopolitike mbeten të pranishme.

Perspektiva për ekonominë botërore gjatë viteve 2026–2027 mbetet përgjithësisht pozitive, por me rritje të moderuar dhe nivele të larta pasigurie. Rritja e tensioneve tregtare, përkeqësimi i ndjesisë në tregjet financiare dhe ndërprerjet në zinxhirët globalë të furnizimit mund të ndikojnë negativisht mbi tregtinë ndërkombëtare, investimet dhe konsumin. Në të njëjtën kohë, luhatjet në tregjet e energjisë dhe zhvillimet gjeopolitike mbeten ndër faktorët kryesorë të rrezikut për ekonominë globale dhe stabilitetin financiar ndërkombëtar

5.2 Mjedisi makroekonomik në vend³

Gjatë periudhës, ekonomia shqiptare vijoi të rritej me ritme pozitive, ndonëse disi më të moderuara krahasuar me periudhat paraardhëse. Në terma vjetorë, rritja ekonomike rezultoi 3.8% në tremujorin e katërt të vitit 2025. Kjo rritje vijoi të kishte një bazë relativisht të gjerë sipas sektorëve dhe u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, në formën e konsumit final dhe investimeve private. Kontributin kryesor në rritjen ekonomike e dhanë sektori i shërbimeve dhe ndërtimit, përkatësisht me rreth 1.53 pikë përqindje dhe 1.17 pikë përqindje, ndërsa sektori prodhues kontribuoi negativisht me rreth 0.43 pikë përqindje.

Nga ana e kërkesës, rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga konsumi final dhe investimet e sektorit privat. Në kahun negativ ndikoi zgjerimi i importeve të mallrave dhe shërbimeve, i shoqëruar me ngadalësimin e eksporteve. Treguesi i ndjesisë ekonomike, ndonëse vijon të qëndrojë mbi mesataren historike, shënoi rënie gjatë periudhës, i ndikuar kryesisht nga dobësimi i besimit në sektorët e ndërtimit dhe shërbimeve, si dhe nga rënia e besimit konsumator.

Tregu i punës u karakterizua nga zhvillime pozitive gjatë periudhës. Punësimi vijoi të mbetet në nivele të larta, ndërsa norma e punësimit për popullsinë 15–64 vjeç rezultoi rreth 68.9% në tremujorin e katërt të vitit 2025. Në të njëjtën kohë, norma e pjesëmarrjes në forcën e punës arriti në rreth 75.9%. Norma e papunësisë rezultoi 8.3%, duke mbetur në nivele historikisht të ulëta.

Pagat vijuan trajektoren rritëse edhe gjatë vitit 2025. Paga mesatare bruto mujore arriti në rreth 86,984 lekë, duke shënuar rritje me rreth 4.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Periudha u karakterizua nga një ecuri relativisht e qëndrueshme e inflacionit. Në fund të muajit dhjetor 2025, ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit regjistroi vlerën 2.3%, duke shënuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (2.1%) dhe rënie krahasuar me tremujorin paraardhës (2.4%). Norma mesatare vjetore e inflacionit gjatë vitit 2025 ishte rreth 2.2%, duke mbetur nën objektivin e Bankës së Shqipërisë.

³

Megjithatë, presionet inflacioniste nga ekonomia e brendshme janë shfaqur më të qëndrueshme në sajë të tregut të shtrënguar të punës dhe forcës së konsumit. Pasiguritë që burojnë nga zhvillimet në mjedisin e jashtëm ekonomik dhe tensionet gjeopolitike mbeten faktorë që mund të ndikojnë mbi ecurinë e inflacionit në periudhën në vijim.

Në pjesën më të madhe të periudhës, politika fiskale vijoi të mbetet në kahun konsolidues. Në raport me PBB-në, treguesit e qëndrueshmërisë fiskale vijuan të përmirësohen. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, në fund të vitit 2025, borxhi publik zbriti në nivelin 53% të PBB-së, duke vijuar prirjen rënëse të viteve të fundit.


Në bilancin e pagesave me jashtë, llogaria korrente paraqiti përmirësim të fortë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kryesisht si rezultat i zgjerimit të tepricës pozitive në tregtinë e shërbimeve. Në tremujorin e katërt të vitit 2025, llogaria korrente regjistroi një deficit prej rreth 250 milionë eurosh. Krahasuar me një vit më parë, pozicioni i llogarisë korrente u përmirësua me rreth 120 milionë euro, ose 33%, duke reflektuar zgjerimin e bilancit pozitiv të shërbimeve dhe përmirësimin e llogarisë së të ardhurave parësore.

Deficiti i tregtisë së mallrave u thellua me rreth 3% në terma vjetorë, si pasojë e rritjes së importeve të produkteve ushqimore dhe produkteve minerare, përfshirë energjinë elektrike. Nga ana tjetër, bilanci pozitiv i tregtisë së shërbimeve u zgjerua me rreth 9%, duke arritur në rreth 970 milionë euro. Ky përmirësim u mbështet nga zhvillimet e qëndrueshme të shërbimeve të udhëtimit, transportit dhe shërbimeve për përpunim.


Të ardhurat neto nga puna u zgjeruan ndjeshëm, duke arritur në rreth 200 milionë euro, ose rreth 21% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, llogaria e të ardhurave parësore u përmirësua ndjeshëm, duke kaluar në një bilanc pozitiv prej rreth 10 milionë eurosh, nga një deficit prej rreth 50 milionë eurosh një vit më parë. Suficiti i të ardhurave dytësore arriti në rreth 360 milionë euro, ku pjesa më e madhe përfaqësohet nga dërgesat e emigrantëve.

Llogaria kapitale rezultoi me një fluks neto dalës prej rreth 40 milionë eurosh, në kontrast me fluksin neto pozitiv prej rreth 44 milionë eurosh një vit më parë. Në të njëjtën kohë, llogaria financiare regjistroi një fluks neto hyrës prej rreth 210 milionë eurosh, dukshëm më të ulët krahasuar me rreth 570 milionë euro një vit më parë. Brenda saj, investimet e portofolit regjistruan dalje neto të konsiderueshme, të lidhura kryesisht me maturimin e Eurobondit të Qeverisë së Përgjithshme dhe rritjen e investimeve të rezidentëve jashtë vendit.

Gjatë periudhës, mjetet e rezervës valutore vijuan të mbeten në nivele të qëndrueshme, duke mbuluar rreth 7.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh. Në të njëjtën kohë, borxhi i jashtëm në raport me PBB-në vijoi prirjen rënëse, duke zbritur në rreth 38%, ndërsa struktura e tij mbetet e dominuar nga komponenti afatgjatë dhe nga monedha evropiane.



Burimi: INSTAT



Burimi: INSTAT

5.3 Sektori Bankar në Shqipëri⁴

Gjatë vitit 2025, sektori bankar shqiptar vijoi të operojë në një mjedis relativisht të qëndrueshëm makroekonomik dhe financiar, i mbështetur nga rritja ekonomike, zgjerimi i aktivitetit kreditues, rritja e depozitave dhe ruajtja e treguesve të mirë të kapitalizimit dhe likuiditetit. Zhvillimet në sektorin bankar u mbështetën gjithashtu nga vijimi i transformimit digjital, përmirësimi i infrastrukturës së pagesave dhe hyrja e Shqipërisë në zonën unike të pagesave SEPA, e cila pritet të ndikojë pozitivisht në eficiencën dhe kostot e transfertave ndërkombëtare në euro.

Brenda sistemit financiar, sektori bankar vijon të mbizotërojë me rreth 89% të totalit të aktiveve. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2025, pesha e aktiveve të sistemit financiar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto u rrit me 3.6 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 96.8%, ndërsa në terma vjetorë ky tregues u zgjerua me rreth 4.4 pikë përqindje. Në këtë rritje, sektori bankar kontribuoi me pothuaj 4 pikë përqindje. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët, por është zgjeruar lehtë gjatë periudhës, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar vijon të mbetet e lartë.

Në terma vjetorë, aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 9%, ndërsa vlera totale e aktiveve arriti në rreth 2,290 miliardë lekë në fund të vitit. Gjatë periudhës, aktivet e sektorit bankar u rritën me rreth 126 miliardë lekë. Kontributin kryesor në zgjerimin e aktiveve e dha rritja e stokut të kredisë bruto dhe investimet në titujt e qeverisë me përkatësisht rreth 112 miliardë lekë dhe 78 miliardë lekë. Këta tregues reflektojnë zgjerimin e aktivitetit bankar dhe ruajtjen e rolit dominues të sektorit bankar në sistemin financiar shqiptar.

Kredia

Aktiviteti kreditues vijoi të shfaqë rritje gjatë vitit 2025, i mbështetur nga kërkesa për financim nga bizneset dhe individët ndërkohë që rreth 1/3 e rritjes së kredisë është regjistruar në dy muajt e fundit të vitit. Në fund të vitit, stoku i kredisë bankare shënonte rreth 950 miliardë lekë nga të cilat rreth 530 miliardë lekë, ose 56% e tepricës së kredisë, janë kredi në monedhën vendase. Në terma relativë, kredia u rrit me 5.9% në krahasim me gjashtë muaj më parë dhe me 13.5% ndaj një viti më parë.

Portofolet e kredisë me rritjen më të shpejtë ishin ata të kredisë afatmesme dhe afatgjatë, kredisë për individët dhe kredisë në Lek. Kredia për individët është zgjeruar me ritme veçanërisht të shpejta gjatë periudhës dhe ndryshimi vjetor në fund të vitit 2025 arriti në 20%. Kredia në Lek u zgjerua me 16%, ajo në valutë u rrit me 11%, ndërsa ajo për bizneset u rrit me 10%. Duke korrigjuar efektin statistikor të kursit të këmbimit, i cili ishte negativ për rreth 7 miliardë lekë, rritja vjetore e kredisë në valutë do të rezultonte rreth 13%, ndërsa rritja e tepricës së kredisë do të ishte rreth 14%.

Gjate periudhës, vëllimi i kredive të ristrukturuara u rrit, ndërsa fluksi i kredive të fshira nga bilancet e bankave ishte më i ulët. Kredia e ristrukturuar gjatë pjesës së dytë të vitit 2025 ishte rreth 4 miliardë lekë ose 2% e fluksit të kredisë së re të periudhës dhe sa 12% e stokut të kredive me probleme. Portofolet e prekura nga ristrukturimi i kredisë lidhen me kreditë në lekë dhe valutë për sektorin e biznesit. Forma kryesore e ristrukturimit e kërkuar nga klientët dhe e miratuar nga bankat

⁴ Informacion i marrë nga Raporti i Stabilitetit Financiar 6MII2024 Seksioni 4.1

ishite zgjatja e afatit të maturimit. Fluksi i kredisë së ristrukturuar për këtë periudhë është më i larti që nga gjashtëmujori i dytë i vitit 2021. Gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit janë fshirë rreth 7 miliardë lekë kredi të humbura dhe rreth 85% e këtij vëllimi lidhet me kredi të marra nga bizneset.

Depozitat

Depozitat vijuan të mbeten burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar. Gjatë vitit 2025, sektori bankar regjistroi rritje të depozitave
Gjatë vitit 2025, depozitat u zgjeruan me rreth 152 miliardë lekë ose 9.1%, dhe në fund të dhjetorit ato arritën në rreth 1,840 miliardë lekë.

Depozitat në lekë u rritën me rreth 90 miliardë lekë, një rritje më e fortë se ajo e depozitave në valutë. Depozitat me afat u zgjeruan me rreth 8.1% në terma vjetorë dhe kanë vijuar të japin një kontribut të rëndësishëm në rritjen e depozitave të përgjithshme. Llogaritë rrjedhëse u rritën me 8.8% gjatë periudhës dhe me 11.2% kundrejt një viti më parë. Nëse do të korrigjohej për efektin statistikor të ndryshimit të kursit të këmbimit²⁴, rritja vjetore e depozitave të përgjithshme do të ishte 10.4% dhe ajo e depozitave në valutë do të ishte 9%.

Në rritjen vjetore të depozitave në Lekë, dhanë kontribut pozitiv rritjet e llogarive rrjedhëse dhe të depozitave me afat të individëve. Në fund të periudhës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat të individëve në monedhën Lek shënonin përkatësisht 280 dhe 370 miliardë lekë, duke qenë 17% dhe 4% më të larta sesa një vit më parë. Depozitat pa afat në Lek u zgjeruan me 8.6% ndaj periudhës dhe me 12% ndaj një viti më parë, ndërsa depozitat me afat në Lek u rritën me 3.4% gjatë periudhës dhe me 7.6% në terma vjetorë. Pothuajse i gjithë stoku prej 350 miliardë lekësh i depozitave me afat në Lek përfaqësohet nga depozitat e individëve, të cilat në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë u zgjeruan me përkatësisht 3.5% dhe 6.4%.

Pavarësisht, struktura e depozitave sipas monedhës dhe sektorëve nuk shfaqti ndryshime të rëndësishme gjatë periudhës. Rreth 54% e depozitave të klientëve vijojnë të mbahen në llogari rrjedhëse, ndërsa rreth 75% e depozitave totale i përkasin individëve. Depozitat e sektorit privat përfaqësojnë rreth 22% të totalit, ndërsa ato të sektorit publik rreth 3%.

Rezultati financiar

Gjatë vitit 2025, përfitueshmëria e sektorit bankar shënoi rënie të lehtë krahasuar me vitin 2024, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të veprimtarisë. Fitimi i akumuluar zbriti në 35.6 mld lekë (2.9% kundrejt 36.7 mld lekë), ndërsa treguesit e rentabilitetit ranë në RoA 1.6% nga 1.9% dhe RoE 16% nga 18%.

Të ardhurat neto nga interesat mbetën pothuajse të pandryshuara në rreth 76 mld lekë dhe vijuan të dominohen nga aktiviteti në Lek. Në monedhën vendase, të ardhurat neto nga interesat arritën 45 mld lekë (rreth +4 mld), ndërsa në valutë ndryshimi ishte negativ për rreth 4 mld lekë për shkak të rënies së të ardhurave dhe rritjes së shpenzimeve për interesa.

Marzhi neto nga interesat ra në 3.9% nga 4.3% një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes së aktiveve mesatare që gjenerojnë të ardhura. Paralelisht, të ardhurat jo nga interesat u rritën në 28 mld lekë (rreth +4 mld), të nxitura nga komisionet/gjobat dhe fitimet nga instrumentet financiare.

Shpenzimet e veprimtarisë u rritën në rreth 58 mld lekë (+7.3 mld), ndërsa të ardhurat arritën 104 mld lekë (+4 mld), duke e çuar raportin shpenzime/të ardhura në 56% nga 51%. Nga ana tjetër, provigjionet për kredi ishin rreth 5 mld lekë më të ulëta dhe së bashku me rimarrjet për mjete të tjera financiare dhanë kontribut pozitiv rreth 4 mld lekë në rezultat.

Rënia e lehtë e rezultatit u reflektua edhe në shpërndarjen e RoA sipas bankave: rreth 2/3 e aktiveve kishin RoA në intervalin 1–2%, ndërsa rreth 30% e aktiveve ishin te bankat me RoA 2–3% (nga rreth 40% një vit më parë).

Kapitalizimi dhe likuiditetit

Në fund të vitit 2025, kapitalizimi i sektorit bankar mbeti i mirë: raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit u rrit në 20.4%, i mbështetur kryesisht nga rritja e kapitalit rregullator.

Kapitali rregullator u rrit me rreth 20 mld lekë (+9%) në 230 mld lekë, ndërsa aktivet e peshuara me rrezik u rritën me rreth 3% në 1,140 mld lekë (84% rrezik kredie, 14% operacional, 2% tregu).

Raporti i levës financiare u rrit lehtë në 9.1%. Teprica e kapitalit pas kërkesave rregullative u ngushtua nga rreth 27 mld lekë (shtator 2025) në rreth 13 mld lekë (dhjetor 2025), nën ndikimin e rritjes së shtesës kundërciklike dhe kërkesave për MREL.





Likuiditeti mbeti i bollshëm: aktive likuide rreth 680 mld lekë (29.6% e aktiveve) dhe raport aktive likuide/detyrime afatshkurtra 43.3% (nga 41.1%); ky raport ishte rreth 55% në Lek dhe rreth 33% në valutë. Përqendrimi i aktiveve likuide në tituj të borxhit të qeverisë mbetet i lartë.

Mospërputhja aktive–pasive ndaj aktiveve mbeti rreth 5%, ndërsa hendeku negativ deri në 3 muaj u ngushtua në rreth 21% të aktiveve (nga 26%). Financimi u mbështet në depozita: raporti hua/depozita 51.5% (59.1% në Lek, 44.4% në valutë); pozicioni i hapur valutor neto ishte rreth 6.7% e kapitalit rregullator.

Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit bankar për vitet 2021-2025 (mld Lekë) ⁴

Përshkrimi i treguesit	T IV 2021	T IV 2022	T IV 2023	T IV 2024	T IV 2025	Y'25 në%
Të ardhura nga interesi	53,334	60,789	83,360	94,751	97,559	3%
Shpenzime interesi	7,363	8,775	13,871	19,184	21,777	14%
Të ardhurat neto nga interesi (1-2)	45,971	52,014	69,489	75,567	75,782	0%
Të ardhura jo nga interesi	16,184	11,815	18,592	23,942	28,006	17%
Gjoha dhe komisione të arkëtueshme	13,358	14,953	16,566	18,871	21,852	16%
Humbjet ose fitimet nga instrumentat financiarë	1,151	-4,098	423	2,371	3,653	54%
Fitimi nga pjesëmarrjet në shoqëri të lidhura	263	323	126	129	248	93%
Të ardhura të tjera	1,412	638	1,477	2,572	2,252	-12%
Të ardhurat bruto (3+4)	62,155	63,829	88,081	99,509	103,788	4%
Shpenzime jo interesi	37,450	38,535	46,595	51,063	58,390	14%
Shpenzime për personelin	12,239	13,009	15,685	17,775	20,194	14%
Shpenzime të tjera	25,211	25,526	30,910	33,288	38,196	15%
Provigjionet (neto)	1,218	1,500	3,813	4,830	3,454	-28%
Provigjionet për kreditë e humbura	841	4,091	5,721	5,570	4,997	-10%
Provigjionet për mjete të tjera financiare	377	-2,591	-1,908	-740	-1,543	108%
Të ardhurat neto (përpara zërave të jashtëzakonshëm) (5-(6+7))	23,488	23,794	37,673	43,616	41,945	-4%
Zëra të jashtëzakonshëm	-1,562	-1,357	0	0	0	0%
Taksat mbi të ardhurat	3,415	3,474	5,191	6,252	6,345	1%
Të ardhurat neto (pas zërave të jashtëzakonshëm) (8-(9+10))	21,634	21,678	32,483	37,364	35,599	-5%

Struktura e aktiv pasivit⁵ pasqyrohet në grafikët e mëposhtëm



⁵ Info i derivuar nga statistikat e publikuar nga Banka e Shqipërisë

6. Performanca në Union Bank

	ne Lek '000	ne Lek '000	ne Lek '000	ne Eur '000	ne Eur '000	Ndryshime	
	2025	2024	2023	2025	2024	2025	2024
Bilanci							
Totali i Aktiveve	121,124,963	107,044,468	99,318,486	1,234,080	1,030,463	13.2%	7.8%
Portofoli I kredise bruto	61,289,451	52,634,625	48,201,836	624,447	506,687	16.4%	9.2%
Investime ne letra me vlere	37,367,682	34,837,566	33,094,651	380,720	335,364	7.3%	5.3%
Balancat ne banka	6,610,028	7,663,842	2,499,989	67,346	73,776	-13.8%	206.6%
Detyrime ndaj klienteve	87,033,069	77,745,843	73,986,210	886,735	748,420	11.9%	5.1%
Kapitali aksionar	10,607,449	9,466,687	8,183,273	108,074	91,131	12.1%	15.7%
Pasqyra e fitim humbjes							
Te ardhurat neto nga interesat	4,261,276	3,990,082	3,456,617	43,416	38,410	6.8%	15.4%
Te ardhurat neto nga komisionet	787,746	738,442	613,863	8,026	7,109	6.7%	20.3%
Te ardhura te tjera, net	402,082	291,550	75,724	4,097	2,807	37.9%	285.0%
Fitimi operativ	5,451,104	5,020,074	4,146,204	55,539	48,326	8.6%	21.1%
Totali i shpenzimeve operacionale, perfshire dhe provigjonet	(4,009,350)	(3,478,029)	(3,193,521)	(40,849)	(33,481)	15.3%	8.9%
Fitimi neto para tatimit	1,441,754	1,542,045	952,683	14,689	14,844	-6.5%	61.9%
Statistika							
Numri i punonjesve	564	519	482			8.7%	7.7%
Numri i degeve	33	32	32			3.1%	0.0%
Numri i kredive aktive	28,757	27,898	26,797			3.1%	4.1%
Numri total i klienteve	342,356	307,241	269,868			11.4%	13.8%
Treguesit kryesore							
Kthimi ne kapital (ROE)	12.4%	15.7%	10.8%			-3.3%	4.9%
Kosto ndaj te ardhurave operative	58.9%	56.7%	56.8%			2.2%	-0.1%
Kredi, bruto ndaj depozitave	70.4%	67.7%	65.1%			2.7%	2.6%
Norma e rritjes se aktiveve	13.2%	7.8%	8.1%			5.4%	-0.3%
Norma e rritjes se detyrimeve ndaj klienteve	11.9%	5.1%	7.6%			6.9%	-2.5%
Norma e rritjes se kredise	16.4%	9.2%	10.9%			7.2%	-1.7%
Fondi i provigjoneve ndaj totalit te kredise	3.92%	4.31%	4.22%			-0.4%	0.1%
Marzhi neto nga interesat	4.04%	4.18%	4.11%			-0.1%	0.1%
Raporti i Mjafueshmerise se Kapitalit	18.05%	17.91%	16.65%			0.1%	1.3%
Aktivet per punonjes	214,761	206,251	206,055			4.1%	0.1%
Aktivet per dege	3,670,453	3,345,140	3,103,703			9.7%	7.8%

6.1 Treguesit Kryesorë Financiarë

Të gjithë treguesit financiarë të paraqitur në këtë raport janë përlogaritur mbi bazën e pasqyrave financiare të Bankës, të cilat janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), duke u trajtuar Banka si një entitet më vete.

Aktivitet

Në fund të dhjetorit 2025, totali i aktiveve të Bankës arriti në rreth 121.12 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 14.08 miliardë lekësh ose 13.2% krahasuar me fundin e vitit 2024 (rreth 107.04 miliardë lekë).


Portofoli i kredisë bruto u rrit me rreth 8.65 miliardë lekë ose 16.4% (nga rreth 52.63 miliardë lekë në fund të vitit 2024 në rreth 61.29 miliardë lekë në fund të vitit 2025). Kredia bruto përbën rreth 51% të totalit të aktiveve të Bankës.

Investimet në letra me vlerë shënuan rritje me rreth 2.53 miliardë lekë ose 7.3% (nga rreth 34.84 miliardë lekë në fund të vitit 2024 në rreth 37.37 miliardë lekë në fund të vitit 2025). Kjo kategori asetesh përbën rreth 30.9% të totalit të aktiveve të Bankës. Balancat në banka ranë me rreth 1.05 miliardë lekë ose 13.8% (nga rreth 7.66 miliardë lekë në 2024 në rreth 6.61 miliardë lekë në 2025).

Paraja dhe balancat pranë Bankës Qendrore në fund të vitit 2025 ishin 14.32 miliardë lekë dhe përbënin rreth 11.8% të totalit të aktiveve, ndërsa balancat në banka dhe institucione të tjera financiare ishin 6.61 miliardë lekë dhe përbënin rreth 5.5% të aktiveve totale. Në total, këto dy zëra përbënin rreth 17.3% të aktiveve.

Aktivitet fikse dhe të tjera (përfshirë investimin në filial, aktivitet jo-materiale, mjetet materiale, aktivitet e së drejtës së përdorimit, kolaterat e marra në zotërim, aktivitet e patundshme për investim, aktivitet e tatimit të shtyrë dhe zërat e tjerë) arritën në rreth 3.94 miliardë lekë në fund të vitit 2025, duke përbërë rreth 3.3% të aktiveve totale.

STRUKTURA E AKTIVEVE NE VITE



Detyrimet dhe Borxhi i Varur

Në fund të vitit 2025, detyrimet totale të Union Bank (pa përfshirë borxhin e varur) arritën në rreth 108.51 miliardë lekë, nga rreth 96.03 miliardë lekë në fund të vitit 2024, duke reflektuar një rritje vjetore prej rreth 13.0% ose 12.48 miliardë lekë. Së bashku me borxhin e varur, totali i detyrimeve arriti në rreth 110.52 miliardë lekë (krahasuar me rreth 97.58 miliardë lekë në fund të vitit 2024), ose një rritje prej rreth 13.3%.


Në fund të vitit 2025, detyrimet ndaj klientëve (depozitat) përbënin rreth 80.2% të totalit të detyrimeve (87.03 miliardë lekë), ndërsa detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare përbënin rreth 9.0% (9.80 miliardë lekë) dhe detyrimet ndaj Bankës Qendrore rreth 9.5% (10.30 miliardë lekë). Detyrime të tjera (përfshirë lease liability dhe detyrime të tjera) përbënin rreth 1.3% të totalit. Struktura e financimit vijon të dominohet nga depozitat e klientëve, të cilat mbeten burimi kryesor i fondeve për mbështetjen e aktivitetit të Bankës.

Në fund të vitit 2025 Banka rezulton me borxh të varur (subordinated debt) prej rreth 2.01 miliardë lekë, që përfaqëson rreth 18.9% të kapitalit aksionar (total shareholders' equity) në të njëjtën datë. Gjatë muajit qershor 2025, Banka emtoi në monedhën euro një borxh të varur në vlerën 5 milionë euro, në funksion të diversifikimit të burimeve të financimit dhe forcimit të kapitalit rregullator.

Kapitali Aksionar

Në fund të vitit 2025, kapitali aksionar u rrit me rreth 1.14 miliardë lekë, duke arritur në afro 10.61 miliardë lekë (nga rreth 9.47 miliardë lekë në fund të vitit 2024). Ky kapital përbën rreth 8.8% të aktiveve totale të Bankës.

Shënim: Banka përgatit dhe publikon në faqen web të saj edhe pasqyrat financiare të konsoliduara, të cilat përfshijnë edhe filialin e Landeslease, një kompani leasing që operon në Shqipëri, 81% në pronësi të Bankës.




Rezultatet Financiare dhe Performanca e Union Bank për vitin 2025

Fitimi i Union Bank për vitin 2025, i matur me fitimin neto pas tatimit, arriti në rreth 1.22 miliardë lekë (krahasuar me rreth 1.31 miliardë lekë në vitin 2024). Ky rezultat u mbështet nga të ardhurat operative prej rreth 5.42 miliardë lekë dhe shpenzimet totale operacionale (përfshirë provigjonet) prej rreth 3.98 miliardë lekë. Fitimi para tatimit arriti në rreth 1.44 miliardë lekë (krahasuar me rreth 1.54 miliardë lekë në vitin 2024), ndërsa tatimi mbi fitimin ishte rreth 225 milionë lekë.

Të ardhurat neto nga interesat në vitin 2025 arritën rreth 4.26 miliardë lekë, duke shënuar rritje prej rreth 6.8% krahasuar me vitin 2024 (rreth 3.99 miliardë lekë). Të ardhurat neto nga komisionet u mbyllën në nivelin e rreth 787.7 milionë lekëve, me një rritje prej rreth 6.7% krahasuar me vitin 2024 (rreth 738.4 milionë lekë). Pesha e të ardhurave neto nga komisionet ndaj totalit të të ardhurave operative ishte rreth 14.5%.

Krahasuar me vitin 2024, të ardhurat totale operative u rritën me rreth 431 milionë lekë ose 8.6%, duke arritur në rreth 5.45 miliardë lekë në vitin 2025. Ndërkohë, shpenzimet totale operacionale (përfshirë provigjonet) u rritën me rreth 531 milionë lekë ose 15.3%, duke arritur në rreth 4.01 miliardë lekë. Provigjonet (neto) ranë në rreth 3.45 miliardë lekë (nga rreth 4.83 miliardë lekë në vitin 2024), ndërsa raporti kosto/të ardhura operative u rrit në 58.9% (nga 56.7% në vitin 2024). Kthimi nga kapitali (ROE) në fund të vitit 2025 ishte 12.4% (nga 15.7% në vitin 2024), duke reflektuar rritjen më të shpejtë të shpenzimeve krahasuar me të ardhurat dhe rënien e lehtë të rezultatit para tatimit.



7. Klienti në qendër të strategjisë së bankës

Klienti qëndron në thelb të strategjisë sonë për rritje të qëndrueshme dhe pozicionimim tone afatgjate në treg. Ne besojmë se besnikëria ndërtohet përmes një përvoje të vazhdueshme, të personalizuar dhe të orientuar drejt vlerës së shtuar, ndaj çdo proces, vendimmarrje dhe nismë zhvillimi udhëhiqet nga nevojat dhe pritshmëritë e klientit.

Në këtë kuadër, të gjitha zhvillimet tona synojnë përshtatjen optimale ndaj klientit, duke balancuar qasjen në nivel segmentesh të gjera me fokusin në nën-segmente që adresojnë nevoja të veçanta. Kjo qasje na lejon të ndërtojmë produkte dhe procese të targetuara, të cilat reflektojnë më mirë sjelljet, preferencat dhe ciklin e jetës së klientëve, duke forcuar lidhjen afatgjatë dhe rritur nivelin e kënaqësisë dhe angazhimit të tyre.

7.1 Klientët Individë

Në kuadër të thellimit të qasjes ndaj klientit individ, banka vazhdon të mbajë një strukturë nën-segmentimi, e cila mundëson adresimin më të saktë të nevojave të ndryshme financiare. Krijimi i nën-segmenteve synon të përmirësojë përshtatjen e produkteve dhe shërbimeve, duke synuar një model më të targetuar dhe më të orientuar nga klienti.

Diferencimi i nën segmenteve synon të reflektoj natyrën e ndryshme të nevojave financiare dhe sjelljeve të klientëve në raport me kursimin dhe kreditimin, duke lejuar dizajnimin e ofertave dhe proceseve specifike për secilin rast. Në këtë mënyrë, banka siguron një përputhje më të mirë midis produktit dhe profilit të përdorimit të tij nga klienti.

Gjithashtu, nën-segmentimi mbështetet edhe në karakteristika të qëndrueshme si burimi i të ardhurave dhe statusi i punësimit. Një ndër segmentet kryesore është ai i klientëve pagamarrës, të cilët kanë një marrëdhënie të rregullt financiare me bankën përmes kreditimit të pagës. Ky segment merr një vëmendje të veçantë, duke reflektuar edhe rëndësinë e tij në ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme dhe afatgjatë me bankën. Për këtë kategori, janë zhvilluar oferta të dedikuara, që përfshijnë paketa të integruara produktesh, norma preferenciale dhe kushte të favorshme kreditimi, për të rritur intesitetin e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve bankare.

Paralelisht, identifikohen segmente të tjera që lidhen me forma të ndryshme punësimi apo vetëpunësimi, si dhe individë që gjenerojnë të ardhura nga aktiviteti tregtar, të cilët paraqesin nevoja të veçanta në përdorimin e produkteve bankare.

Në vijim, banka adreson edhe segmentimin sipas ciklit të jetës së klientit, duke identifikuar grupe si fëmijët, të rinjtë dhe pensionistët, secili me kërkesa dhe sjellje financiare të dallueshme. Po ashtu, një fokus i veçantë i kushtohet klientëve emigrantë, të cilët përbëjnë një kategori me karakteristika specifike në drejtim të flukseve financiare dhe përdorimit të shërbimeve bankare.

Banka kushton vëmendje të veçantë për grupet me nevoja bazë financiare, si pjesë e angazhimit të saj për të zgjeruar përfshirjen financiare dhe për të ofruar akses më të gjerë në shërbimet bankare, në përputhje edhe me kuadrin rregullator në fuqi.

Në funksion të përmirësimit të përvojës së klientit dhe rritjes së efikasitetit në ofrimin e shërbimeve, gjatë vitit 2025 banka filloi diferencimin e modelit të shërbimit: Mass Banking dhe Personal Banking. Ky model shërbimi mundëson diferencimin, ofertave dhe kanaleve të komunikimit, duke reflektuar më mirë nevojat, sjelljet financiare dhe potencialin e secilit grup klientësh. Përmes kësaj qasjeje, banka synon të balancojë standardizimin dhe shkallëzueshmërinë me personalizimin dhe vlerën e shtuar, duke forcuar marrëdhëniet me klientët dhe duke optimizuar përdorimin e kapaciteteve të saj operacionale.

Personal Banking karakterizohet nga një nivel i lartë ndërveprimi dhe një qasje e dedikuar ndaj klientit. Shërbimi ofrohet përmes bankierëve personalë, të fokusuar në këshillim të specializuar, ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata dhe ofrimin e zgjidhjeve të personalizuara. Bankieret personale kryejnë një menaxhim proaktiv të kërkesave dhe një përvojë të diferencuar. Komunikimi realizohet në mënyrë të targetuar dhe të personalizuar, në përputhje me preferencat dhe profilin individual të çdo klienti.

Në kontrast, **Mass Banking** mbështetet në një model shërbimi të standardizuar, i konceptuar për të adresuar një bazë më të gjerë klientësh në mënyrë efikase dhe të shkallëzueshme. Ndërveprimi realizohet kryesisht përmes rrjetit të degëve dhe Qendren e Kontaktit. Komunikimi realizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me klientin, ndërsa ofertimi dhe dizajnimi i udhëtimit të klientit mbështeten në modele të bazuara në persona dhe nën-segmente, duke reflektuar në mënyrë të strukturuar nevojat dhe sjelljet e përbashkëta të këtij segmenti.

Klienti në Qendër të Çdo Vendimmarrjeje

Gjatë vitit 2025, Union Bank ka konsoliduar më tej vizionin e saj për të funksionuar si një institucion i ndërtuar rreth klientit, ku nevojat, pritshmëritë dhe përvoja e tij janë pika e nisjes për çdo proces, kanal apo produkt të ri. Qasja jonë ka evoluar nga përmirësime të izoluara drejt një modeli të integruar pune, ku vendimmarrja mbështetet në të dhëna, analiza të thelluara dhe ku zëri i klientit është pjesë aktive e zhvillimit të bankës.

Ndërtimi dhe rishikimi i proceseve, kanaleve të shërbimit dhe produkteve nuk bëhet më vetëm nga këndvështrimi operativ, por duke u fokusuar tek mënyra se si klientët i përdorin dhe i përjetojnë ato në praktikë. Për këtë qëllim, gjatë gjithë vitit kemi përdorur anketa të strukturuar, analiza të sjelljes së klientëve, si dhe të dhëna të mbledhura nga ndërveprimet e përditshme në të gjitha pikat e kontaktit me bankën.

Matja e përvojës së klientit ka qenë një element thelbësor i këtij vizioni. Përmes treguesve kryesorë si NPS (Net Promoter Score), kemi vlerësuar nivelin e besnikërisë dhe gatishmërinë e klientëve për të rekomanduar Union Bank. Gjatë vitit 2024, NPS është ruajtur në nivele të kënaqshme dhe konkurruese krahasuar me benchmark-un e tregut, duke reflektuar një marrëdhënie në rritje besimi mes bankës dhe klientëve të saj.

Paralelisht, CSAT (Customer Satisfaction Score) është përdorur për të matur kënaqësinë e klientëve në eksperiencat specifike, të lidhura me procese dhe shërbime të veçanta si funksionalitetet e kanaleve digjitale, hapja e llogarive, shërbimi ndaj klientit dhe ndërveprimet në degë. Kjo qasje na ka mundësuar të identifikojmë me saktësi pikat që funksionojnë mirë dhe ato që kërkojnë përmirësim të menjëhershëm.

Një fokus i veçantë i këtij viti ka qenë edhe analiza e arsyeve të largimit të klientëve, me qëllim ndërtimin e një cikli të plotë feedback-u që na ndihmon të ndërhyjmë në kohë dhe të adresojmë problematika strukturore, jo vetëm simptoma momentale.

Menaxhimi i ankesave ka kaluar gjithashtu në një fazë më të matur dhe strategjike. Ankesat nuk trajtohen më thjesht si raste që duhet të zgjidhen, por si burim i vlefshëm mësimi. Çdo ankesë analizohet në thellësi për të identifikuar shkakun rrënjësor dhe shërben si input për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve, produkteve dhe mënyrës së komunikimit me klientët.

Në thelb, ajo që Union Bank ka ndërtuar gjatë vitit 2025 është një kulturë organizative e orientuar nga klienti, ku përvoja e tij nuk është përgjegjësi e një funksioni të vetëm, por një angazhim i përbashkët në të gjithë bankën. Kjo kulturë përbën bazën mbi të cilën do të vazhdojmë të zhvillojmë shërbime më të thjeshta, më intuitive dhe më të përshtatura me nevojat reale të klientëve tanë.

7.2 Klientë Biznes

Bizneset në një mjedis në ndryshim – Partner për jetën, jo vetëm për momentin

Viti 2025 shënoi një periudhë transformimi dhe sfidash të shtuara për bizneset shqiptare, të karakterizuar nga presioni mbi kostot, nevoja për eficiencë më të lartë, digjitalizim të përsheptuar dhe përshtatje ndaj standardeve të reja të qëndrueshmërisë. Në këtë kontekst, Union Bank ka forcuar pozicionimin e saj si një partner aktiv për bizneset, duke mbështetur jo vetëm nevojat e momentit, por edhe rritjen dhe zhvillimin e tyre afatgjatë.

Në Union Bank, ndërtimi i partneriteteve solide me klientët biznes është më shumë se një prioritet strategjik – është një filozofi pune që udhëheq veprimtarinë tonë të përditshme. Ne besojmë se marrëdhëniet e qëndrueshme ndërtohen mbi besim, kuptim të thellë të nevojave të klientit dhe angazhim real për të qenë pranë tij në çdo fazë të zhvillimit. Për këtë arsye, roli ynë shkon përtej ofrimit të shërbimeve bankare tradicionale.

Nga ofrues shërbimesh në partner strategjik – “Partner for life”

Union Bank pozicionohet si këshilltar strategjik për klientët e saj biznes, duke i mbështetur ata në hartimin dhe zbatimin e planeve financiare të qëndrueshme, orientimin ndaj mundësive të tregut dhe integrimin në një ekosistem më të gjerë partnerësh dhe iniciativash zhvillimore. Në kushtet e pasigurive makroekonomike, luhatjeve të tregut dhe presionit për likuiditet të qëndrueshëm, kemi qenë më pranë klientëve tanë, duke ofruar zgjidhje financimi të strukturuar sipas nevojave reale dhe duke balancuar rritjen me menaxhimin e kujdesshëm të rrezikut.

Të qenit “Partner for life” për ne do të thotë prani e vazhdueshme, reagim i shpejtë dhe një qasje që i sheh bizneset në tërësi – financiarisht, operativisht dhe strategjikisht.

Shërbimi i shpejtë dhe Konsulencë Financiare e përshtatur sipas sektorit

Bizneset kërkojnë një bankë që i sheh përtej produktit individual financiar. Union Bank ka ndërtuar një qasje 360°, duke trajtuar klientët si një tërësi dhe duke ofruar zgjidhje të koordinuara për të gjitha nevojat kryesore të biznesit. Në sektorë si turizmi dhe agrobiznesi, ku koha dhe sezonaliteti luajnë rol kritik, shpejtësia e shërbimit është vendimtare. Gjatë vitit 2025, Union Bank ka vënë theks të veçantë në përsheptimin e proceseve dhe reagimin e menjëhershëm ndaj nevojave të klientëve, duke mundësuar vendimmarrje më të shpejtë dhe akses efikas në financim.

Ky angazhim për shërbim të shpejtë i ka lejuar bizneset të përfitojnë nga mundësitë e tregut në kohën e duhur, të menaxhojnë më mirë flukset sezonale dhe të planifikojnë aktivitetin e tyre me më shumë siguri. Qasja jonë synon të minimizojë kohën midis nevojës së klientit dhe zgjidhjes së ofruar, duke ndërtuar besim dhe duke i lejuar bizneset të fokusohen në aktivitetin e tyre kryesor.

Digjitalizimi dhe qëndrueshmëria në sektorët kryesorë

Transformimi digjital në Union Bank gjatë vitit 2025 u fokusua jo vetëm në përmirësimin e kanaleve bankare, por në ndërtimin e zgjidhjeve që i shërbejnë drejtpërdrejt operimit ditor të bizneseve.

Prezantimi i platformës së re të këmbimit të Union Bank dhe avancimi i shërbimeve të Online Banking për klientët biznes i mundësoi atyre një menaxhim më të plotë dhe në kohë reale të financave të tyre, nga pagesat dhe autorizimet, te monitorimi i flukseve dhe strukturës së kredisë

Në sektorë si prodhimi, mjeksia, agroprocesimi e turizmi, ku sezonaliteti dhe intensiteti operativ janë të lartë, zgjidhjet digjitale luajne një rol thelbësor në rritjen e efikasitetit, uljen e kostove operative dhe rritjen e kontrollit financiar. Përmes programit Go Digital, banka ka mbështetur bizneset në investime në teknologji, automatizim dhe modernizim procesesh, duke e kthyer digjitalizimin në një mjet konkret zhvillimi dhe jo thjesht në një kërkesë teknike.

Realisht, kreditimi i gjelbër dhe implementimi i parimeve ESG janë integruar në strategjinë tonë të biznesit. Investimet në energji të rinovueshme, eficiencë energjetike dhe projekte të qëndrueshme kanë kontribuar në reduktimin e emetimeve, përdorimin më efikas të burimeve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në komunitetet lokale. Bashkëpunimet me partnerë ndërkombëtarë kanë sjellë jo vetëm financim, por edhe ekspertizë teknike dhe standarde të avancuara.

8. Raporti i Produkteve dhe Shërbimeve


8.1 Produktet për Individë

Llogaria e kursimit përbën një element themelor të ofertës depozituese të bankës, e konceptuar për të kombinuar fleksibilitetin në përdorimin e fondeve me përfitimin nga interesi. Kjo kategori përfshin llogari standarde të strukturuar me norma interesi të përshkallëzuara sipas nivelit të balancës dhe monedhës, duke krijuar një mekanizëm natyror nxitjeje për rritjen e kursimeve dhe mbajtjen e fondeve në bankë.

Diversifikimi i portofolit të produkteve të kursimit reflektohet edhe në prezencën e llogarisë së kursimit për fëmijë “Filizat”, e konceptuar si një zgjidhje afatgjatë për krijimin gradual të një fondi financiar në mbështetje të të ardhmes së tyre. Kjo llogari mbështet akumulimin e qëndrueshëm të kursimeve përmes një strukture interesi të diferencuar dhe mekanizmave stimulues, duke u ofruar prindërve një instrument të dedikuar për planifikimin financiar deri në arritjen e moshës madhore.

Llogaritë e kursimit për individë kanë vijuar të ruajnë qëndrueshmërinë në kohë, si në volume ashtu edhe në numër llogarish, ndërkohë që kanë mbajtur një peshë të pandryshuar në raport me totalin e llogarive për individë (llogari rrjedhëse dhe të kursimit), duke reflektuar një përdorim të qëndrueshëm të këtij produkti në menaxhimin e likuiditetit dhe kursimeve nga klientët.

Zhvillimi i llogarive të klientëve



Depozita me afat

Oferta e depozitave e Union Bank paraqet një strukturë të diversifikuar produktesh, që adresojnë nevoja të ndryshme për kursim dhe investim, duke balancuar fleksibilitetin me përfitimin nga norma më të larta interesi.

Depozitat standarde u ofron klientëve mundësi investimi në disa monedha (LEK, EUR, USD, etj.) dhe afate të ndryshme, nga afatshkurtra deri në afatmesme. Normat e interesit janë të diferencuara sipas shumës së investuar dhe afatit, çka krijon një strukturë të qartë incentivash për klientët që synojnë të rrisin nivelin e kursimeve apo të zgjedhin periudha më të gjata investimi.

Paralelisht, banka ofron depozita speciale me afate më të gjata dhe norma më konkurruese interesi, të cilat synojnë klientët me horizonte më të qëndrueshme financiare dhe me kapacitete më të larta

kursimi. Këto produkte janë të strukturuar për të maksimizuar përfitimin nga interesi, duke reflektuar një orientim drejt planeve të kursimit afatgjatë.


Depozitat me afat vijojnë të mbeten forma më e preferuar e kursimit nga individët, duke shënuar një rritje vjetore si në numër (+8%) ashtu edhe në volum (+13%).

Gjatë vitit 2025, banka ka mbështetur këtë trend përmes promovimit aktiv të gamës së produkteve dhe organizimit të fushatave periodike, gjatë të cilave janë aplikuar norma më të larta interesi për periudha të caktuara.


Paralelisht, janë incentivuar kanalet dixhitale përmes kushteve më të favorshme për depozitat e çelura online, si dhe janë ofruar norma preferenciale për segmente të veçanta klientësh, duke reflektuar një qasje të targetuar dhe dinamike në zhvillimin e produkteve të depozitave.



Struktura e detyrimeve ndaj klientëve 2025



Struktura e detyrimeve ndaj klientëve 2024



8.2 Kreditë e dhëna për klientët

Oferta e kredive për individë është konceptuar për t'u përshtatur jo vetëm me nevojat financiare të klientëve, por edhe me mënyrën se si ata ndërveprojnë me bankën nëpërmjet kanaleve dhe pikave të kontaktit. Gama e produkteve kreditore për individët përfshin zgjidhje të ndryshme financimi me fleksibilitet në shumat, afatet dhe kushtet e shlyerjes, ndërkohë që normat e interesit dhe parametrat e financimit diferencohen sipas profilit të riskut dhe karakteristikave individuale të çdo klienti, duke mundësuar një qasje më të personalizuar dhe të përshtatur financimi.

Në përputhje me kërkesat e tregut dhe nevojat e segmenteve të dedikuara të klientëve, banka ka përditësuar disa nga format e financimit konsumator, duke rritur limitet e financimit dhe zgjatur afatet e shlyerjes, me qëllim përmirësimin e aksesit në financim dhe përshtatjen më të mirë të kësteve me kapacitetin pagues të klientëve.

Duke synuar forcimin e marrëdhënieve me klientët me profil të qëndrueshëm financiar, si dhe rritjen e besnikërisë dhe angazhimit afatgjatë, gjatë vitit 2025 banka rishikoi një nga format e financimit konsumator, duke zgjeruar limitet e financimit dhe afatet e shlyerjes, me qëllim ofrimin e zgjidhjeve më fleksibile dhe më të përshtatura për këto segmente klientësh.

Mbështetja e grave, vajzave dhe mësuesve është tashmë një traditë e konsoliduar për bankën, e materializuar çdo vit gjatë muajit mars përmes fushatave të dedikuara dhe ofertave të personalizuara në produktet e financimit konsumator.

Banka vijoi bashkëpunimin me kompanitë kryesore të ndërtimit në vend, duke mundësuar akses të lehtësuar në financim për klientët që kërkojnë të investojnë në pasuri të paluajtshme, edhe në faza të hershme të zhvillimit të projekteve. Paralelisht, Banka punoi në identifikimin e mundësive të reja për partneritete strategjike, si dhe në formalizimin dhe standardizimin e procedurave në këtë drejtim, me qëllim përmirësimin e koordinimit me partnerët dhe unifikimin e mënyrës së trajtimit të aplikimeve. Kjo qasje ndihmon në qartësimin e hapave të financimit dhe në lehtësimin e procesit për klientët që kërkojnë të blejnë pasuri të paluajtshme.



Union Bank vijoi bashkëpunimin me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) në kuadër të programit GEF, duke mundësuar që kreditë e individëve të përfshihen në këtë program kur investimet e tyre lidhen me përmirësimin e eficiencës së energjisë. Kjo u jep klientëve mundësinë që, përveçse të financojnë nevojat e tyre, të bëjnë edhe zgjedhje më të mençura për të ardhmen, si ulja e shpenzimeve mujore për energjinë, përmirësimi i kushteve të jetesës dhe rritja e vlerës së banesës së tyre. Përmes këtij bashkëpunimi, Banka synon të jetë më pranë klientëve jo vetëm duke i mbështetur financiarisht, por edhe duke i orientuar drejt investimeve që kanë ndikim pozitiv dhe afatgjatë në jetën e tyre dhe në mjedis

Gjatë vitit 2025, volumet e kredisë hipotekare vijon të përbëjë pjesën dominante të portofolit të financimeve për individë, duke zënë rreth **75%** të totalit të kredive konsumatore dhe hipotekore. Kredia hipotekare ka shënuar një rritje prej **17%** krahasuar me vitin e kaluar, duke reflektuar interesin e qëndrueshëm të klientëve për financime afatgjata. Paralelisht, kredia konsumatore ka regjistruar gjithashtu një rritje prej **11%**, duke dëshmuar një kërkesë në rritje për financime më fleksibile që adresojnë nevojat e përditshme të klientëve.

Cilësia e portofolit


Bazuar në rezultatet të cilat janë të paraqitura në grafike, risku kreditor i bankës gjatë periudhës raportuese karakterizohet nga një rritje e qëndrueshme e portofolit të kredive, e shoqëruar me përmirësim gradual të cilësisë së aktiveve. Portofoli total ka ndjekur një trajektore rritëse nga rreth 270 milionë në fund të vitit 2020 në mbi 630 milionë në fund të vitit 2025, duke reflektuar zgjerimin e aktivitetit kreditues.

Paralelisht, niveli i kredive me probleme (NPL) ka shënuar rënie të ndjeshme në rreth 4.5% në vitin 2025, duke dëshmuar përmirësimin e proceseve të menaxhimit të riskut, rikuperimeve dhe seleksionimit të klientëve. Gjatë viteve të fundit, raporti i NPL ka mbetur relativisht i qëndrueshëm në intervalin 5–6%, me një tendencë lehtë zbritëse në fund të periudhës.



Nga ana strukturore, portofoli vijon të dominohet nga kreditë në valutë, megjithëse vihet re një rritje progresive e kreditimit në lekë, çka kontribuon në uljen e ekspozimit ndaj riskut valutor. Në tërësi, këto zhvillime tregojnë një profil risku të përmirësuar dhe një menaxhim më të balancuar midis rritjes së portofolit dhe cilësisë së tij.

Struktura valutore e kredisë dhënë klienteve



Produktet e kartave

Në kuadër të përparësive strategjike për rritjen e cilësisë së përvojës së klientit, Union Bank vazhdon të jete e konsoliduar në portofolin e produkteve të kartave. Këto produkte janë pozicionuar gjithnjë e më tepër si instrumente thelbësore për menaxhimin e përditshëm financiar dhe për përmbushjen e nevojave të ndryshme të klientëve.

Akses 24/7 në fonde përmes ATM-ve dhe POS-eve, blerje online të sigurta, si dhe monitorim në kohë reale i shpenzimeve përmes aplikacionit digjital, janë shoqëruar me programe shpërblyese dhe oferta të personalizuar, duke nxitur zhvendosjen graduale nga përdorimi i parasë fizike drejt instrumenteve elektronike të pagesave. Paralelisht, Banka ka intensifikuar përpjekjet për edukimin financiar dhe digjital të klientëve, duke promovuar përdorimin e sigurt dhe efikas të kartave përmes komunikimeve informuese, fushatave ndërgjegjësuese dhe mbështetjes së vazhdueshme. Këto iniciativa kontribuojnë jo vetëm në rritjen e përdorimit të produkteve të kartave, por edhe në forcimin e besimit të klientëve ndaj shërbimeve bankare digjitale.

Informimi dhe edukimi financiar i të rinjve për përdorimin e instrumenteve bankare në përditshmëri vijon të mbetet një shtyllë e strategjisë së Bankës ndër vite. Në këtë kuadër, produkte si karta Debit Junior për fëmijët dhe Karta Financiare 2 në 1, e zhvilluar në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, përfaqësojnë iniciativa të vazhdueshme që synojnë të nxisin adoptimin e hershëm të praktikave moderne të pagesave.

Gjatë vitit 2025, portofoli i kartave ka shënuar një rritje prej 11% krahasuar me vitin paraardhës, duke reflektuar zgjerimin e qëndrueshëm të përdorimit të instrumenteve digjitale për pagesa dhe menaxhim fondesh. Ky trend është shoqëruar me një intensifikim të aktivitetit transaksional. Në kete linjë, numri i transaksioneve është rritur me 24%, ndërsa volumi total i tyre ka shënuar një rritje prej 23% krahasuar me vitin 2024, duke konfirmuar një dinamikë pozitive në adoptimin dhe përdorimin aktiv të produkteve të kartave.

Si një bankë e orientuar drejt zhvillimeve digjitale dhe ofrimit të shërbimeve të sigurta dhe efikase, Union Bank do të vijojë të ndërtojë mbi këto iniciativa të konsoliduara, duke zhvilluar më tej projekte që adresojnë nevojat në zhvillim të klientëve. Në këtë drejtim, mbetet prioritet stimulimi i përdorimit të kartave si instrument kryesor pagese, si dhe rritja e përfshirjes financiare në mënyrë të qëndrueshme.


8.3 Kanalet Alternative

Rrjeti i ATM-ve

Në fund të 2025 Union Bank kishte në dispozicion të klientëve një flotë prej 71 ATM në të gjithë vendin, 39 nga këto me funksion shtesë të depozitimit të fondeve. 40 ATM janë të vendosura në degë dhe 31 ATM jashtë dege duke rritur mbulimin gjeografik.

Në vijim të strategjisë për digjitalizimin e veprimeve të klientëve, për gjithë 2025, 74% e transaksioneve paratë klientëve në monedhën Lek dhe Euro, u kryen në rrjetin e ATM.

Shërbimi në ATM mundësohet për të gjitha kartat e lëshuara ndërkombëtarisht nën markat Mastercard dhe Visa. Banka nëpërmjet komunikimit të targetuar të klientëve si dhe nëpërmjet stafit të degëve është angazhuar në edukim intensiv të klientëve për të kanalizuar transaksionet paranë këtë kanal.



Një eksperiencë e re digjitale

Në shtator 2025, Union Bank shënoi një moment të rëndësishëm në rrugëtimin e saj digjital me prezantimin e platformës së re të përmirësuar të Online Banking, e konceptuar dhe ndërtuar mbi parimin “klienti në qendër”. Kjo platformë e re përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një eksperience bankare më intuitive, më të thjeshtë vizualisht dhe më funksionale, duke reflektuar nevojat reale të klientëve tanë dhe mënyrën se si ata ndërveprojnë me shërbimet bankare në përditshmëri. Platforma erë vjen me një përvojë përdorimi dhe një ndërfaqe të rikonceptuar, të ndërtuara për të ofruar kërkim dhe eksplorim më të thjeshtë, vizualisht më të qartë dhe funksionalitet më të avancuar.

Informacioni është i strukturuar në mënyrë të kuptueshme dhe çdo veprim është ndërtuar me më pak hapa. Platforma e re ka funksionalitete të zgjeruara, duke e bërë përdorimin e shërbimeve bankare digjitale më të shpejtë, më efikas dhe më të këndshëm për përdoruesit.

Një tjetër risi e rëndësishme e vitit 2025 është ndarja e qartë e shërbimeve digjitale në dy aplikacione të ndërtuara posaçërisht për dy segmentet kryesore të bankës: klientët individë dhe klientët biznes.

Union Bank Live – për klientët individë

Union Bank Live është aplikacioni i ri bankar për individë, i ndërtuar për të ofruar kontroll të plotë mbi financat personale, në çdo moment dhe nga kudo. Klientët kanë në dispozicion një pasqyrë të plotë dhe në kohë reale të llogarive të tyre, historikut të transaksioneve, detajeve të kartave dhe informacionit financiar kryesor.

Aplikacioni mundëson kryerjen e transfertave brenda dhe jashtë vendit, pagesën e faturave, energjisë elektrike dhe detyrimeve të tjera, pa pasur nevojë për vizitë fizike në degë. Përmes Union Bank Live, klientët mund të kryejnë gjithashtu pagesën e kartave, si dhe të vendosin dhe menaxhojnë limitet e përdorimit të kartave sipas nevojave dhe preferencave të tyre, duke rritur kontrollin dhe sigurinë gjatë përdorimit.

Funksionalitete shtesë si kursi ditor i këmbimit, lokalizimi i degëve dhe ATM-ve, si dhe përdorimi në gjuhën shqipe dhe angleze, e bëjnë Union Bank Live një zgjidhje të kompletuar, fleksibël dhe të përshtatur me ritmin e jetës moderne.

Union Bank Business – për klientët biznes

Union Bank Business është aplikacioni i ndërtuar për nevojat e bizneseve, duke ofruar një platformë të sigurt dhe fleksibël për menaxhimin e financave të kompanive. Aplikacioni u jep mundësi administratorëve dhe menaxherëve financiarë të monitorojnë në kohë reale gjendjen e llogarive, lëvizjet ditore, qarkullimin mujor, pagesat dhe strukturat e kredisë. Funksionalitetet përfshijnë transferta vendase dhe ndërkombëtare, autorizime hierarkike të pagesave, rishikim të detajuar të transaksioneve, si dhe krijimin e niveleve të ndryshme të përdoruesve brenda kompanisë, sipas roleve dhe përgjegjësi. Të gjitha këto ofrohen duke respektuar standardet më të larta të sigurisë bankare dhe autentifikimit, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave dhe vazhdimësinë e operacioneve të biznesit.

Në fund të vitit 2025, 64% e të gjitha transaksioneve financiare u realizuan përmes platformave digjitale, me një rritje të qëndrueshme nga muaji në muaj, duke arritur në 68% në mbyllje të vitit. Ky trend dëshmon qartë orientimin gjithnjë e më të madh të klientëve drejt kanaleve online për kryerjen e transaksioneve të përditshme. Rritja e përdorimit të kanaleve digjitale krijon bazën për një të ardhme bankare më efektive, ku shërbimet, konsultimi dhe ndërveprimi me klientët zhvillohen gjithnjë e më shumë në mënyrë digjitale.

DUAKredi

Edhe gjatë 2025, DuaKredi si një kanal aktiv në distancë për procesimin kryesisht të kredive konsumatore dhe hipotekore retail ka arritur të konvertojë në shitje, nga total interesimet dhe trajtimet e rasteve, të ardhura nga, rrjetet sociale të bankës, faqja e internetit, nga rrjeti UFT si dhe nga pika të shitjes me pakicë, partnerë të bankës, real estate etj. Zotërimi i kompetencave, ashtu si dhe përmirësimet në sistemet ndihmëse bënë që për 2025 konvertimet në shitje nga kanalet në distancë të kenë një rritje, duke zënë 21% e numrit të kredive totale.

Shërbimi telefonik ndaj klientit

Shërbimi telefonik ndaj klientit vazhdon të mbetet një nga pikat kryesore të kontaktit dhe ndërveprimit midis Union Bank dhe klientëve të saj, duke ofruar akses të vazhdueshëm 24/7 dhe duke mbuluar nevojat si të klientëve individë, ashtu edhe të atyre biznes. Gjatë vitit 2025, ky kanal ka luajtur një rol kyç në garantimin e një eksperience të qëndrueshme dhe cilësore, në përputhje të plotë me strategjinë e bankës për fokusin tek klienti.

Përmes një komunikimi të qartë, të strukturuar dhe të orientuar drejt zgjidhjes, ekipi i shërbimit ndaj klientit ka arritur të ofrojë përgjigje në kohë dhe mbështetje efektive, duke e kthyer shërbimin telefonik në një alternativë të besueshme dhe të vlerësuar nga klientët. Profesionalizmi, eksperiencia dhe aftësia për të komunikuar në mënyrë të thjeshtë edhe çështje komplekse kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kënaqësisë dhe besimit të klientëve.

9. Zhvillimi i Operacioneve të Brendshme

Viti 2025 ka qënë një vit konsolidimi nga këndvështrimi operacional, duke sjellë ofrimin e shërbimeve të konsoliduara mbas përfundimit me sukses të upgrade të platformave kryesore mbështetëse të aktivitetit të bankës: core banking system dhe platformës së shërbimeve digjitale si edhe aplikimit të teknologjive të reja në shërbim të klientëve si pajisjet e depozitimit të cashit për bizneset në zonat 24/7.

Në linjë me strategjisë e bankës fokusi kryesor i strukturave operacionale ka qënë:

- Rritja e automatizimit të proceseve të brendshme operacionale, ekzekutimit të transaksioneve etj me objektiv rritjen e eficensës së strukturave, saktësisë së operacioneve dhe të kënaqësisë së klientit.
- Spostimi gradual i fokusit dhe natyrës së punës nga ekzekutues në kontrollues, duke përforcuar rolin e strukturave si linja të dyta kontrolli.
- Përforcim kapacitetesh të burimeve njerëzore për një përqsje proaktive në sfidat tekonologjike të realitetit si AI etj
- Suport të drejtpërdrejtë nëpërmjet pjesëmarrjes dhe kontributit në të gjitha projektet kryesore të bankës.

Edhe gjatë vitit 2025 struktura e Operacioneve të bankës ka vijuar të mbetet një shtyllë e fortë mbështetëse e aktivitetit të bankës, duke u përshtatur gjithashtu në mënyrë proaktive në të gjitha drejtimet si në metodologji pune, fokus dhe përforcim aftësish me objektivin e kryesor të bankës dhe strategjinë e saj.

10. Zhvillimi dhe Menaxhimi i Rrjetit

10.1 Roli i degëve dhe zhvillimi i prezencës fizike (Degë, ATM dhe CDS)

Rrjeti i Degëve

Gjatë vitit 2025, Union Bank ka vijuar konsolidimin dhe optimizimin e saj duke forcuar pozicionin e rrjetit të degëve, duke ndërmarrë iniciativa transformuese, zhvilluar modernizimin e rrjetit të degëve dhe strategjinë e përmirësimit të eksperiencës së klientit. Mbulimi me degë fizike në të gjitha qytetet kryesore të vendit ka rritur prezencën dhe afërsinë me klientët.

Standardizimi dhe modernizimi i hapësirave fizike

Në Vijim të iniciativave të nisura në vitin 2025, banka ka përshpejtuar implementimin e konceptit të ri të dizajnit dhe organizimit të hapësirave të degëve. Një nga momentet kryesore të vitit ishte implementimi i këtij koncepti në një nga degët. Kjo degë do të shërbejë si një model referues, duke pasqyruar vizionin e Bankës për një mjedis modern, të orientuar drejt klientit dhe mbështetur në teknologji duke prezantuar dhe konceptin e një dege Hibride si dhe duke aplikuar modelin cash-less, me qëllim reduktimin e varësisë nga transaksionet me para fizike dhe duke mbështetur strategjinë e digjitalizimit të Bankës.

Në disa degë ekzistuese u realizuan rikonstruksione të pjesshme, me fokus të veçantë në zhvillimin dhe përmirësimin e zonave 24/7, duke impementuar jo vetëm ATM cash in/cash out Lek/Eur, por edhe pajisje cash in për klientët biznes CDS. Përgjatë vitit 2025 të gjitha degët e bankës janë pajisur me ATM Cash In/ Cash Out në të dyja monedhat Lekë dhe Euro. Në 11 degë është bërë e mundur vendosja e pajisjes CDS (Vivex) në degët të cilat kanë volume cash-i më të larta me qëllim uljen e kohës operacionale dhe reduktimin e kohës së shërbimit ndaj klientit.

Këto rikonstruksione synojnë rritjen e aksesit për klientët tanë, reduktimin e kohës së pritjes dhe nxitjen e përdorimit të kanaleve alternative përtej orarit zyrtar.

Forcimi i rolit të stafit të degëve

Në funksion të një shërbimi më të personalizuar dhe me vlerë të shtuar, gjatë vitit 2025 u prezantua edhe roli të ri Personal Advisor për klientët premium. Ky rol është i fokusuar në ofrimin e Këshillimit Financiar të personalizuar, identifikimin e nevojave të klientëve në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata.

Njëkohësisht, Banka ka vijuar investimin në zhvillimin profesional të stafit, duke rritur aftësitë këshilluese, shitëse dhe orientimin drejt zgjidhjeve të kërkesave për klientët.

Zgjerimi i kanaleve alternative dhe bashkëpunimi me rrjete të jashtme

Union Bank ka vijuar të zgjerojë aksesin e klientëve përmes kanaleve alternative, duke forcuar bashkëpunimin me rrjetin e Union Net/Western Union, i cili numëron rreth 800 agjenci të shpërndarë në të gjithë qytetet dhe zonat rurale te vendit.

Ky rrjet vijon të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh bankare përtej orareve zyrtare të degëve, duke përfshirë kryerjen e pagesave të ndryshme utilitare, depozitime në llogari, aplikime për kredi si dhe hapje llogarie dhe kryerje të të gjithë transaksioneve bankare në 4 pikat Shop in Shop ku kemi edhe prezence fizike të stafit të Bankës.

Ky bashkëpunim ka ndikuar në rritjen e prezencës së Bankës në zona ku Union Bank nuk ka degë fizike, si dhe në përmirësimin e aksesit dhe komoditetit për klientët duke mbështetur njëkohësisht fokusin strategjik në inovacion dhe lehtësinë e përdorimit të shërbimeve.

Union Bank ka vijuar me zhvillimin e modeleve hibride të degëve, të cilat kombinojnë shërbimin fizik me orientimin drejt përdorimit të teknologjisë dhe shërbimeve të automatizuara. Këto modele kanë ndikuar në optimizimin e kohës së pritjes dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

RRJETI I DEGËVE**Dega Qendrore**

Bulevardi "Zogu i I",
Rr. "Sheshi Ferenc Nopçka",
Nd. 5, H. 3, Tiranë
Tel: +355 4 238 9085

Dega Shallvare

Rr. "Reshit Çollaku"
Pallatet Shallvare 2/18,
Tiranë
Tel: +355 4 238 9169

Dega Garda

Rr. "Dëshmorët e 4
Shkurtit", Tiranë
Tel: +355 4 238 9170

Dega Blloku

Rr. "Ismail Qemali",
Pallati nr. 32, Shk 1, Tiranë
Tel: +355 4 238 9160

Dega Lana

Blv. "Bajram Curri",
Rr. "Isuf Elezi", Nr.8/1, Tiranë
Tel: +355 4 238 9163

Dega Kinostudio

Rruga "Aleksandër Moisiu",
Përballë ish- Kinostudios, Tiranë
Tel: +355 4 238 9166

Dega Medrese

Rr. e Dibrës,
Sheshi "Hafiz Ibrahim Dalliu",
Tiranë
Tel: +355 4 238 9164

Dega Ali Demi

Rruga "Ali Demi"
Tiranë
Tel: +355 4 238 9162

Dega Laprakë

Rruga e Durrësit,
Hyrja 1, Laprakë,
Tiranë,
Tel: +355 4 238 9168

Dega Kristal

Rr. "Medar Shtylla"
Kompleksi Kika 1,
Komuna e Parisit, Tiranë
Tel: +355 4 238 9181

Dega Toptani

Rr. "Murat Toptani"
(Eurocol Center), Tiranë
Tel: +355 4 238 9158

Dega Piazza

Rr. "Ded Gjo Luli"
Nr. 3, Tiranë
Tel: +355 4 238 9157

Dega Rruga e Kavajës

Rruga e Kavajës
Nd. 50, H. 1, Tiranë
Tel: +355 4 238 9159

Dega Gjergj Fishta

Bulevardi Gjergj Fishta
Kompleksi Delijorgji
Tel: +355 4 238 9130

Dega Kamëz

Kryqëzimi i Bulevardit Blu me rrugën
Dubai, (Ish Tutto Casa), Kamëz
Tel: +355 4 238 9167

Dega Durrës 1

Rruga Tregtare, Durrës
Tel: +355 4 238 9171

Dega Durrës 2

Rruga "Kristaq Rama"
Durrës
Tel: +355 4 238 9172

Dega Elbasan

Bulevardi "Qemal Stafa",
Elbasan
Tel: +355 4 238 9173

Dega Kavajë

Shëtitoria "Josif Budo",
Kavajë
Tel: +355 4 238 9174

Dega Rrogozhinë

Lgji Nr. 2, Pallati B2/3,
Shk1, Ap. 2, Rrogozhinë
Tel: +355 4 238 9175

Dega Fushë Krujë

Sheshi "George E. Bush",
Fushë-Krujë
Tel: +355 4 238 9182

Dega Lezhë

Rr. "Besëlidhja", Lezhë
Tel: +355 4 238 9184

Dega Sarandë

Rr. "Skënderbe",
Lgji 1, Sarandë
Tel: +355 85 224 567

Dega Shkodër

Lgji "Vasil Shanto",
Shkodër
Tel: +355 4 238 9185

Dega Kukës

Lgji Nr. 5, Kukës
Tel: +355 4 238 9180

Dega Lushnjë

Shëtitoria "Kongresi
i Lushnjës", Lushnjë
Tel: +355 4 238 9186

Dega Fier

Sheshi "Fitorja",
Rr. "Kastriot Muço", Fier
Tel: +355 4 238 9176

Dega Berat

Rr. "Antipatrea",
Lgji "22 Tetori", Berat
Tel: +355 4 238 9188

Dega Vlorë

Ish Parku Rinia, Bulevardi Ismail
Qemali Lagjia Pavarësia, Vlorë
Tel: +355 4 238 9177

Dega Pogradec

Lgji Nr 1, Blv. "Rreshit Çollaku",
Pogradec
Tel: +355 4 238 9178

Dega Korçë

Rr. "Ismail Qemali",
Sheshi i Teatrit, Korçë
Tel: +355 4 238 9179

Agjencia Divjakë

Qendër Divjakë, Lushnjë
Tel: +355 4 238 9187

11. Menaxhimi i Rrezikut

Banka, gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, ndjek një qasje të kujdesshme dhe të strukturuar për të siguruar një balancë të qëndrueshme midis rrezikut të ndërmarrë dhe fitimit të realizuar.

Kjo qasje mbështetet në një kuadër të integruar të menaxhimit të rrezikut, që përfshin identifikimin, vlerësimin, monitorimin, kontrollin dhe zbutjen e rreziqeve potenciale që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të saj strategjike, financiarë dhe operativë të Bankës .

Kuadri i menaxhimit të rrezikut është ndërtuar në përputhje me parimin e tre linjave të kontrollit. Njësitë e biznesit veprojnë si linja e parë e mbrojtjes, duke identifikuar dhe menaxhuar rreziqet operationale, ndërsa funksionet e menaxhimit të rrezikut dhe përputhshmërisë, si linjë e dytë, ofrojnë politika, monitorim dhe kontroll të pavarur.

Auditimi i brendshëm, si linja e tretë, ofron siguri të pavarur mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut

Në nivel ekzekutiv, komitetet funksionale mbështesin procesin e vendimmarrjes dhe mbikëqyrjes së rrezikut, duke siguruar që vendimet të bazohen në analiza të strukturuar dhe në përputhje me politikat e miratuara.

- Komiteti i Menaxhimit të Aseteve dhe Pasiveve (ALCO)
- Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë
- Komiteti i Kredisë
- Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Rreziqeve të Tjera
- Komiteti i Përputhshmërisë
- Komiteti i Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës
- Komiteti i Administrimit të Kolateraleve në Pronësi të Bankës
- Komiteti i Menaxhimit të Rrjetit
- Komiteti i Menaxhimit të Produkteve
- Komiteti i Teknologjisë së Informacionit
- Komiteti i Prokurimeve
- Komiteti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Komiteti i Rikuperimit dhe Menaxhimit të Vonesave
- Komiteti i Menaxhimit të Portofolit të Projekteve
- Këshilli (Komiteti) i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Funksionimi dhe ndërveprimi i këtyre komiteve siguron një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj menaxhimit të rrezikut dhe mbështet realizimin e objektivave strategjike të Bankës.

Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut luan një rol kyç në këtë kuadër, duke përgatitur dhe përditësuar politikat dhe metodologjitë e menaxhimit të rrezikut, duke zhvilluar modele matjeje, duke ofruar një opinion të pavarur dhe teknik dhe duke raportuar periodikisht profilin e rrezikut

të Bankës. Departamenti raporton në mënyrë funksionale dhe të pavarur pranë strukturave drejtuese dhe Këshillit Drejtues.

Departamenti mban gjithashtu një bashkëpunim të ngushtë ndërfunksional me të gjitha njësitë e biznesit dhe funksionet mbështetëse, duke mundësuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe proaktive ndaj rrezikut.

Në përputhje me natyrën e aktivitetit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve kryesore si rreziku i kredisë, likuiditetit, normës së interesit dhe tregut, rrezikut operativ, të kundërpartisë dhe këmbimit valutor. Këto rreziqe menaxhohen në përputhje me kuadrin rregullator dhe standardet ndërkombëtare, përmes politikave të dedikuara, limiteve dhe treguesve të monitorimit.

Informacion më i detajuar mbi performancën e rreziqeve dhe masat e kontrollit është paraqitur në pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit të Bankës.

Të gjitha këto rreziqe trajtohen në përputhje me kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë dhe standardet ndërkombëtare, si dhe shoqërohen me instrumente dhe tregues përkatës për matjen dhe monitorimin e tyre.

Çdo punonjës është i ndërgjegjshëm për rolin e tij në ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe përkushtohet për të vepruar brenda kuadrit të rrezikut të pranuar.

11.1 Politikat e Menaxhimit të Rrezikut

Politikat e Menaxhimit të Rrezikut përbëjnë bazën e kuadrit të kontrollit dhe mbikëqyrjes së rreziqeve në Bankë. Ato përcaktojnë rreziqet kryesore ndaj të cilave Banka është e ekspozuar, si dhe parimet dhe përgjegjësitë për identifikimin, matjen, monitorimin dhe menaxhimin e tyre, në përputhje me strategjinë e biznesit dhe oreksin ndaj rrezikut të Bankës.

Politika e Menaxhimit të Aktiv – Pasiveve

Politika e Menaxhimit të Aktiv-Pasiveve përcakton kuadrin për menaxhimin e likuiditetit, normave të interesit, rreziqeve të tjera financiare në bilancin e Bankës përfshirë transaksionet me fondet, investimin e burimeve likuide, menaxhimin e risqeve të tjera financiare në bilancin e Bankës, menaxhimi i rrezikut të këmbimit valutor, etj.

Nëpërmjet kësaj politike, Banka synon të sigurojë që struktura e aktiveve dhe pasiveve të jetë në përputhje me strategjinë, oreksin ndaj rrezikut dhe kërkesat rregullatore.

Komiteti ALCO mbikëqyr zbatimin e kësaj politike përmes limiteve, treguesve dhe mekanizmave të kontrollit të miratuar.

Politika e Investimeve

Politika e Investimeve përcakton kriteret kryesore për menaxhimin e përgjegjshëm të investimeve financiare të Bankës duke marrë në konsideratë profilin e rrezikut, likuiditetin dhe objektivat strategjike. Politika synon të sigurojë që investimet të kryhen në instrumente të lejuara dhe në përputhje me kufijtë e rrezikut të miratuar.

Politika e Rrezikut të Kundërpartisë

Rreziku i ekspozimit me palët e tjera është trajtuar njësoj si rreziku i kredisë dhe aplikohet veçanërisht për ekspozimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare. Në këtë rast, përshtatshmëria e palëve të tjera si dhe limiteve përkatëse janë vlerësuar individualisht duke u bazuar në kriteret e caktuara dhe në metodologjinë përkatëse.

Politika e Rrezikut Operacional

Politika e Rrezikut Operacional adreson rreziqet që lindin nga procese të brendshme të papërshtatshme ose të dështuara, njerëz, sisteme apo ngjarje të jashtme. Ajo përfshin identifikimin dhe monitorimin e indikatorëve kyç të rrezikut, raportimin e incidenteve, analizën e shkaqeve dhe zbatimin e masave parandaluese.

Banka synon të minimizojë humbjet operationale dhe të sigurojë vijueshmërinë e biznesit përmes kontrolleve të përshtatshme dhe planeve të emergjencës.

Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Risqeve të Tjera (KRORT) monitoron periodikisht ngjarjet e humbjeve operationale dhe koston e rrezikut dhe ka përcaktuar përgjegjësitë e duhura për të minimizuar humbjet dhe siguron zgjidhjet dhe mbulimet e rrezikut për aktivitetet që janë subjekt i rrezikut operacional.

Politika e Përputhshmërisë

Politika e Përputhshmërisë pasqyron angazhimin e Bankës për të vepruar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe me standardet e brendshme. Ajo përcakton rolin e funksionit të përputhshmërisë në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me mosrespektimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore.

Funksioni i përputhshmërisë vepron si linjë e dytë e kontrollit dhe është i pavarur nga njësitë operationale dhe vepron në bazë të një kornize të brendshme rregullatore, që shërben për të identifikuar, monitoruar dhe adresuar rreziqet e përputhshmërisë në mënyrë efektive.

Komiteti i Përputhshmërisë mbikëqyr zhvillimin, zbatimin dhe rishikimin e Politikës së Përputhshmërisë, duke siguruar që ajo të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe me standardet e brendshme të Bankës.

12. Burimet Njerëzore, trajnimi dhe zhvillimi i stafit

12.1 Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore përbën një komponent strategjik në zhvillimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të Union Bank. Banka e konsideron kapitalin njerëzor si një nga asetet kryesore për realizimin e objektivave të biznesit, rritjen e performancës dhe fuqizimin e kulturës organizative. Në këtë kontekst, politikat dhe praktikrat e Burimeve Njerëzore janë ndërtuar për të mbështetur strategjinë e përgjithshme të Bankës, duke siguruar profesionalizëm, transparencë dhe zhvillim të vazhdueshëm të stafit. Paralelisht, Banka ka ndërmarrë hapa drejt digjitalizimit të proceseve të Burimeve Njerëzore, me synimin për të rritur eficiencën operacionale, cilësinë e shërbimit të brendshëm dhe mbështetjen e vendimmarrjes, në përputhje me kërkesat bashkëkohore dhe zhvillimet teknologjike të sektorit bankar.

Të gjitha politikat dhe praktikrat e Burimeve Njerëzore në Union Bank zbatohen në përputhje të plotë me legjislacionin e punës në fuqi, aktet nënligjore përkatëse dhe kërkesat rregullatore të sektorit bankar. Banka siguron respektimin e standardeve ligjore dhe rregullatore në çdo aspekt të menaxhimit të burimeve njerëzore, duke kontribuar në transparencë, stabilitet institucional dhe besueshmëri ndaj autoriteteve dhe publikut.

Të gjithë punonjësit me kohë të plotë gëzojnë një paketë të plotë përfitimesh, e cila përfshin përfitime sociale dhe shëndetësore, përfitime që lidhen me paaftësinë dhe pensionin, pushimet dhe festat zyrtare, si dhe përfitime të tjera në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Këto politika reflektojnë aktivitetin e përgjithshëm të Bankës si biznes dhe janë të harmonizuara me strategjinë dhe deklaratën e misionit të saj.

Planifikimi strategjik i burimeve njerëzore është i strukturuar në mënyrë të tillë që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve ekzistues dhe të maksimizojë kontributin e tyre, duke u ofruar mundësi për avancim në karrierë në përputhje me performancën, përvoja dhe kompetencat e tyre.

Kultura organizative e Bankës bazohet në një qasje transparente dhe proaktive ndaj standardeve etike dhe profesionale, të cilat promovohen dhe zbatohen në gjithë mjedisin e punës. Në lidhje me zhvillimin profesional dhe trajnimin, Banka mbështet një sjellje efikase dhe të përgjegjshme, duke ruajtur si prioritet kryesor arritjen e objektivave të biznesit.

Në fund të vitit **2025**, Union Bank kishte një numër total prej **564 punonjësish**, nga të cilët **311 punonjës** ishin të punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme dhe **253 punonjës** në rrjetin e degëve. Qarkullimi total i punonjësve për vitin **2025** ishte **11.2%**.

12.2 Rekrutimi dhe përzgjedhja e stafit

Union Bank angazhohet për garantimin e parimeve të barazisë, diversitetit dhe përfshirjes në të gjitha proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore. Banka siguron trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë punonjësit dhe kandidatët për punësim, pa dallim gjinie, moshe, përkatësie apo karakteristikash të tjera personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2025, procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes së stafit u fokusua në përzgjedhjen e kandidatëve të kualifikuar, me përvojë dhe aftësi profesionale të përshtatshme, me qëllim përmbushjen e standardeve të shërbimit në të gjitha nivelet e veprimtarisë së Bankës.

Për të mbështetur nevojat e biznesit në të gjitha fushat ku Banka operon, gjatë vitit 2025 u punësuan rreth **115 punonjës të rinj**. Procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes është i strukturuar dhe realizohet përmes disa fazave vlerësimi, të cilat përfshijnë teste të ndryshme teknike, logjike dhe të sjelljes (Predictive dhe Cognitive Index), diskutime në grup, kryesisht për pozicionet hyrëse si Shërbim Klienti, si dhe intervista individuale, të zhvilluara fizikisht ose në modalitet online, me qëllim vlerësimin sa më të saktë të përshtatshmërisë së kandidatëve me rolin përkatës.

Në varësi të profilit të pozicionit vakant, paneli i përzgjedhjes përbëhet nga drejtues të departamenteve dhe/ose degëve përkatëse, si dhe përfaqësues nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Kulturës Organizative, duke siguruar një proces vlerësimi objektiv dhe të balancuar.

Gjatë vitit 2025, një fokus i veçantë i është kushtuar gjithashtu promovimit dhe zhvillimit të punonjësve të brendshëm, duke iu ofruar atyre mundësi për avancim profesional dhe ndërtim të një karriere afatgjatë brenda institucionit, si dhe duke kontribuar në rritjen e motivimit dhe angazhimit të stafit.

12.3 Programi i Praktikës

Nëpërmjet Programit të Praktikës, Union Bank synon të tërheqë studentë me rezultate të mira akademike, me motivim të lartë për të mësuar dhe për t'u angazhuar në një mjedis profesional dhe dinamik. Përmes këtij programi, Banka mirëpret studentë tek të cilët evidentohen potenciale për zhvillim profesional dhe punësim të mëtejshëm, duke kontribuar njëkohësisht në përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Union Bank vlerëson ambicien dhe vullnetin e të rinjve, duke u ofruar atyre mundësinë e përfitimit të njohurive praktike dhe transmetimin e përvojës profesionale nga punonjësit e saj. Gjatë programit të praktikës, i kushtohet rëndësi edhe korrektësisë, përkushtimit dhe performancës së studentëve, duke vlerësuar çdo mundësi për krijimin e një marrëdhënieje punësimi afatgjatë me kandidatët më të përshtatshëm.

Gjatë vitit 2025, numri total i praktikantëve që kanë ndjekur Programin e Praktikës në Union Bank ka qenë rreth **50 studentë**, nga të cilët **9** janë punësuar në Bankë pas përfundimit të programit.

12.4 Trajnimi dhe edukimi i mëtejshëm

Përveç përfaqësjes së saj ndaj tërheqjes dhe përzgjedhjes së punonjësve më të kualifikuar në treg, Union Bank angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive profesionale dhe njohurive të stafit të saj. Banka i konsideron programet e trajnimit dhe zhvillimit si një investim strategjik në funksion të përmbushjes së objektivave të biznesit dhe rritjes së cilësisë së shërbimit.

Në Union Bank zhvillohen trajnime orientuese për të gjithë punonjësit e rinj që në momentin e integritit të tyre në institucion, të cilat pasohen nga trajnime në vendin e punës. Nëpërmjet zbatimit të procedurave të përcaktuara dhe mbështetjes nga ekspertiza e kolegëve, synohet një integrim sa më i lehtë dhe efikas i punonjësve në rolet e tyre.

Në lidhje me trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm gjatë punësimit, punonjësve u ofrohen mundësi të shumta për zhvillim profesional dhe kualifikim. Gjatë vitit 2025, Banka ofroi një sërë programesh trajnime dhe iniciativash zhvillimi, të organizuara si nga burime të brendshme, ashtu edhe me ekspertë të jashtëm. Gjithashtu, për një pjesë të stafit është mundësuar akses në platformën e trajnimeve online **Udemy**. Në total, gjatë vitit u zhvilluan rreth **230 seanca trajnime**, nga të cilat rreth **30** ishin trajnime të brendshme dhe rreth **200** u realizuan me bashkëpunëtorë të jashtëm.

Plani vjetor i trajnimit u hartua në përputhje me nevojat e njësive organizative të Bankës, me qëllim rritjen ose rifreskimin e njohurive teknike dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të nevojshme për përballimin e sfidave dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara. Gjatë vitit 2025, stafi ka ndjekur mesatarisht **4.65 ditë trajnime për punonjës**.

Modulet e zhvilluara përfshinë programe të zhvillimit menaxherial për nivelin e lartë dhe të mesëm drejtues, si dhe trajnime në fusha teknike për stafin e rrjetit të degëve, duke përfshirë efikasitetin e forcës së shitjes, produktet bankare, shërbimet digjitale të Bankës, shërbimin ndaj klientit, komunikimin, reagimin ndaj situatave, aftësinë për të kryer disa detyra njëkohësisht, zgjidhjen e problemeve, si dhe rritjen e kapaciteteve menaxheriale dhe të lidhshme.

Gjithashtu, janë zhvilluar trajnime të dedikuara për stafin e Drejtorisë së Përgjithshme, kryesisht në fusha si digjitalizimi, metodologjitë agile, si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe workshop-e profesionale. Po ashtu, gjatë vitit janë realizuar trajnime periodike të detyrueshme që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, sigurinë e informacionit, mbrojtjen dhe përdorimin e të dhënave personale, përputhshmërinë me kuadrin rregullator dhe parandalimin e pastrimit të parave, si dhe rifreskime të njohurive mbi produktet bankare.

12.5 Politikat e Shpërblimeve

Union Bank i kushton rëndësi të veçantë angazhimit dhe mirëqenies së punonjësve të saj, duke synuar krijimin e një mjedisi pune të qëndrueshëm dhe mbështetës. Përmes politikave të shpërblimit, përfitimeve sociale, fleksibilitetit në organizimin e punës dhe masave që synojnë balancën ndërmjet jetës profesionale dhe asaj personale, Banka kontribuon në rritjen e motivimit, produktivitetit dhe stabilitetit të stafit.

Komiteti i Shpërblimeve dhe Burimeve Njerëzore është organi përgjegjës për përcaktimin dhe mbikëqyrjen e politikave të shpërblimit dhe planeve të kompensimit si pjesë e politikave të Burimeve Njerëzore të Bankës. Ky komitet miratohet nga Këshilli Drejtues dhe funksionimi i tij rregullohet në përputhje me statutin përkatës.

Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Kulturës Organizative është nën varësinë direkte të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Kryetarit të Drejtorisë Ekzekutive të Bankës, i cili mban përgjegjësinë përfundimtare për çështjet e burimeve njerëzore. Çështjet që lidhen me burimet njerëzore adresohen gjithashtu përmes Komitetit të Brendshëm të Burimeve Njerëzore.

Pagat

Politika e Shpërblimeve zbatohet për të gjithë personelin e Union Bank dhe mbulon të gjitha format dhe elementet e shpërblimit, duke përfshirë si shpërblimet e pandryshueshme, si paga bazë, ashtu edhe shpërblimet e ndryshueshme, përfitimet e tjera financiare dhe materiale, si dhe përfitimet që rrjedhin nga pjesëmarrja në skema vullnetare pensioni, etj.

Struktura e Pagave në Union Bank është e bazuar në Sistemin e Gradave, i cili shërben si një instrument i standardizuar për ruajtjen e balancës së niveleve të pagave brenda Bankës dhe në krahasim me tregun e punës. Kjo strukturë përcakton kufijtë minimalë dhe maksimalë të pagave për rolet e klasifikuara në çdo gradë dhe mundëson krahasime me referenca të tregut të punës, me fokus industrinë bankare.

Banka synon që sistemi i pagave të jetë i balancuar me nivelet mesatare të tregut, me qëllim nxitjen e motivimit dhe kënaqësisë në punë të stafit, promovimin e një kulture meritokratike dhe mbështetjen e tërheqjes dhe mbajtjes së profesionistëve me nivel të lartë.

Faktorët që ndikojnë në ndryshimin e pagave

Në vendimmarrjen për rishikimin e nivelit të pagave, Banka merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- ndryshimet në nivelet e pagave dhe dinamika të tregut të punës, si edhe ndryshimet në kuadrin ligjor;
- rritjen e kompetencave dhe përgjegjësi të rolit, të cilat shoqërohen me rivlerësimin e gradës dhe rishikimin e nivelit të pagës brenda kufijve të gradës përkatëse;
- ndryshime strategjike, transformime organizative, automatizim të proceseve dhe krijimin e roleve të reja ose roleve kritike për vijueshmërinë e aktivitetit të Bankës.

Performanca individuale e punonjësit konsiderohet si një kriter plotësues në procesin e rishikimit të pagave. Në përputhje me analizat e zhvillimeve në tregun e punës, Banka mund të vendosë rishikimin e niveleve të pagave për pozicione ose individë të caktuar, sipas nevojave dhe në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të saj.

Elementet e ndryshueshme të shpërblimit

Në Union Bank, elementet e ndryshueshme të shpërblimit përfshijnë shpërblimin për performancë, skemat nxitëse të shpërblimit, shpërblimin për realizimin e projekteve, si dhe elemente të tjera financiare që mund të aplikohen edhe në formë të shtyrë në kohë (deferred).

Këto elemente përfshijnë gjithashtu përfitime për stafin, si pjesëmarrja në skema sigurimi jete dhe shëndeti, fondin vullnetar të pensionit, çmime preferenciale për produkte dhe shërbime të Bankës, si dhe forma fleksibiliteti në organizimin e punës, përfshirë punën në distancë.

Elementet e ndryshueshme përcaktohen në përputhje me situatën financiare të Bankës, performancën e përgjithshme dhe performancën e njësive të biznesit, dhe mund të aplikohen në mënyrë të pavarur ose të kombinuar, në varësi të natyrës së roleve dhe objektivave të njësive përkatëse.

Përfitimet për stafin e Bankës

Përfitimet për stafin e Union Bank synojnë të jenë në përputhje me tendencat e tregut të punës dhe të plotësojnë paketën e përgjithshme të shpërblimeve, duke e bërë atë sa më tërheqëse për stafin ekzistues dhe për kandidatët potencialë.

Këto përfitime kontribuojnë në mirëqenien e stafit, ruajtjen e niveleve të larta të motivimit dhe produktivitetit, si dhe në uljen e rrezikut të qarkullimit të punonjësve. Skemat kryesore të përfitimeve përfshijnë:

- sigurim jete dhe shëndetësor;
- pjesëmarrje në Fondin Vullnetar të Pensionit;
- çmime preferenciale për produkte dhe shërbime bankare;
- pushim në ditën e ditëlindjes;
- orar të shkurtuar në ditën e punës;
- përfitime të tjera të lidhura me pozicionin e punës.

Shpërblimi i Këshillit Drejtues dhe Drejtimit Ekzekutiv

Anëtarët e Këshillit Drejtues paguhen me një shumë fikse vjetore për ushtrimin e funksionit si anëtar i Këshillit dhe një tarifë për ushtrimin e funksionit gjatë mbajtjes së mbledhjes së Këshillit Drejtues, paguar këto në baza tremujore.

Drejtimi Ekzekutiv, nga viti 2024, përbëhet nga katër anëtarë. Shpërblimi për Drejtimin Ekzekutiv përbëhet nga komponenti fiks dhe variabël që do të varen nga situata financiare e Bankës si dhe nga performanca individuale e funksioneve respektive të pasqyruara në një skemë që ka brenda dhe elementë pakësimi apo dhe mos pagesë të lidhur me rreziqe të ndryshme e shprehur në politikën e Shpërblimit të punonjësve të Drejtimit Ekzekutiv dhe në objektivat vjetorë.

Në vitin 2025 për të gjithë anëtarët e Drejtimit Ekzekutiv janë aplikuar shpërblime variabël në cash të lidhura me performancën e Bankës, si dhe shpërblime të pandryshueshme në cash mujore të lidhura me rolin në Drejtorinë Ekzekutive si dhe për Vitin e ri, të cilat jepen të përmbledhura më poshtë, në Mijë Lekë:

	2025	2024	2023	2022
Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin fiskal (në Mijë Lekë)				
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	-	-	-	-
Cash/bonus	5'400	4,600	1'526	1,364
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit	-	-	-	-
Cash/bonus	14'189	17,260	19,861	18,035

12.6 Siguria dhe shëndeti në punë

Union Bank vlerëson dhe çmon sigurinë e punonjësve të saj dhe e konsideron atë një prioritet themelor, me synimin për të garantuar që Banka përfaqëson një mjedis të sigurt si për punonjësit, ashtu edhe për bashkëveprimin me klientët.

Në këtë drejtim, Banka ndërmerr përpjekje të vazhdueshme dhe vepron me përgjegjësi për përmirësimin e standardeve të sigurisë, duke forcuar kontrollet dhe masat mbrojtëse, përfshirë ato që lidhen me sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave të klientëve.

Një nga qëllimet kryesore të Bankës është sigurimi i shëndetit, mirëqenies dhe sigurisë në punë për punonjësit e saj. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, përfitimet që lidhen me sigurimin shëndetësor zënë një vend të rëndësishëm. Sigurimi shëndetësor i ofruar nga Sigma InterAlbanian VIG rinovohet çdo vit dhe mbulon pothuajse të gjithë punonjësit e Bankës, duke garantuar akses në skema shëndetësore cilësore që përfshijnë trajtime mjekësore në një rrjet të gjerë klinikash dhe spitalësh të mirënjohura në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

13. Aktivitetet Marketing dhe Përgjegjësia Sociale

Aktivitete dhe Sponsorizime 2025

Gjatë vitit 2025 angazhimi i Union Bank është reflektuar në mbështetjen e aktiviteteve sportive dhe fushatave ndërgjegjësuere për një stil jetese të shëndetshme, si dhe në përkrahjen e kauzave sociale që synojnë fuqizimin dhe përfshirjen e grupeve në nevojë. Një prioritet i veçantë i është kushtuar edukimit financiar të brezit të ri duke mbështetur projekte që synojnë të njohin të rinjtë me kulturën financiare dhe t'i inkurajojë të mendojnë më zgjuar për të ardhmen, si edhe projekte dhe iniciativave që nxisin sipërmarrjen dhe aftësitë profesionale.

Gjithashtu, përmes marrëveshjeve strategjike dhe programeve të dedikuara financiare, Union Bank ka kontribuar në mbështetjen e bizneseve të vogla dhe të mesme, digjitalizimin, investimet e gjelbra dhe zhvillimin e lidershit, duke ndikuar drejtpërdrejt në modernizimin e sektorit privat. Të gjitha këto iniciativa janë në përputhje me vlerat themelore të Bankës dhe angazhimin e saj për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Union Bank, mbështeti Kampionatin e parë të Bizneseve në Ping Pong

Në vijim të angazhimeve për promovimin e një stili jetese të shëndetshme dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, Union Bank mbështeti Kampionatin e Bizneseve organizuar nga Federata Shqiptare e Ping Pongut. Ky kampionat kishte për qëllim zhvillimin e talenteve të reja, si dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive në shkollat e vendit. Union Bank u përfaqësua me ekipin e saj amator, i cili reflektoi jo vetëm frymën sportive, por edhe angazhimin e bankës për të ndërtuar një komunitet biznesi të shëndetshëm.

Union Bank mbështet fushatën ndërgjegjësuere “Çorapet Shumëngjyrëshe”

Union Bank mbështeti fushatën “Çorapet Shumëngjyrëshe”, organizuar nga Fondacioni Down Syndrome Albania, ku me blerjen e çorapeve kontribuoi në mbledhjen e fondeve për ofrimin e shërbimeve terapeutike për 45 fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët frekuentojnë qendrën PRO PAK. Me rastin e 21 Marsit, Ditës Botërore të Sindromës Down, Union Bank dhe punonjësit e saj shprehën solidaritetin dhe mbështetjen për këtë kauzë e cila ka si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e të drejtave dhe përfshirjen e individëve me Sindromën Down në shoqëri.

Union Bank marrëveshje me BERZH dhe BE për të ofruar fonde në mbështetje të bizneseve të vogla shqiptare

Union Bank nënshkroi një marrëveshje me BERZH dhe BE për të ofruar fonde në mbështetje të bizneseve të vogla shqiptare. Paketa e alokuar nëpërmjet Union Bank për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në Shqipëri përfshin realizimin e dy programeve: programi “Go digital” do të mbështesë digjitalizimin dhe modernizimin e tyre, si dhe do të nxisë investimet e gjelbra, si dhe programi “Të rinjtë në biznes”, i cili synon të rrisë qasjen në financa për bizneset e vogla në

pronësi ose të drejtuara nga sipërmarrës të rinj. Këto nisma përfaqësojnë një hap të rëndësishëm përpara në nxitjen e inovacionit, rritjes ekonomike dhe qëndrueshmërisë në Shqipëri, duke mbështetur brezin ardhshëm të drejtuesve dhe modernizimin e sektorit privat”.

Union Bank mbështet “The Leadership Forum”

Union Bank ishte për të katërtin vit sponsor i aktivitetit “The Leadership Forum”. Ky forum bashkoi drejtues dhe profesionistë nga sektorë të ndryshëm të biznesit, për të ndarë së bashku idetë dhe eksperiencat e tyre me qëllimin për t’u rritur dhe zhvilluar së bashku. Tema e trajtuar këtë vit në forum ishte “Flourishing in an AI Era” e organizuar në 2 panele diskutimi ku ekspertë të fushës ndanë pikëpamjet dhe ekspertizën e tyre në lidhje me inteligjencën artificiale, sesi ajo sot po ndikon fusha të ndryshme si burimet njerëzore, lidhshpimin dhe biznesin në tërësi.

Masterclass nga Union Bank për Programin Youth in Business

Union Bank në bashkëpunim me BERZH, organizoi një event të dedikuar për sipërmarrësit e rinj në fushën e hotelerisë dhe bar-restoranteve, në kuadër të Programit Youth in Business. Mbështetja ndaj të rinjve është në fokus të Union Bank dhe tashmë si pjesë e Programit Youth in Business, duke synuar fuqizimin e sipërmarrësve të rinj duke ofruar këshillimin e duhur financiar si dhe produkte financiare dhe jo financiare të përshtatur sipas nevojave të këtij segmenti.

Union Bank sponsor i aktivitetit “Bëje matin si shahist në karrige me rrota”

Union Bank, mbështeti organizimin e aktivitetit social “Bëje matin si shahist në karrige me rrota”, një nismë me një vlerë të madhe për komunitetin e personave me aftësi ndryshe. Ky projekt social u zhvillua në një cikël 2 mujor, ku pjesëmarrësit patën mundësi të trajnohen për sportin e shahut dhe në fund të ciklit të trajnimit të merrnin pjesë në një kampionat duke konkuruar me njëri-tjetrin. Union Bank nëpërmjet mbështetjes së kësaj nisme ka kontribuar në krijimin e një mjedisi më gjithpërfshirës duke nxitur pjesëmarrjen e personave me aftësi ndryshe në jetën sociale dhe kulturore.

Union Bank dhurim gjaku për fëmijët talasemikë

Union Bank edhe këtë vit iu bashkua nismës “Dhuro gjak, shpëto një jetë!” nga Kryqi i Kuq Shqiptar, duke zhvilluar sot seancën vullnetare të dhurimit të gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemikë. Ashtu si e ka traditë dhe këtë vit stafi i Union Bank, iu bashkua thirrjes për pjesëmarrje në seancën e dhurimit të gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemikë, duke përmbushur nevojat e tyre për gjak. Union Bank mbetet e angazhuar duke dhënë kontributin e saj humanitar për kauza jetësore, si pjesë e pandarë e vlerave korporative.

Union Bank mbështetës i Mbrëmjen Gala të Bamirësisë organizuar nga Down Syndrome Albania

Union Bank ishte partner mbështetës në Mbrëmjen Gala të Bamirësisë, një mbrëmje e mbushur me emocione dhe solidaritet, e organizuar nga Fondacioni Down Syndrome Albania, për të mbështetur trajtimet e fëmijëve me aftësi të kufizuara që marrin shërbime në qendrën Propak. Mbështetja e kauzave sociale është një pjesë thelbësore e angazhimit tonë si bankë, prandaj jemi të lumtur që kontributi ynë ndihmon në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për këta fëmijë, duke krijuar më shumë mundësi për integrimin e tyre në shoqëri.

Union Bank dhuron sete shkollore për fëmijët e fshatit SOS

Union Bank, në fillim të vitit të ri shkollor, kontribuoi për të dytin vit radhazi me çanta dhe mjete shkollore për 100 fëmijë të fshatrave SOS në Tiranë. Union Bank do të vijojë mbështetjen dhe angazhimin e saj në projekte që kanë në fokus edukimin dhe zhvillimin e brezit të ri apo projekte që përmirësojnë jetën e komunitetit.

14. Planet për vitin 2026

14.1 Planet Strategjike

Strategjia e Union Bank vijon të ketë në qendër klientin, duke u bazuar në një qasje të personalizuar që ndërtohet mbi analizën e të dhënave, komunikimin e vazhdueshëm dhe kuptimin e të nevojave financiare të klientëve tanë. Qëllimi ynë mbetet ndërtimi i produkteve dhe proceseve që shtojnë vlerë reale në marrëdhënien afatgjatë me klientët, duke e bërë bankën një partner të besueshëm në çdo fazë të zhvillimit të tyre.

Në vitin 2026, kjo qasje merr një dimension të ri, duke reflektuar zhvillimet e viteve të fundit dhe transformimin e vazhdueshëm të sektorit bankar. Në një mjedis të ndikuar nga dinamika demografike, rritja e konkurrencës dhe digjitalizimi i shpejtë, fokusi ynë mbetet rritja e qëndrueshme dhe forcimi i mëtejshëm i lidhjes me klientët.

Fokusi te klienti dhe zhvillimi i marrëdhënies afatgjatë

Në vitin 2026, Banka do të vijojë të vendosë në qendër zgjerimin e bazës së klientëve dhe rritjen e besnikërisë, si dy elementë kyç për zhvillimin afatgjatë.

Në një mjedis ku struktura e tregut dhe lëvizjet demografike po ndryshojnë vazhdimisht, rritja nuk bazohet vetëm në tërheqjen e klientëve të rinj, por në ndërtimin e marrëdhënieve më të forta dhe më të qëndrueshme me klientët ekzistues, ku klienti mbetet elementi kyç i rritjes organike të bankës. Strategjia në këtë drejtim mbështetet në:

- përmirësimin e eksperiencës së klientit;
- zhvillimin e produkteve të personalizuara sipas nevojave dhe profilit të klientit;
- përdorimin e feedback-ut dhe analizës së sjelljes së klientit për të ndërtuar zgjidhje më të qëndrueshme.

Transformimi digjital dhe shërbimet për klientët

Digjitalizimi vijon të jetë një nga shtyllat më të rëndësishme të strategjisë së Union Bank edhe në vitin 2026. Pas zhvillimeve të rëndësishme gjatë vitit 2025 në drejtim të platformave digjitale dhe kanaleve alternative, fokusi zhvendoset drejt thellimit dhe optimizimit të këtij transformimi. Në këtë drejtim, Banka synon:

- rritjen e mëtejshme të përdorimit të kanaleve digjitale nga klientët;
- avancimin e platformave ekzistuese me funksionalitete të reja më të thjeshta në përdorim;
- zgjerimin e shërbimeve 24/7 dhe të kapaciteteve self-service;
- rritjen e sigurisë dhe përputhshmërisë me kërkesat rregullatore.

Digjitalizimi nuk shihet vetëm si një kanal shërbimi, por si një transformim i plotë i mënyrës së operimit të bankës, duke ndikuar në proceset e brendshme, eficiencën dhe menaxhimin e rrezikut.

Përshtatja me zhvillimet rregullatore dhe transformimi i modelit të operimit

Union Bank do të vijojë të jetë në përputhje me ndryshimet e tregut dhe kuadrin rregullator që po evoluon me shpejtësi. Zhvillime si Open Banking, avancimi i sistemeve të pagesave dhe standardet ndërkombëtare të raportimit kërkojnë jo vetëm investime teknologjike, por një adaptim të plotë të organizatës.

Në vitin 2026, fokusi do të jetë në:

- thellimin e integritimit me infrastrukturat e reja të pagesave;
- përmirësimin e proceseve të brendshme për përputhshmëri;
- rritjen e kapaciteteve për edukimin e klientëve dhe përdorimin e shërbimeve të reja.

Këto zhvillime janë pjesë e transformimit afatgjatë të bankës dhe e pozicionimit të saj në një treg gjithnjë e më të hapur dhe digjital.

Rritja e aktivitetit dhe ndërmjetësimi financiar

Roli i Bankës si ndërmjetës financiar mbetet thelbësor në strategjinë për vitin 2026. Fokusi do të jetë në ruajtjen dhe rritjen e fondeve të klientëve, duke i kanalizuar ato në financimin e ekonomisë reale.

Në këtë drejtim, Banka synon:

- rritjen e fondeve nga klientët, me fokus në diversifikim dhe stabilitet;
- zgjerimin e portofolit të kredisë me një strukturë të balancuar ndërmjet segmenteve;
- mbështetjen e sektorëve kryesorë të ekonomisë shqiptare.

Rritja do të vijojë të jetë e kujdesshme dhe e bazuar në analiza, duke synuar cilësi jo vetëm volum.

Zhvillimi i biznesit dhe mbështetja e sektorëve strategjikë

Segmenti i klientëve biznes mbetet një nga prioritetet kryesore të bankës. Në vitin 2026, Banka do të vijojë të forcojë praninë e saj në këtë segment përmes zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve të dedikuara.

Fokusi do të jetë në:

- rritjen e përdorimit të kanaleve bankare nga bizneset;
- zgjerimin e infrastrukturës së pagesave dhe shërbimeve elektronike;
- zhvillimin e produkteve për financim në fusha si efienca energjetike, investimet digjitale dhe ndërmarrjet e reja.

Ky drejtim mbështet jo vetëm rritjen e bankës, por edhe zhvillimin e klientëve dhe ekonomisë në tërësi.

Transformimi organizativ dhe zhvillimi digjital i bankës

Transformimi digjital i nisur në vitet e fundit dhe i strukturuar në një plan afatmesëm deri në vitin 2027, do të vijojë të jetë një element thelbësor i strategjisë.

Ky transformim përfshin:

- zhvillimin e sistemeve dhe proceseve të reja;
- rritjen e eficiencës dhe reduktimin e kostove operacionale;
- përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe kontrollit të brendshëm.

Ai përfaqëson një investim në të ardhmen e bankës dhe në aftësinë e saj për të konkurruar në një treg gjithnjë e më të digjitalizuar.

Menaxhimi i rrezikut dhe qëndrueshmëria

Çdo strategji rritjeje mbështetet në një kuadër të fortë të menaxhimit të rrezikut. Në vitin 2026, Banka do të vijojë të zbatojë një qasje të kujdesshme dhe të balancuar, duke garantuar stabilitet dhe cilësi në aktivitetin e saj.

Fokusi do të jetë në:

- diversifikimin e portofolit të kredisë;
- ruajtjen e një profili të kontrolluar rreziku;
- forcimin e kontrolleve të brendshme dhe proceseve operacionale;
- investimet në sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e informacionit.

Zhvillimi i kapitalit njerëzor

Në këtë transformim, roli i punonjësve mbetet kyç. Union Bank do të vijojë të investojë në zhvillimin e kapaciteteve të stafit, duke përfshirë aftësitë digjitale, menaxheriale dhe teknike.

Fokusi do të jetë në:

- trajnimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm;

- tërheqjen e talenteve të reja, veçanërisht në teknologji;
- krijimin e një kulture organizative që nxit inovacionin dhe bashkëpunimin.

Teknologjia perceptohet si një mundësi për zhvillim dhe transformim, duke krijuar një organizatë më fleksibël dhe më të përgatitur për të ardhmen.

14.2 Planet dhe performanca financiare

Vizioni dhe Objektivat Strategjike

Union Bank synon të konsolidojë më tej pozicionin e saj si një bankë moderne, dinamike dhe e besueshme në tregun shqiptar, e mbështetur mbi baza të forta financiare, standarde të larta qeverisjeje dhe një qasje të kujdesshme ndaj rritjes dhe menaxhimit të rrezikut. Banka synon të jetë pranë individëve dhe bizneseve shqiptare përmes një modeli shërbimi të integruar, që kombinon praninë fizike nëpërmjet rrjetit të degëve me kanalet alternative dhe zgjidhjet digjitale.

Në këtë kuadër, transformimi teknologjik mbetet një prioritet kyç. Modernizimi i platformave ekzistuese, zgjerimi i funksionaliteteve digjitale dhe përmirësimi i përvojës së klientit do të mbështesin një model shërbimi më efikas, më të shpejtë dhe më të aksesueshëm.

Strategjia për periudhën 2026–2030 fokusohet në rritje të qëndrueshme të aktiveve, përfitueshmëri solide, eficiencë operationale dhe zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve digjitale, duke krijuar themele të forta për vlerë afatgjatë ndaj klientëve, aksionarëve dhe ekonomisë shqiptare

Drejtimit Strategjike dhe Perspektiva e Zhvillimit

Strategjia e Bankës mbështetet mbi pritshmëritë për një mjedis ekonomik relativisht të qëndrueshëm, si dhe mbi perspektivën e përmirësimit gradual të profilit të rrezikut në sektorin bankar vendas. Në këtë kontekst, Banka synon të zhvillojë aktivitetin e saj në mënyrë të balancuar, duke konsoliduar pozicionin në treg, duke rritur praninë në segmentet prioritare dhe duke thëlluar marrëdhëniet me klientët ekzistues.

Viti 2026 pritet të shënojë progres të mëtejshëm në treguesit kryesorë financiarë, i mbështetur nga zhvillimi i sektorëve strategjikë të ekonomisë shqiptare, përfshirë turizmin, ndërtimin, shërbimet dhe biznesin e vogël e të mesëm. Këta sektorë pritet të gjenerojnë kërkesë të shtuar për financim, shërbime pagesash, menaxhim likuiditeti dhe produkte investimi.

Në këtë sfond, Union Bank synon të përfitojë nga mundësitë e reja të tregut përmes një qasjeje selektive, fleksibile dhe të orientuar drejt krijimit të vlerës afatgjatë.

Objektivat Financiare për Vitin 2026 dhe Perspektiva Afatmesme

Në fund të vitit 2026, Union Bank synon të përmirësojë më tej pozicionin e saj në treg përmes rritjes së qëndrueshme të aktiveve dhe forcimit të përfitueshmërisë.

Konkretisht, parashikohet që totali i aseteve të rritet me mbi 135 milionë euro, ndërsa fitim neto të tejkalojë 17 milionë euro.

Kthyeshmëria mbi kapitalin aksionar (ROE) parashikohet të jetë mbi nivelin 15%, duke reflektuar performancën e qëndrueshme të Bankës dhe përdorimin efikas të kapitalit.

Në periudhën afatmesme, Banka synon ruajtjen e këtij niveli përfitueshmërie, në përputhje me objektivat e saj për rritje të qëndrueshme, disiplinë financiare dhe optimizim të strukturës së bilancit. Këto rezultate do të pasqyrojnë jo vetëm rritjen volumetrike të aktivitetit por edhe ruajtjes e standardeve të larta të eficiencës operationale dhe cilësisë së aktiveve.

Angazhimi Strategjik i Drejtorisë së Bankës

Drejtoria e Bankës mbetet plotësisht e angazhuar në zbatimin e një strategjie të qartë dhe të orientuar drejt rezultateve, me fokus në rritje të qëndrueshme, përmirësim të përvojës së klientit dhe diversifikim të burimeve të të ardhurave.

Qasja menaxheriale mbështetet në fleksibilitet, përgjegjshmëri dhe aftësi të lartë ekzekutimi, duke siguruar përshtatje të vazhdueshme ndaj zhvillimeve ekonomike, teknologjike dhe rregullatore. Në këtë drejtim, Banka do të vijojë të monitorojë në mënyrë aktive tendencat e sektorit bankar, përfshirë proceset e konsolidimit dhe mundësitë e reja për partneritete apo investime strategjike.

Qëndrueshmëria e Kapitalit dhe Politika e Kujdesshme e Kredihënies

Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit pritet të ruhet në nivelin 18.5% deri në fund të periudhës së planifikimit, duke reflektuar një bazë solide kapitali dhe kapacitet të mjaftueshëm për të mbështetur rritjen e aktivitetit kreditues. Ky pozicion financiar do të mbështetet nga kapitalizmi i pjesës më të madhe të fitimeve të realizuara, si dhe nga përdorimi i instrumenteve shtesë të kapitalit, përfshirë borxhin e varur, i cili planifikohet të rritet me rreth 4 Milion Eur, në funksion të ruajtjes së një strukture optimale kapitali.

Në përputhje me objektivin për stabilitet afatgjatë dhe menaxhim të përgjegjshëm të riskut, aktiviteti i aktivitetit kreditues do të vijojë të fokusohet në cilësinë e portofolit, analizën e kujdesshme të rrezikut dhe shpërndarjen e balancuar sektoriale të ekspozimeve.

Politika e Likuiditetit dhe Menaxhimi i Kujdesshëm i Rrezikut

Union Bank synon të ruajë një pozicion solid likuiditeti gjatë gjithë periudhës së planifikimit, mbi kërkesat minimale rregullatore, duke garantuar fleksibilitet të mjaftueshëm për skenarë të ndryshëm operativë dhe financiarë.

Likuiditeti mbështetet nga buffer-a të brendshëm konservatorë, analiza të rregullta të stresit dhe monitorim i vazhdueshëm në përputhje me kuadrin e apetitit ndaj rrezikut dhe kërkesat prudenciale të Bankës së Shqipërisë.

Kjo qasje synon të garantojë qëndrueshmërinë financiare të Bankës, besueshmëri të lartë në treg dhe kapacitet të plotë për të mbështetur klientët në çdo fazë të ciklit ekonomik.

Përmirësimi i Eficiencës Operacionale dhe Rritja e Vlerës për Aksionarët

Union Bank do të vijojë të fokusohet në rritjen e eficiencës operacionale dhe në krijimin e vlerës së qëndrueshme për aksionarët, përmes një modeli biznesi më produktiv, më fleksibël dhe të mbështetur nga investime të vazhdueshme në teknologji, procese dhe kapital njerëzor.

Treguesit operacionale të Bankës, përfshirë raportin kosto/të ardhura dhe përfitueshmërinë neto, pritet të përmirësohen gradualisht si rezultat i automatizimit të proceseve, rritjes së përdorimit të kanaleve digjitale, optimizimit të rrjetit të degëve dhe rritjes së produktivitetit në të gjitha njësitë organizative.


Në këtë mënyrë, Banka synon jo vetëm të përmirësojë performancën financiare, por edhe të forcojë avantazhin konkurrues në një treg gjithnjë e më të orientuar drejt teknologjisë dhe shërbimit cilësor.

Banka do të vijojë transformimin e modelit të saj operativ, me fokus në thjeshtimin e proceseve, reduktimin e aktiviteteve manuale, përmirësimin e kohës së përgjigjes ndaj klientëve dhe përdorimin më efikas të burimeve ekzistuese. Investimet në sisteme moderne teknologjike dhe në zhvillimin profesional të stafit do të mbeten prioritare gjatë gjithë periudhës së planifikimit.

Në horizontin strategjik afatmesëm, Banka parashikon gjithashtu avancimin e projektit për blerjen e truallit dhe zhvillimin e një godine të re për zyrat qendrore. Ky investim synon krijimin e një selie moderne, funksionale dhe energjetikisht efikase, e projektuar për të mbështetur rritjen afatgjatë të institucionit, bashkëpunimin ndërmjet njësive organizative dhe standarde bashkëkohore të punës.

Zbatimi i objektivave strategjike do të kontribuojë në forcimin e mëtejshëm të profilit të Bankës si një institucion financiar i përgjegjshëm, inovativ dhe i orientuar drejt së ardhmes. Përmes kombinimit të stabilitetit financiar, transformimit digjital dhe qasjes proaktive ndaj klientit dhe komunitetit, Banka synon të ushtrojë një ndikim pozitiv dhe të matshëm në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare.

Treguesit operacionale të Bankës vijnë përmirësimin e tyre ndër vite, siç paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm (vlerat në Euro ‘000).



Aktivet

Gjatë vitit 2026, totali i aktiveve të Bankës pritet të rritet me afro 11%, Rritja do të mbështetet nga zgjerimi i qëndrueshëm i aktivitetit kreditues, rritja e bazës së klientëve dhe optimizimi i strukturës së bilancit, me fokus në rritjen e aktiveve që gjenerojnë të ardhura dhe përdorimin më efikas të kapitalit.

Prioritetet kryesore përfshijnë përmirësimin e raportit hua/depozita, ruajtjen e marzheve neto të interesit dhe një shpërndarje më efektive të aktiveve ndërmjet huadhënies, investimeve financiare dhe rezervave të likuiditetit. Të gjitha këto objektiva do të ndiqen duke ruajtur nivele të përshatshme likuiditeti, në përputhje me politikat e brendshme të Bankës dhe kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë.

Struktura e aktiveve të Union Bank do të vijojë të reflektojë një ekuilibër të kujdesshëm ndërmjet ekspozimit ndaj kredive dhe investimeve në letra me vlerë, në funksion të diversifikimit të të ardhurave, menaxhimit të likuiditetit dhe kontrollit të rrezikut.

Në përputhje me zhvillimet e tregjeve financiare dhe normave të kthimit, Banka do të ndjekë një qasje prudente investimi, duke orientuar portofolin drejt instrumenteve të përzgjedhura që ofrojnë kthyeshmëri të kënaqshme dhe ruajtje të profilit konservator të rrezikut.

Në anën tjetër, viti 2025 përfshin gjithashtu përfundimin e projekteve strategjike në infrastrukturë IT, përfshirë përditësimin e sistemit bankar qendror, zgjerimin e sistemeve të monitorimit të rrezikut dhe automatizimin e funksioneve operationale në degë dhe qendër. Këto investime synojnë rritjen e sigurisë, eficiencës dhe shkallëzueshmërisë së operationeve të Bankës.

Ky pozicionim lejon optimizimin e portofolit nën një filozofi investimi prudente, që siguron ruajtjen e kapitalit dhe krijimin e të ardhurave të qëndrueshme në një mjedis të ndryshueshëm tregu.

Në vitet në vijim, fokusi do të mbetet në rritjen e qëndrueshme të aktiveve të Bankës, me një ritëm të planifikuar vjetor prej rreth 10-11%, duke ruajtur standarde të larta të cilësisë së aktiveve dhe disiplinës së riskut. Ruajtja dhe optimizimi i rjetit ekzistues të degëve do të shoqërohet me konsolidimin e mëtejshëm të kanaleve alternative, të cilat përbëjnë një shtyllë të rëndësishme të strategjisë së Bankës për të ofruar një përvojë bankare moderne, të aksesueshme dhe të personalizuar.

Huadhënia

Për vitin 2026, Union Bank parashikon ta mbyllë me një rritje vjetore me rreth 15.0% portofolin e saj të huasë. Ky rezultat pasqyron zbatimin e suksesshëm të strategjisë së rritjes së qëndrueshme dhe fokusimin në produkte dhe segmente me potencial më të lartë kthyeshmërie.

Në vitet në vazhdim, për periudhën afatmesme, rritja e portofolit të huasë pritet të mbetet dyshifrore, në intervalin 12-14%, duke ruajtur balancën ndërmjet zgjerimit të aktivitetit dhe cilësisë së portofolit kreditor. Strategjia e rritjes synon jo vetëm forcimin e portofolit ekzistues, por edhe zgjerimin drejt segmenteve të reja të klientëve, me fokus të veçantë tek individët dhe

ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME), të cilat mbeten një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të vendit.

Banka synon të luajë një rol aktiv në financimin dhe mbështetjen e këtyre segmenteve përmes produkteve të përshtatura, kushteve konkurruese dhe një qasjeje të personalizuar në menaxhimin e marrëdhënieve me klientët. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet cilësisë së portofolit të huasë, e cila mbetet thelbësore për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe përfitueshmërisë afatgjatë të Bankës.

Rritja e kostove për bizneset dhe konsumatorët në kontekstin e pasigurive globale ka ndikuar si në kërkesën për hua, ashtu edhe në strukturën dhe performancën e portofolit kreditor. Në këtë kuadër, Banka vlerëson dhe monitoron rregullisht të gjitha ekspozimet, duke ruajtur fokusin në cilësinë e aktiveve dhe nivelin e pranueshëm të rrezikut.

Proceset e huadhënies do të vijojnë të modernizohen në përputhje me zhvillimin e sistemeve qendrore dhe implementimin e moduleve të reja funksionale, me qëllim ofrimin e përgjigjeve më të shpejta, rritjen e eficiencës operacionale dhe përmirësimin e përvojës së klientit.

Falë këtyre përmirësimeve teknologjike, produktet e huadhënies do të bëhen më të personalizuar, më të aksesueshme dhe më fleksibël, si në kushtet financiare ashtu edhe në procedurat e miratimit, duke iu përshtatur më mirë profileve dhe nevojave të ndryshme të klientëve.

Fushatat tregtare, të mbështetura nga përdorimi më i avancuar i analizës së të dhënave dhe qasje të reja shitjeje, do të synojnë forcimin e marrëdhënieve me klientët ekzistues dhe zgjerimin e bazës së klientelës së re. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet produkteve të kredisë konsumatore, hipotekare dhe financimit të bizneseve, në përputhje me zhvillimet demografike dhe nevojat e tregut.

Huadhënia do të vijojë të mbështesë klientët aktualë dhe të rinj, me objektivin për të kontribuar pozitivisht në sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare. Ky angazhim do të realizohet në përputhje me limitet sektoriale të përcaktuara nga politikat e brendshme të Bankës, duke garantuar një balancë të kujdesshme ndërmjet rritjes së portofolit dhe menaxhimit të rrezikut.

Për të maksimizuar impaktin, Banka do të ndjekë një qasje proaktive në shitjet e kryqëzuara, duke ofruar paketa të integruara dhe të përshtatura, të mbështetura nga teknologjia, me synim rritjen e kënaqësisë së klientit, eficiencës dhe kontributit në sektorët strategjikë të ekonomisë.

Në thelb të kësaj qasjeje qëndron bindja se përmes një kredihënieje të disiplinuar dhe të orientuar drejt cilësisë, Union Bank jo vetëm që mbështet zhvillimin e klientëve të saj, por kontribuon realisht në përparimin e qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare.

Financimi

Banka mbështetet kryesisht në fondet e mbledhura nga klientët në formën e depozitave, të cilat përbëjnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit të saj dhe një element themelor të stabilitetit të modelit të biznesit. Struktura e fondeve mbetet e diversifikuar ndërmjet segmenteve retail dhe business, me shpërndarje të balancuar sipas monedhave, maturiteteve dhe pranisë gjeografike.

Për vitin 2026, Union Bank parashikon një rritje prej rreth 10% të fondeve të klientëve, me fokus të shtuar në llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat, ndërsa llogaritë e kursimit pritet të rriten me ritme më të moderuara. Rritja synohet si nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve me klientët ekzistues, ashtu edhe përmes zgjerimit të klientelës së re në të gjitha segmentet – individë dhe biznese.

Në periudhën afatmesme që pason, rritja vjetore e fondeve parashikohet të mbetet mesatarisht 10-12%, duke ruajtur një profil të balancuar dhe të qëndrueshëm të strukturës së financimit. Ky zhvillim do të mbështesë objektivat strategjike të Bankës për zgjerimin e aktivitetit kreditues, rritjen e pjesës së tregut dhe financimin e iniciativave prioritare të biznesit.

Kjo rritje do të mbështetet nga një qasje më e avancuar në menaxhimin e marrëdhënieve me klientët, oferta të segmentuara sipas nevojave të tregut dhe përmirësimet e vazhdueshme në kanalet fizike dhe digjitale të shpërndarjes. Në këtë mënyrë, Banka synon të rrisë qëndrueshmërinë e bazës së fondeve dhe besnikërinë e klientëve në afatgjatë.

Në terma absolutë, kontribuesit kryesorë në këtë rritje pritet të jenë depozitat me afat dhe llogaritë rrjedhëse, të cilat po marrin rol gjithnjë e më të rëndësishëm në strukturën e financimit të Bankës. Ky zhvillim reflekton si konkurrencën në treg, ashtu edhe orientimin gradual të klientëve drejt produkteve që kombinojnë fleksibilitetin, sigurinë dhe vlerën financiare.

Struktura e fondeve do të monitorohet me kujdes, me fokus të veçantë në peshën e monedhave kryesore, veçanërisht Euro dhe Lek, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në strukturën aktiv/pasiv të Bankës, në menaxhimin e likuiditetit dhe në drejtimin e investimeve.

Përveç fondeve të klientëve, Banka planifikon të zgjerojë përdorimin e burimeve të tjera të financimit institucional, si linjat ndërbankare dhe bashkëpunimet me partnerë financiarë vendas e ndërkombëtarë. Këto burime do të shërbejnë jo vetëm për optimizimin e strukturës së financimit dhe menaxhimin efektiv të likuiditetit, por edhe për mbështetjen e projekteve dhe iniciativave specifike të bizneseve, veçanërisht në sektorë me prioritet strategjik dhe potencial të lartë zhvillimi.

Në këtë kuadër, Banka synon të forcojë aksesin në skema dhe programe të dedikuara financimi që nxisin sipërmarrjen, investimet prodhuese, modernizimin e bizneseve dhe zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë shqiptare. Këto iniciativa do të kontribuojnë në zgjerimin e bazës së klientëve, rritjen e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e marrëdhënieve afatgjata me klientelën e biznesit.

Strategjia e çmimeve për produktet e depozitave dhe fondeve do të vijojë të orientohet drejt balancimit ndërmjet rritjes së klientelës dhe ruajtjes së përfitueshmërisë, përmes një menaxhimi të kujdesshëm të kostos së fondeve dhe marzhit neto të interesit. Kjo mbetet veçanërisht e rëndësishme në kushtet e rritjes së konkurrencës dhe shtimit të alternativave investuese në treg.

Në funksion të objektivave të mësipërme, zhvillimi i produkteve dhe fushatat tregtare do të fokusohen në krijimin e zgjidhjeve më fleksibël dhe të personalizuar për segmente të ndryshme klientësh. Këto iniciativa synojnë të rrisin atraktivitetin dhe diferencimin e ofertës së Bankës në treg, duke krijuar më shumë vlerë për klientin dhe një bazë më të fortë financimi për rritjen e ardhshme të Bankës.

15. Deklarata e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut

Union Bank synon arritjen e një profili rreziku nga i 'Moderuar' në të 'Ulët', duke balancuar ndjekjen e rritjes së vazhdueshme të qëndrueshme me nevojën për një menaxhim të matur të rrezikut të modelit të saj të biznesit dhe objektivave kryesorë.

Oreksi ynë për rrezik është strukturuar për t'i mundësuar Bankës arritjen e objektivave të saj strategjike si bankë retail — siç janë rritja, inovacioni teknologjik dhe stabiliteti financiar — duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë dhe duke mbrojtur besimin e palëve të interesit. Ne pranojmë rreziqe të caktuara kur ato janë të nevojshme për të mbështetur këto objektiva, me kusht që ato të mbeten brenda limiteve të përcaktuara dhe të menaxhohen në mënyrë aktive.

Në përgjithësi, Banka do të synojë të ruajë një Bilanc të qëndrueshëm, një përfitueshmëri të dëshiruar, një mjaftueshmëri të lartë kapitali, si dhe aftësinë për të përmbushur detyrimet në mjedise ekonomike normale dhe në kushte stresi gjatë viteve të ardhshme. Organizata do të garantojë pajtueshmëri të plotë me të gjitha rregulloret përkatëse dhe standardet e industrisë.

Banka ka një oreks të moderuar, por të kontrolluar ndaj rreziqeve strategjike për të mbështetur rritjen, inovacionin dhe transformimin, duke pranuar se këto rreziqe janë thelbësore për arritjen e objektivave afatgjatë. Ky oreks pasqyron një ekuilibër të matur midis inovacionit dhe ndjeshmërisë ndaj reputacionit.

Banka ka një oreks të moderuar për rrezikun e kredisë dhe synon të ruajë një cilësi të lartë të këtyre aktiveve në kërkim të kthimeve të arsyeshme. Kjo marrje përsipër e rrezikut mbështet qëllimin tonë strategjik për financimin e zhvillimit ekonomik dhe zgjerimin e pranisë sonë në treg. Banka është e përgatitur të marrë nivele të moderuara të rrezikut të kredisë përmes angazhimit me sektorin privat dhe publik për arritjen e objektivave të saj strategjike.

Strategjia jonë përfshin diversifikimin sipas klasave të aktiveve dhe rajoneve gjeografike, me monitorim të vazhdueshëm për të siguruar që rreziqet të mbeten brenda niveleve të pranueshme dhe që Banka të mos ketë përqendrim të tepërt në ekspozime të mëdha apo në portofole të së njëjtës natyrë (p.sh. klientë me ponderim të lartë rreziku, sektorë specifikë të aktivitetit ekonomik, etj.).

Gjithashtu, Banka ka një oreks të ulët për rrezikun e kundërpalës, duke i dhënë përparësi cilësisë së lartë të kredisë dhe qëndrueshmërisë së fortë financiare. Ky rrezik menaxhohet duke investuar vetëm në kundërpalë dhe instrumente të miratuara, duke garantuar ndarje të duhur dhe pajtueshmëri me limitet e përcaktuara të kredisë dhe kriteret e pranueshmërisë.

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit përmes aktiviteteve të saj investuese dhe operacioneve në tregjet financiare. Banka synon të ruajë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet dhe objektivat e politikave të saj në kushte normale dhe në kushte stresi.

Oreksi i Bankës për këtë rrezik është i ulët, duke prioritzuar aftësinë për të siguruar fonde menjëherë, pa pësuar humbje domethënëse. Testet e stresit dhe planet për financim në situata emergjente janë procese integrale që garantojnë qëndrueshmërinë në kushte të pafavorshme të tregut.

Rreziqet e tregut dhe *rreziku i normës së interesit nga aktivitetet e librit bankar (IRRBB)* menaxhohen në një nivel të pranueshëm përmes një kuadri limitesh dhe kontrollesh. Në këtë kontekst:

- Banka ka një oreks të ulët (në monedhë të huaj - FCY) deri në të moderuar (në monedhë vendase - LCY) për rrezikun IRRBB, gjë që pasqyron ekspozimin që vjen nga strategjia e saj e investimit;
- Banka ka një oreks të ulët për rrezikun e kursit të këmbimit, i cili mund të rezultojë në humbje kapitale;

Banka ka një *oreks/tolerancë të ulët për ngjarjet me ndikim të lartë të rrezikut operacional*, të cilat mund të çojnë në humbje të konsiderueshme financiare, dëmtim të reputacionit ose penalitete rregullatore dhe synon të minimizojë rrethanat që mund të dobësojnë ndjeshëm besimin e palëve të interesit dhe të dëmtojnë misionin e saj. Ne pranojmë se disa rreziqe operacionale janë të qenësishme në proceset tona të biznesit.

Ne pranojmë një *ekspozim të kufizuar/të moderuar ndaj rrezikut operacional aty ku është e nevojshme për të rritur efikasitetin dhe inovacionin*, me kusht që kontrollet të jenë në fuqi dhe rreziqet të mbeten brenda limiteve të paracaktuara. Banka njeh *rrezikun në rritje në fushën e sigurisë së informacionit* dhe synon ta zbutë atë përmes një kulture të fortë të sigurisë së informacionit dhe investimeve të duhura në infrastrukturë, mjete dhe këshilltarë të jashtëm, kontrolle aktive, trajnime të stafit, etj.

Banka ka *tolerancë zero ndaj shkeljeve materiale ose të përsëritura të përputhshmërisë, sanksioneve rregullatore, masave shtrënguese dhe sjelljeve të papërshtatshme* që mund të rezultojnë në humbje financiare, dëmtim të reputacionit ose ndërhyrje mbikëqyrëse. Përveç kësaj, Banka synon të shmangë proceset gjyqësore materiale dhe humbjet ligjore duke mbajtur kontrolle të forta ligjore, një qeverisje të shëndoshë të kontratave dhe menaxhimin në kohë të ndryshimeve ligjore/rregullatore, përmes eskalimit të hershëm të mosmarrëveshjeve dhe respektimit rigoroz të ligjeve në fuqi dhe kërkesave mbikëqyrëse.

Ne synojmë të ndërtojmë një organizatë qëndrueshme që mund t'u përshtatet sfidave dhe të shfrytëzojë mundësitë. Ne do të angazhohjmë palët e interesit në të gjitha nivelet për të promovuar një kulturë të ndërgjegjësimit ndaj rrezikut dhe llogaridhënies, duke siguruar që rreziqet operacionale të identifikohen, vlerësohen dhe adresohen menjëherë. Ne duhet të jemi të përgatitur t'u përgjigjemi ndërprerjeve operacionale me plane të forta të menaxhimit të krizave dhe masa për vazhdimësinë e biznesit.

UNION BANK SH.A.
Raporti i Audituesit të Pavarur
dhe Pasqyrat Financiare të Veçanta
me dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

forvis
mazars

PËRMBAJTJA

OPINIONI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	I-III
PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E VEÇANTË E FITIM HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR	3
PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE	4
1. HYRJE.....	5
2. BAZA E PËRGATITJES	6
3. NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHËNIMET SHOQËRUESE	7
4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL.....	7
5. PËRDORIMI I GJYKIMEVE, VLERËSIMEVE DHE SUPOZIMEVE.....	25
6. ARKA DHE LLOGARI ME BANKËN QENDRORE.....	27
7. DEPOZITA DHE LLOGARI ME BANKAT.....	28
8. INVESTIME NË LETRA ME VLERË	29
9. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT	32
10. INVESTIME NË FILIALE.....	38
11. AKTIVE TË PATRUPËZUARA	38
12. AKTIVE TË TRUPËZUARA.....	39
13. AKTIVET ME TË DREJTË PËRDORIMI DHE DETYRIME PËR QIRATË.....	40
14. INVESTIMI NË PASURI TË PALUAJTSHME	42
15. AKTIVE TË MARRA NË PRONËSI.....	42
16. AKTIVE TË TJERA	43
17. DETYRIME NDAJ BANKËS QENDRORE	43
20. DETYRIME TË TJERA	48
21. BORXH I VARUR.....	48
22. KAPITALI AKSIONAR	49
23. TË ARDHURAT NGA INTERESAT	50
24. SHPENZIMET PËR INTERESA	50
25. TË ARDHURAT NGA KOMISIONET.....	51
26. SHPENZIMET PËR KOMISONE.....	51
27. SHPENZIMET NETO PËR ZHVLERËSIM TË AKTIVEVE FINANCIARE.....	51
28. E ARDHURA NETO NGA TREGTIMI	52
29. REZULTATI NETO NGA VEPRIMET VALUTORE.....	52
30. TË ARDHURA TË TJERA, NETO	52
32. SHPENZIME TË TJERA ADMINISTRATIVE	53
34. ANALIZA E MATURITETIT TË AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE	56
36. VEPRIMET ME PALËT E LIDHURA.....	57
37. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME	60
38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR.....	62
39. PARAQITJA DHE VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË.....	86
40. MENAXHIMI I KAPITALIT	87
41. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	88

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR**Për Aksionerët dhe Bordin Drejtues të Union Bank sh.a.****Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të **Union Bank sh.a** ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2025, pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë të rrjedhës së parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të veçanta, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar e veçantë të Bankës me datën 31 dhjetor 2025, dhe performancën e veçantë financiare dhe flukset e veçanta të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare të Veçanta. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi IESBA") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 Mars 2009, "Për auditimin ligjor dhe organizimin e profesionit të audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar", i ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Menaxhimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacioni tjetër përfshin informacionin e përfshirë në Raportin Vjetor të Bankës në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9662, Artikuli 53, date 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë, amenduar me artikullin nr. 18 të ligjit nr. 25/2018 "Për. Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Raporti Vjetor i Bankës pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare të veçanta nuk mbulon informacionin tjetër dhe ne nuk shprehim asnjë formë konkluzioni sigurie për to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të veçanta, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër të identifikuar më sipër kur ai të bëhet i disponueshëm dhe, duke e bërë këtë, të shqyrtojmë nëse informacioni tjetër ka mospërputhje materiale me pasqyrat financiare të veçanta ose njohuritë tona të marra në auditim, ose përndryshe duket të ketë anomali materiale.

Kur lexojmë Raportin Vjetor të Bankës, nëse konkludojmë se në të ka një anomali materiale, ne duhet t'ua komunikojmë këtë çështje personave të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Menaxhimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare të Veçanta

Menaxhimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta, menaxhimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhimi synon të likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se më sipër.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Veçanta

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare të veçanta.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Bankës për vijësi.
- Marrim evidencë të mjaftueshme të auditimit në lidhje me informacionin financiar të subjekteve ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të veçanta. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe performancën e auditimit të Grupit. Ne jemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

**forvis
mazars**
Emin Duraku, Str. Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirane, Albania
NUIIS: K32123006W

15 maj 2026

Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR

Vlerat në '000 Lekë

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aktivët			
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	6	14,317,508	10,898,772
Depozita dhe llogari me bankat	7	6,610,028	7,663,842
Investime në letra me vlerë – VDFH (Tregtimi)	8	42,215	59,702
Investime në letra me vlerë - VDATGJ	8	2,148,440	1,485,468
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	8	35,177,027	33,292,396
Hua dhe paradhënie për klientet	9	58,887,056	50,368,597
Tatim fitim. i parapaguar	34	8,174	-
Aktive të tjera	16	514,975	288,516
Aktive të marra në pronësi	15	426,353	477,848
Investim në pasuri të paluajtshme	14	17,399	33,903
Investime në filiale	10	698,720	366,436
Aktive të patrupëzuara	11	546,790	453,189
Aktive të trupëzuara	12	923,555	838,749
Aktive me të drejtë përdorimi	13.1.1	746,340	746,517
Aktive tatimore të shtyra	33	60,383	70,533
Totali i aktiveve		121,124,963	107,044,468
Detyrimet			
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	17	10,295,120	9,593,294
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	18	9,798,692	6,948,015
Detyrime ndaj klientëve	19	87,033,069	77,745,843
Detyrime të tjera	20	603,450	959,565
Detyrime për qiratë	13.1.2	780,590	769,955
Detyrime tatimore	34	-	18,291
Borxh i varur	21	2,006,593	1,542,818
Totali i detyrimeve		110,517,514	97,577,781
Kapitali			
Kapitali aksionar	22	3,883,813	3,883,813
Primi i aksioneve	22	175,600	175,600
Rezerva ligjore dhe të tjera	22.1	1,233,599	1,156,316
Rezerva për vlerën e drejtë	22.2	30,651	6,397
Fitimi i akumuluar		5,283,786	4,244,561
Totali i kapitalit		10,607,449	9,466,687
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		121,124,963	107,044,468

Këto pasqyra të veçanta financiare janë aprovuar nga Drejtoria Ekzekutive më 27 mars 2026 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


 Flutura Veipi
 Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe
 Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive


 Arten Zikaj
 Drejtor i Divizionit të Financës dhe
 Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive



Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 88, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave të veçanta financiare.

PASQYRA E VEÇANTË E FITIM HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE

Vlerat në '000 Lekë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga interesat	23	5,880,906	5,507,231
Shpenzime për interesat	24	(1,619,630)	(1,517,149)
Të ardhura neto nga interesat		4,261,276	3,990,082
Të ardhura nga komisionet	25	945,317	852,872
Shpenzime për komisionet	26	(157,571)	(114,430)
Të ardhura neto nga komisionet		787,746	738,442
Shpenzimet neto nga zhvlerësimi i aktiveve financiare	27	(592,872)	(405,304)
Fitimi neto nga tregtimi	28	1,136	6,950
Fitim nga shitja e aktiveve financiare -VDATGJ	8	27,813	31,192
Rezultati neto nga veprimet valutore	29	272,391	76,220
Ndryshimi i vlerës së drejtë të investimeve në pasuri të paluajtshme	14	(248)	3,066
Të ardhura nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme	14.2	4,162	2,510
Të ardhura nga dividenti	10	-	48,600
Të ardhura të tjera, neto	30	96,580	126,078
Ndryshimi i vlerës së realizueshme të aktiveve të marra në pronësi	15	(1,396)	(54,965)
Shpenzime të tjera për provigjone		(10,192)	(4,282)
Amortizimi i aktiveve të patrupëzuara	11	(96,163)	(85,200)
Amortizimi i aktiveve të trupëzuara	12	(133,019)	(109,676)
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	13.2	(191,226)	(168,798)
Shpenzime personeli	31	(1,323,715)	(1,255,452)
Shpenzime të tjera administrative	32	(1,660,519)	(1,397,418)
Fitimi para tatimit		1,441,754	1,542,045
Tatimi mbi fitimin	33	(225,246)	(229,027)
Fitimi vitit		1,216,508	1,313,018
	22.2		
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse, neto nga tatimi		24,254	70,396
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		1,240,762	1,383,414

Këto pasqyra të veçanta financiare janë aprovuar nga Drejtoria Ekzekutive më 27 mars 2026.

Pasqyra e veçantë e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 88, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave të veçanta financiare.

PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR

Vlerat në '000 Lekë

Shënime	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore dhe të tjera	Rezerva vlerës së drejtë	Fitimi i akumuluar	Totali
Gjendja më 1 janar 2024	3,883,813	175,600	1,107,600	(63,999)	3,080,259	8,183,273
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	1,313,018	1,313,018
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimi	-	-	-	70,396	-	70,396
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	70,396	1,313,018	1,383,414
Veprimet me pronarët regjistruar direkt në kapital						
Kontribut për rritjen e kapitalit	-	-	-	-	-	-
Krijimi i rezervave të tjera	-	-	48,716	-	(48,716)	-
Dividentet e shpërndarë	-	-	-	-	(100,000)	(100,000)
Totali i kontributeve të dhe për pronarët	-	-	48,716	-	(148,716)	(100,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	3,883,813	175,600	1,156,316	6,397	4,244,561	9,466,687
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	1,216,508	1,216,508
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimi	-	-	-	24,254	-	24,254
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	24,254	1,216,508	1,240,762
Veprimet me pronarët regjistruar direkt në kapital						
Kontribut për rritjen e kapitalit	-	-	-	-	-	-
Krijimi i rezervave të tjera	-	-	77,283	-	(77,283)	-
Dividentet e shpërndarë	-	-	-	-	(100,000)	(100,000)
Totali i kontributeve të dhe për pronarët	-	-	77,283	-	(177,283)	(100,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2025	3,883,813	175,600	1,233,599	30,651	5,283,786	10,607,449

Këto pasqyra të veçanta financiare janë aprovuar nga Drejtoria Ekzekutive më 27 mars 2026.

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapitalin aksionar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 88, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE

Vlerat në '000 Lekë

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Flukset e parasë nga aktiviteti operativ:		
Fitimi para tatimit	1,441,754	1,542,045
Rregullime për zërat jo-monetare:		
Të ardhura nga interesat	23 (5,880,906)	(5,507,231)
Shpenzime për interesat	24 1,619,630	1,517,149
Amortizimi i aktiveve të trupëzuara	12 133,019	109,676
Amortizimi i aktiveve të patrupëzuara	11 96,163	85,200
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	13.1 191,226	168,798
Të ardhura nga dividendi	10 -	(48,600)
Humbje neto nga zhvlerësimi i aktiveve financiare	27 592,872	405,304
Ndryshimi i vlerës së realizueshme të aktiveve të marra në pronësi	15 1,396	54,965
Ndryshimet e vlerës së drejtë të investimeve në pasuri	14 248	(3,066)
Të ardhura nga çregjistrimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	13.2 (89)	(2,312)
Fitimi /humbje nga ndryhimi në vlerën e drejte	95,511	74,155
Provigjone për shpenzime të tjera	10,011	4,282
Efektet e rivlerësimit	522,064	639,060
Fitimi neto nga shitja dhe fshirja e aktiveve të trupëzuara	4,432	878
Fitim/humbja neto nga shitja e aktiveve të marra në pronësi	(4,794)	15,147
	(1,177,463)	(944,550)
Ndryshimet në:		
Depozita dhe llogari me bankat	(1,072,328)	(76,971)
Hua dhe paradhënie për klientët	(9,049,663)	(4,534,880)
Aktive të tjera	(240,579)	2,312
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	2,841,203	(734,533)
Detyrime ndaj klientëve	9,228,642	3,602,355
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	701,944	2,385,089
Detyrime të tjera	(365,252)	345,559
Arkëtime nga shitja e aktiveve të marra në pronësi	66,334	26,349
Interesi i arkëtuar	5,811,583	5,399,604
Interesi i paguar	(1,549,216)	(1,310,869)
Tatim fitimi i paguar	(245,195)	(222,759)
Paraja neto e gjeneruar nga aktiviteti operativ	4,950,010	3,936,706
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese:		
Blerja e aktiveve të patrupëzuara	11 (198,493)	(106,308)
Blerja e aktiveve të trupëzuara	12 (222,436)	(437,003)
Arkëtime nga shitja e aktiveve të trupëzuara	179	10,681
Rritje në investimin në Filial	(332,284)	(81,000)
Rritje në investimin në letra me vlerë	35 (2,907,995)	(2,133,154)
Dividendë të arkëtuar	10 -	48,600
Arkëtime nga investimet në qira neto	6,750	6,750
Paraja neto e përdorur për aktivitetet investuese	(3,654,279)	(2,691,434)
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese		
Dividendë të paguar	22 (100,000)	(100,000)
Ripagimet e detyrime për qira	13 (169,348)	(203,161)
Borxhi i varur	35 483,850	490,750
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese	214,502	187,589
Rritje neto në para dhe ekuivalentet e saj gjatë vitit	1,510,233	1,432,861
Efkti i rivlerësimit të parasë dhe ekuivalentëve të saj	(220,277)	(395,609)
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	35 11,718,634	10,681,382
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	35 13,008,589	11,718,634

Këto pasqyra të veçanta financiare janë aprovuar nga Drejtoria Ekzekutive më 27 mars 2026. Pasqyra e veçantë e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 88, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

1. HYRJJE

Union Bank Sh.a. (“Banka”) është një institucion financiar i regjistruar si bankë tregtare më 9 Janar 2006 bazuar në Vendimin nr. 101, datë 28 dhjetor 2005 të Bordit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (BSH). Aktiviteti i Bankës i nënshtrohet Ligjit nr. 8269 datë 23 Dhjetor 1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 9662 datë 18 Dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” si dhe në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Banka është një bankë tregtare, e cila ofron shërbime bankare për individë dhe kompani në Republikën e Shqipërisë. Banka është regjistruar si shoqëri aksionare me numër regjistrimi 33563 datë 26 Maj 2005, datë në të cilën Banka filloi aktivitetin e saj tregtar. Banka mori licencën për aktivitete bankare më 9 Janar 2006.

Bazuar në marrëveshjen e shitblerjes të nënshkruar më Shtator 2014, në 22 Dhjetor 2014, Banka bleu 100% të aksioneve të Landeslease Sh.a. (“LL”). LL është një shoqëri lizingu shqiptar, e regjistruar si një shoqëri aksionare, e cila u regjistrua dhe filloi të operonte më 5 Prill 2005.

Gjatë vitit 2023, pas marrjes së vendimeve të strukturave të brendshme përkatëse si dhe miratimit të Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet blerjes së aksioneve të sapoemetuara, strukturës aksionere të LL iu shtua Unioni Financiar Tiranë Sh.p.k. Pas kësaj, Banka zotëron 81% të aksioneve të LL.

Bazuar në marrëveshjen e blerjes të firmosur më 28 Mars 2025, Banka mori aprovimin nga Banka e Shqipërisë më 2 Tetor 2025 për blerjen e 100% të aksioneve të Albanian Financial Institution sh.p.k. (“AFI”), dhe është aksionari i vetëm i këtij institucioni financiar. AFI është një institucion financiar jo-bankë, i licensuar nga Banka e Shqipërisë më 17 Janar 2013.

Për qëllimet e këtyre pasqyrave financiare, Landeslease sh.a. dhe Albanian Financial Institution sh.p.k. do të referohen si “Filiale”.

Këto pasqyra janë pasqyra financiare të veçanta të Bankës (“Mëma”). Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare të veçanta kërkohet nga legjislacioni tatimor vendas. Përveç këtyre pasqyrave, Banka përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me kërkesat e SNRF 10. Ato pasqyra financiare të konsoliduara janë të Bankës dhe Filialeve të saj (së bashku “Grupi”). Pasqyrat financiare të Filialeve përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara duke filluar nga data në të cilën fillon ushtrimi i kontrollit të Bankës mbi të e deri në datën në të cilën ky kontroll pushon së ekzistuari (shih Shënimin 2.5).

Më 31 dhjetor 2025 Banka operonte me një rrjet prej 33 degësh dhe agjencish (31 dhjetor 2024: 32) në të gjithë Shqipërinë. Selia qendrore e Bankës ndodhet në Tiranë, Shqipëri

Drejtuesit dhe administrimi i Bankës më 31 dhjetor 2025*Këshilli Drejtues*

Edmond Leka	Kryetar
Niko Leka	Zv.Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anëtar
Henry Russell	Anëtar
Flutura Veipi	Anëtar (dhe Drejtor i Përgjithshëm)
Gazmend Kadriu	Anëtar
Teuta Baleta	Anëtar
Kreshnik Dibra	Anëtar
Mërgim Cahani	Anëtar

Komiteti i Kontrollit

Teuta Baleta	Kryetar
Kreshnik Dibra	Anëtar
Sonila Bicaku	Anëtar

Drejtorja Ekzekutive

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës
Alban Burazeri	Drejtor i Transformimit, Inovacionit

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat e veçanta financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

2.2 Baza e përgatitjes

Banka paraqet pasqyrën e saj të veçantë të pozicionit financiar sipas likuiditetit bazuar në synimin dhe aftësinë e perceptuar të Bankës për të rikuperuar/shlyer pjesën më të madhe të aktiveve/detyrimeve të zërit përkatës të pasqyrës financiare. Një analizë në lidhje me rikuperimin ose shlyerjen brenda 12 muajve nga data e raportimit (aktuale) dhe më shumë se 12 muaj pas datës së raportimit (jo-aktuale) është paraqitur në Shënimin 34.

Pasqyrat financiare të veçanta të Bankës janë përgatitur mbi bazën e kostos historike me përjashtim të Pasurive të paluajtshme të mbajtura për investim, Letrat me Vlere me VDFH dhe Letrat me vlerë me VDAGJ të cilat matën me vlerën e drejtë dhe inventarëve të kolateraleve të marra në pronësi të cilat matën me më të voglën midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

2.3 Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Këto pasqyra financiare të veçanta të Bankës janë paraqitur në Lek Shqiptar (Lek), e cila është monedha funksionale e Bankës. Gjithë informacioni i paraqitur në Lek është rumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur është shprehur ndryshe.

2.4 Vijueshmëria

Drejtimi i Bankës ka vlerësuar aftësinë e tij për të vazhduar në vijimësi dhe është i kënaqur që ka burimet për të vazhduar biznesin për të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, drejtimi nuk është në dijeni për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar si vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare të veçanta vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e parimit të vijueshmërisë.

2.5 Pasqyrat financiare të veçanta

Banka e regjistron investimin në Filialin e saj (Shënimi 1 dhe Shënimi 10) me kosto. Banka njeh dividendet e marrë nga Filiali në fitim ose humbje në pasqyrat e saj financiare të veçanta kur e drejta për të marrë dividendet është përmbushur.

Banka ka aplikuar të gjitha SNRF-të në fuqi në paraqitjen e shënimeve sqaruese në pasqyrat financiare të veçanta.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në baza të veçanta (të pakonsoliduara), në përputhje me legjislacionin tatimor në Republikën e Shqipërisë. Banka vullnetarisht përgatit pasqyra financiare të konsoliduara që përfshijnë dhe filialin e saj, të cilat mund të gjenden në adresën elektronike të Bankës: <https://unionbank.al/>.

Filialet janë investime të kontrolluara nga Banka. Banka ‘kontrollon’ një investim nëse është i ekspozuar ndaj, apo ka të drejta mbi kthimin e ndryshueshëm nga përfshirja në investim dhe ka mundësinë për të ndikuar mbi këtë kthim nëpërmjet pushtetit të tij mbi investimin. Banka rivlerëson nëse ka kontroll nëse ka ndryshuar një apo më shumë nga elementët e kontrollit. Këto përfshijnë rrethana në të cilat të drejtat mbrojtëse të patura (psh. ato që rezultojnë nga një marrëdhënie kredidhënie) bëhen të rëndësishme dhe bëjnë që Banka të këtë pushtet mbi investimin.

Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare të veçanta duhet t’i lexojnë së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankës për vitin të mbyllur më 31 dhjetor 2025, në mënyrë që të sigurojnë një informacion të plotë mbi pozicionin financiar, rezultatet operacionale dhe ndryshimeve në pozicionin financiar të Bankës si një të tërë.

2.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vlerësimeve kontabël njihen në përiudhën në të cilën ndodh rishikimi dhe në periudhat e ardhshme që afektohen/preken nga këto ndryshime.

2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Drejtimi beson se vlerësimet dhe supozimet bazë janë të duhura dhe se, si rrjedhojë, pasqyrat financiare të veçanta paraqesin saktë pozicionin dhe rezultatin financiar në veçanti, informacionin rreth elementëve kryesorë të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël të Bankës. Këto kanë efekt të rëndësishëm në shumatat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta të cilat janë përshkruar në shënimin 5.

2.7 Informacioni krahasues

Riklasifikime të caktuara janë kryer për të përmirësuar prezantimin dhe shënimet shoqëruese të pasqyrave financiare të veçanta më 31 Dhjetor 2025.

3. NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHËNIMET SHOQËRUESE

3.1 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara

Standarde dhe interpretime të tjera aplikohen për herë të parë në 2025, por ato nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës shiko shënimin 4.33. Banka nuk ka filluar aplikimin përpara datave efektive të ndonjë standardi, interpretimi apo rishikimi tjetër të dalë, por ende të pa hyrë në fuqi, shiko shënimin 4.34.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

Banka ka aplikuar në mënyrë konsistente politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

4.1. Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë entitete të kontrolluara nga Banka. Banka përgatit pasqyrat financiare të veçanta dhe të konsoliduara në përputhje me SNRF-të. Filialet mbahen me kosto në pasqyrat financiare të veçanta. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë të përgatitura në mënyrë vullnetare nga Banka pavarësisht se Banka përmbush kriteret përjashtuese të SNRF-ve për përgatitjen e tyre, pasi pasqyrat financiare të Bankës konsolidohen nga aksionari fundor.

4.2. Transaksionet në monedhë të huaj

Veprimet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Zërat monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitim/humbja nga monedhat e huaja për zërat monetare është diferenca midis koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e axhustuar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë, janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Diferencat që vijnë nga kurset e këmbimit e prej konvertimeve janë njohur përgjithësisht në pasqyrën e veçantë të të ardhurave gjithpërfshirëse. Fitimet/ humbjet neto nga këmbimi përfshijnë të gjitha diferencat nga kurset e këmbimit që kanë të bëjnë me transaksionet spot me datë likuidimi dy ditë pune pas datës së veprimit, megjithëse këto transaksione njihen në datën e likuidimit.

4.3. Interesat

Sipas SNRF 9, të ardhurat nga interesat regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit ("NEI") për të gjithë instrumentet financiarë të matur me koston e amortizuar. Të ardhurat nga interesi për instrumentet financiare që sipas SNRF 9 maten me Vlerë të Drejtë në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ("VDATGJ"), gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën e NEI. Shpenzimet për interesa për të gjitha detyrimet financiare të matur me koston e amortizuar, gjithashtu regjistrohen duke përdorur metodën e NEI.

NEI është norma me të cilën skantohen ekzaktesisht pagesat e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare ose arkëtimet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, ose kur është e përshtatshme për një periudhë me të shkurtër, duke arritur në vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.3. Interesat (vazhdim)

NEI (dhe për këtë dhe kosto e amortizuar e një aktivi) përllogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim apo prim në blerje, komisionet dhe kosto të tjera që janë pjesë integrale e NEI-t. Banka njih të ardhurat nga interesat duke përdorur një normë kthimi që përfaqëson vlerësimin më të mirë të një norme konstant kthimi gjatë jetës së pritshme të huasë. Për këtë njih efektin e normave të ndryshme të interesit të aplikuar në faza të ndryshme, dhe karakteristika të tjera të ciklit të jetës së produktit (duke përfshirë parapagimet, gjobat dhe komisionet).

Nëse pritshmëritë në lidhje me flukset e parasë për aktivin financiar rishikohen për arsye të tjera përveç të rrezikut të kredisë, rregullimi regjistrohet si një rregullim pozitiv apo negativ në vlerën e mbartur të aktivit në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar kundrejt një rritje apo ulje të të ardhurave/shpenzimeve nga/për interesi/a, e përllogaritur duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Për instrumentet financiare me normë të ndryshueshme, rivlerësimi periodik i flukseve të parasë që reflekton lëvizjet në normat e interesit të tregut gjithashtu ndikon normën efektive të interesit, por kur instrumentet janë njohur si fillim me vlerë të barabartë me principalin, rivlerësimi i pagesave të ardhshme të interesit nuk ndikon në mënyre të ndjeshme vlerën e mbartur të aktivit ose pasivit.

Interesat dhe të ardhura të ngjashme

Të ardhurat neto nga interesi përbëhen nga të ardhurat nga interesat dhe shpenzimet për interesa të përllogaritura duke përdorur si metodën e normës efektive të interesit dhe metoda të tjera për to. Këto shpalosen të veçanta në pasqyrën e të ardhura dhe shpenzimeve si për të ardhurat, ashtu edhe shpenzimet për interesat për të dhënë një informacion simetrik dhe të krahasueshëm. Në shpenzimet/të ardhurat nga interesat e përllogaritura duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, Banka përfshin vetëm ato interesa të instrumentëve financiare që paraqiten në këtë shënim.

Të ardhura të tjera nga interesi përfshijnë interesin për instrumentet financiare të përcaktuara në VDFH të ndryshme nga ato të mbajtura për tregtim, duke përdorur normën e interesit kontraktual. Të ardhurat/shpenzimet nga interesi për të gjitha aktivet/detyrimet financiare të tregtueshme njihen si pjesë e ndryshimit të vlerës së drejtë në 'të ardhurat neto nga tregtimi'.

Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën bruto të aktivive financiare të cilat nuk janë të zhvlerësuar. Kur një aktiv financiar zhvlerësohet dhe për këtë arsye quhet si "Klasa 3", Banka i përllogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit mbi vlerën neto të aktivit financiar. Nëse aktivi financiar përmirësohet dhe nuk është më i zhvlerësuar, Banka e kthen mënyrën e përllogaritjes së të ardhurave nga interesi mbi vlerat bruto të tij.

Për aktivet financiare të blera apo të krijuara tërësisht të zhvlerësuar ("POCI") (siç shpjegohet në shënimin 4.12.1), Banka përllogarit të ardhurat nga interesat duke përllogaritur NEI-in të rregulluar dhe më pas duke e aplikuar atë normë mbi koston e amortizuar të aktivit.

NEI i rregulluar është norma e interesit e cila, në njohjen fillestare, skonton flukset e ardhshme të parashikuara (duke përfshirë dhe humbjen kreditore) në vlerën e amortizuar të aktivit POCI. Më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024, Banka nuk ka në portofolin e saj ndonjë aktiv POCI.

4.4. Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione

Banka fiton të ardhura nga komisionet nga një shumëllojshmëri shërbimesh të cilat ia ofron klientëve të saj. Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione që janë pjesë e normave efektive të interesave të një aktivi apo detyrimi financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Komisionet dhe tarifat për të cilat Banka merr përsipër detyrimin për të kryer një shërbim, apo një detyrim performues, ndaj klientëve, njihen si të ardhura nga shërbimet bankare bazuar në SNRF15. Të ardhura nga Kontratat me Klientët. Kushtet e punës për shërbimet bankare (kontratat) zakonisht nuk përfshijnë detyrime performimi të shumëfishta të bashkuara në një vlerësim dhe për pasojë nuk ka një gjykim të rëndësishëm të alokimit të çmimit të transaksionit. Për me tëpër, shërbimet bankare të ofruara nga Banka kanë një kohëzgjatje me pak së një vit ose rinovohen në bazë vjetore (për shembull mirëmbajtja e llogarive). Për pasojë, Banka ka përdorur përshtatshmërinë praktike të standardit dhe nuk ka nevojë të paraqesë informacion rreth shumës së agreguar të çmimit të lidhur me pjesën e pakënaqur të detyrimeve të performancës.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.4. Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione (vazhdim)

Deyrimet e performancës përmbushen ose në një moment në kohë, ku e ardhura nga komisioni njihet kur shërbimi është kryer dhe transferuar tek klienti, ose përgjatë kohës gjatë së cilës Banka përmbush shërbimin gjatë një periudhe të rënë dakord dhe klienti e merr shërbimin gjatë gjithë kësaj kohe, dhe e ardhura njihet gjatë gjithë periudhës në fjalë. Përkatësisht, të ardhurat nga komisionet njihen si më poshtë:

- Të ardhurat nga komisionet e fituara nga shërbimet që sigurohen gjatë një periudhë të caktuar kohe.

Komisionet e fituara për ofrimin e shërbimeve gjatë një kohë të caktuar njihen gjatë kësaj kohe. Këto komisione përfshijnë komisionet për mirëmbajtje llogarie, karta, shërbim E-banking, komisione për letrat e kredisë ose garancive bankare dhënë klientëve.

- Të ardhura nga komisionet të fituara nga shërbimet financiare dhe nga ekzekutimi i transaksioneve.

Këtu përfshihen komisione të fituara nga urdhërat e pagesave apo transfertave të klientëve dhe shërbimeve të tjera bankare të ofruara klientëve. Këto komisione apo komponentë të tyre që janë të lidhur me një zhvillim të caktuar, njihen në të ardhura kur kryhen shërbimet me të cilat janë të lidhura.

4.5. Humbje neto nga çregjistrimi i aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar ose me VDATGJ

Humbja neto nga çregjistrimi i aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar ose me VDATGJ përfshin humbjen (ose fitimin) njohur në shitjen ose çregjistrimin e aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar, përlllogaritur si diferencë midis vlerës kontabël (përfshirë këtu dhe zhvlerësimin) dhe arkëtimeve të marra.

4.6. Të ardhura nga dividendët

E ardhura nga dividendi njihet kur vendoset e drejta për të marrë pagesën e tij.

4.7. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin e vitit përmban tatimin e vitit aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e veçantë të fitim ose humbjeve të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse.

4.7.1. Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e arkëtueshme në lidhje me fitimin ose humbjen e tatueshme për vitin, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe ndonjë rregullim për tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

4.7.2. Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që rezultojnë midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare të veçanta. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin në momentin e njohjes fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitimin/humbjen kontabël dhe as atë të tatueshëm.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën Banka pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë është matur me normat e tatimit që pritet të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur detyrimi është likuiduar apo aktivi është realizuar, bazuar në normat tatimore e ligjore në fuqi në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompesojnë njëra-tjetren kur ka një të drejtë ligjore të zbatueshme për të kompesuar aktivitet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatimet mbi të ardhurat të vëna nga i njëjti autoritet i taksave.

Taksat shtesë që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Banka njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendët.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet/kreditet e mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme, deri në masën që është e mundur që të kemi të ardhura të tatueshme kundrejt të cilave ky aktiv tatimor pritet të përdoret. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo periudhë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka mundësi që përfitimi i lidhur nga tatimi të mund të realizohet.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.7. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

4.7.3. Ekzpozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse taksa apo interesa shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozimet dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacionet e reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

4.8. Instrumentet financiare – Njohja fillestare

4.8.1. Data e njohjes

Aktivet dhe detyrimet financiare, me përjashtim të kredive e paradhënieve dhënë klientëve dhe detyrimeve ndaj klientëve, fillimisht njihen në datën e tregëtimit që është data në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Kjo përfshin mënyrën standarde të tregëtimit: blerje ose shitje e aktiveve financiare që kërkojnë dorëzimin e aktiveve brenda një afati kohor, përgjithësisht të përcaktuar me rregullore apo konventë në treg. Huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve njihen kur fondet janë transferuar në llogaritë e klientëve. Banka njih detyrimet ndaj klientëve kur fondet janë transferuar në Bankë.

4.8.2. Matja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiarë në njohjen fillestare varet nga termat e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për të menaxhuar këto instrumente, siç përshkruhet në Shënimin 4.9.1.1. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, me përjashtim të rasteve të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruar si aktive që maten me vlerën e drejtë nepërmjet fitimit ose humbjes (“VDFH”), për cilat kostot e transaksionit shtohen apo zbriten nga kjo vlerë. Llogaritë e arkëtueshme maten me çmimin e transaksionit. Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Banka regjistron fitimin ose humbjen e Ditës së parë, siç përshkruhet më poshtë.

4.8.3. Fitimi ose humbja e ditës së parë

Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti ndryshon nga vlera e drejtë në njohjen fillestare dhe vlera e drejtë bazohet në teknika vlerësimi që përdorin vetëm inputet e vëzhgueshme në transaksionet e tregut, Banka njih diferencën midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto të tregëtimit. Në ato raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të vëzhgueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë shtyhet në kohë dhe njihet vetëm në fitim ose humbje kur inputet bëhen të vëzhgueshme ose kur instrumenti çregjistrohet.

4.8.4. Kategoritë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare në bazë të modelit të biznesit për menaxhimin e aktiveve si dhe kushteve kontraktuale të aktiveve, të matura me:

- Koston e amortizuar (shih Shënimet 4.19, 4.20 dhe 4.21)
- VDATGJ (shih Shënimin 4.21)
- VDFH (shih Shënimin 4.21)

Banka klasifikon dhe mat portofolin për tregëtim me VDFH. Ajo mund të caktojë instrumente financiare në VDFH, dhe për këto eliminon ose ulë ndjeshëm mospërputhjet e matjes ose të njohjes.

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç angazhimeve të huasë dhe garancive financiare, si të matura me koston e amortizuar të shpjeguar në Shënimet 4.11.2.2.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.9. Aktivet dhe detyrimet financiare

4.9.1. Depozita dhe llogari me bankat, Hua dhe paradhënie për klientët, Letra me vlerë të investimit me kosto të amortizuar

Banka mat Depozita dhe llogari me bankat, Hua dhe paradhënie për klientët dhe Letrat me vlerë të investimit me koston e amortizuar vetëm nëse të dyja kushtet e mëposhtme janë përmbushur:

- Aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e aktiveve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale; dhe
- Kushtet kontraktuale të aktivit financiar japin në datat e specifikuar flukse monetare të cilat përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe interesit për shumën e papaguar të tij (SPPI).

Detajet e këtyre kushteve jepen më poshtë.

4.9.1.1. Përcaktimi i modelit të biznesit

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që reflekton më mirë mënyrën se si menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit.

Modeli i biznesit të Bankës nuk vlerësohet bazuar në instrumentë individual, por në nivel portofolësh të grupuara dhe bazohet në faktorë të vëzhgueshëm si:

- Mënyra e vlerësimit dhe raportimit të performancës e modelit të biznesit dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi që janë vlerësuar dhe raportuar tek personeli drejtues të njësisë ekonomike,
- Rreziqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe aseteve financiare të mbajtura në atë model biznesi) dhe, në veçanti, mënyrën se si menaxhohen ato rreziqe
- Si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi i tyre bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara apo në flukset monetare kontraktuale të mbledhura)
- Frekuenca e pritshme, vlera dhe koha e shitjeve janë gjithashtu aspekte të rëndësishme të vlerësimit të modelit të biznesit të Bankës

Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenare të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenaret e "rastit me të keq" ose "rastin e stresit". Nëse flukset e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritshmeritë fillestare të Bankës, Banka nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo origjinuara ose ato të blera në vazhdim.

4.9.1.2. Testi SPPI

Si një hap i dytë i procesit të klasifikimit, Banka vlerëson kushtet kontraktuale të aktiveve financiare për të identifikuar nëse ata përmbushin testin SPPI. 'Principalit' për qëllim të këtij testi përcaktohet si vlera e drejtë e aktivit financiar në njohjen fillestare dhe mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivit financiar (për shembull, nëse ka shlyerje të principalit ose amortizimin e primit / skontos).

Elementet me të rëndësishëm të interesit në kuadër të marrëveshjes së huadhënies janë zakonisht konsiderata për vlerën kohore të parasë dhe rrezikut të kredisë. Për të bërë vlerësimin SPPI, Banka zbaton gjykimin dhe shqyrton faktorët relevantë si monedha në të cilën është shprehur aktivi financiar dhe periudha për të cilën është përcaktuar norma e interesit.

Ne të kundërt, kushtet kontraktuale që paraqesin një ekspozim më pak së minimumi ndaj rreziqeve ose paqëndrueshmëri në flukset monetare kontraktuale që nuk kanë lidhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, nuk krijojnë flukse kontraktuale të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi tepricën e huasë. Në raste të tilla, aktivi financiar kërkohet të matet në VDFH.

4.9.2. Instrumentet financiare të mbajtur për tregtim

Banka i klasifikon aktivet financiare si të mbajtura për tregtim kur ato janë blerë kryesisht për fitim afatshkurtër nëpërmjet aktiviteteve tregtare ose janë pjesë e një portofoli instrumentesh financiare që menaxhohen së bashku, për të cilat ka dëshmi të një modeli të gjenerimit të fitimi afatshkurtër. Aktivitetet e mbajtura për tregtim regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhurat neto nga tregtimi. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në të ardhurat neto nga tregtimi sipas kushteve të kontratës, ose kur vendoset e drejta për pagesë. Të përfshira në këtë klasifikim janë letrat me vlerë të borxhit që janë blerë kryesisht për qëllime të shitjes në periudhën afatshkurtër.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.9. Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

4.9.3. Instrumentet financiare të matur me VDATGJ

Banka klasifikon instrumentet financiare si të matur me VDATGJ kur të dy kushtet e mëposhtme përmbushen:

- Aktiviteti mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është si mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale si dhe për shitje
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar përmbushin testin SPPI.

Matja e mëpasshme e aktiveve me VDATGJ bëhet me vlerën e drejtë me fitimin dhe humbjen që rezulton nga ndryshimi në vlerën e drejtë që njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Të ardhurat nga interesat dhe fitimet nga kurset e këmbimit njihen në të ardhurat dhe shpenzimet në të njëjtën mënyrë si ato të aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar siç shpjegohet në Shënimin 4.3.

Përlllogaritja e HPK për aktivet financiare të matur me VDATGJ shpjegohet në Shënimin 4.12.3. Kur Banka ka me shumë së një investim në të njëjtën letër me vlerë, ato konsiderohen si të shitur sipas parimit “i pari që hyn është i pari që del”. Në çregjistrimin e tyre, fitimet ose humbjet kumulative që më parë janë njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, riklasifikohen nga këtu në të ardhurat dhe shpenzimet.

4.9.4. Borxhi i emtuar dhe fonde të tjera hua

Pas matjes fillestare, borxhi i emtuar dhe fondet e tjera hua më pas maten me koston e amortizuar. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose primi në fondet e emtuara, dhe kostot që janë pjesë integrale e NEI. Shpalosjet për borxhin e emtuar të Bankës përcaktohen në Shënimin 21.

4.10. Riklasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Nëse modeli i biznesit sipas të cilit Banka mban aktivet e saj financiare ndryshon, aktivet financiare të prekura nga ky ndryshim riklasifikohen. Kërkesat e klasifikimit dhe matjes që lidhen me kategorinë e re zbatohen në mënyrë prospektive që nga dita e parë e periudhës së parë të raportimit pas ndryshimit në modelin e biznesit që rezulton në riklasifikimin e aktiveve financiare të Bankës. Gjatë vitit ushtrimor dhe periudhës së mëparshme kontabël nuk ka pasur ndryshime në modelin e biznesit sipas të cilit Banka mban aktivet e saj financiare dhe për këtë arsye nuk janë bërë riklasifikime. Detyrimet financiare nuk riklasifikohen.

4.11. Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

4.11.1. Çregjistrime nga modifikimet thelbësore

Banka çregjistron një aktiv financiar, të tillë si një hua për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegociuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua e re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Huatë e reja të njohura klasifikohen si Klasa 1 për qëllimet e matjes HPK, përveç nëse kredia e re, konsiderohet të jetë POCI.

Gjatë vlerësimit nëse do të çregjistrohet një hua për një klient, ndër të tjera, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në monedhën e huasë
- Futja e një tipari të instrumentit të kapitalit
- Ndryshimi në kundërparti
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të përmbushë me kriterin e SPPI

Nëse modifikimi nuk rezulton në flukse të mjeteve monetare që janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin. Bazuar në ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të skontuara me NEI fillestare, Banka regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën paregjistruar në humbjes nga zhvlerësimi.

4.11.2. Çregjistrime të tjera përveç së ato nga modifikimet thelbësore

4.11.2.1. Aktive financiare

Një aktiv financiar (ose, kur është e mundur, një pjesë e një aktiviteti financiar ose pjesë e një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktiviteti financiar kanë skaduar. Banka, gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ajo ka transferuar aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.11. Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

4.11.2 Çregjistrime të tjera përvec se ato nga modifikimet thelbesore (vazhdim)

4.11.2.1. Aktivet financiare (vazhdim)

Banka ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar; ose
- Ajo ruan të drejtat për flukset e mjeteve monetare, por ka marrë detyrimin për të paguar plotësisht flukset monetare të marra pa vonesa materiale për një palë të tretë nën një marrëveshje 'kalimtare'.

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për të paguar këto flukse monetare në një ose më shumë njësi ekonomike ('përfituesit eventual'), kur të gjitha tri kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Banka nuk ka asnjë detyrim të paguajë shumat për përfituesit eventual, përveç nëse ka arkëtuar shuma ekuivalent nga aktivi origjinal, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën për rimarrjen e plotë të shumës së huasë plus interesin e përlogaritur me normat e tregut
- Banka nuk mund të shesë ose të vendosë si kolateral aktivin fillestar përveçse si siguri për marrësit eventual

Banka duhet të dorezojë çdo fluks parash që mbledh në emër të përfituesve eventual pa vonesë materiale. Përveç kësaj, Banka nuk ka të drejtë të riinvestojë flukse të tilla të parasë, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalent të parasë duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së arkëtimit dhe datës së dërgesës së kërkuar për përfituesit eventualë.

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit; ose
- Banka nuk ka transferuar as ruajtur thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit

Banka e konsideron kontrollin të transferuar nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij për një palë të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Nëse Banka as nuk ka transferuar e as nuk ka mbajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet dhe ka mbajtur kontrollin e aktivit, aktivi vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, rast në të cilin, Banka njih edhe një detyrim të lidhur me të. Aktivet e transferuara dhe detyrimi i lidhur me të maten në një bazë që reflekton të drejtat dhe detyrimet që Banka ka mbajtur. Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e një garancie mbi aktivin e transferuar matet me vlerën me të ulët midis vlerës kontabël fillestare të aktivit dhe shumën maksimale të konsideratës që mund t'i kërkohej Bankës të paguaj.

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) në aktivin e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet në vlerën që Banka do të kërkohej të paguajë gjatë riblerjes.

4.11.2.2. Detyrimet financiare

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë substanciale, zëvendësimi ose modifikim i tillë trajtohet si një çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

4.12. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

4.12.1. Vështrim i Përgjithshëm i parimeve të HPK

Banka ka regjistruar një fond zhvlerësimi për humbjet e pritshme të kredisë për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në VDFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, në këtë pjesë të gjitha të quajtura si 'instrumente financiare'. Instrumentet e kapitalit nuk janë subjekt i zhvlerësimit sipas SNRF 9.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.12. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

4.12.1. Veshtrim i Përgjithshëm i parimeve të HPK (vazhdim)

Fondi i zhvlerësimit HPK bazohet në humbjet e kredisë që pritet të lindin gjatë jetës së aktivitetit (humbja e pritshme përgjatë gjithë jetës së kredisë ose HPK përgjatë gjithë jetës), përveç nëse nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, fondi bazohet në humbjen e pritur të kredisë në 12 muaj (HPK12m) siç është shënuar në Shënimin 4.12.2. Politikat e Bankës për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë janë paraqitur në Shënimin 38.1.2.2.

Me përjashtim të aktiveve financiare POCI (të cilat janë konsideruar më poshtë), HPK-të kërkohet të maten nëpërmjet një fondi për humbje në një shumë të barabartë me njërën nga:

- HPK 12-mujore, që rezultojnë nga ato ngjarje dështimi në instrumentet financiare që janë të mundshëm brenda 12 muajve pas datës së raportimit; ose
- HPK përgjatë gjithë jetës, që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të dështimit gjatë jetës së instrumentit financiar.

Banka mat fondin e humbjeve në një shumë të barabartë me HPK përgjatë gjithë jetës, përveç përveç rasteve në vijim, për të cilat fondi matet si HPK 12 mujore:

- Letrat me vlerë të investimit të cilat përcaktohen të kenë rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit; dhe
- Instrumente të tjera financiare në të cilët rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja e tyre fillestare.

Si HPK përgjatë gjithë jetës ashtu dhe HPK12m janë llogaritur në baza individuale ose në bazë kolektive, në varësi të natyrës së portofolit të instrumenteve financiare. Politika e Bankës për grupimin e aktiveve financiare të matura në baza kolektive është shpjeguar në Shënimin 38.1.2.3.

Banka kryen një vlerësim në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse rreziku i kredisë i një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e dështimit që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar. Ky vlerësim shpjegohet me tej në Shënimin 38.1.2.3. Bazuar në këtë proces, Banka klasifikon kreditë e saj në Klasën 1, Klasën 2, Klasën 3 dhe POCI, siç përshkruhet më poshtë:

- Klasa 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Banka njeht një zhvlerësim në bazë të HPK12m. Kreditë e Klasës1 gjithashtu përfshijnë kredi ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Klasa 2.
- Klasa 2: Kur një kredi ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi, Banka regjistron një fond për HPK përgjatë gjithë jetës. Kreditë e Klasës 2 gjithashtu përfshijnë kredi, për të cilat rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Klasa 3.
- Klasa 3: Huatë që konsiderohen të zhvlerësuar plotësisht (siç janë shënuar në Shënimin 38.1.2.1). Banka regjistron një fond për HPK përgjatë gjithë jetës.
- POCI: Aktivitetet e blera ose të origjinuara tërësisht të zhvlerësuar ("POCI") janë aktivitetet financiare që janë të zhvlerësuar që në njohjen fillestare. Aktivitetet POCI regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një NEI të rregulluar. HPK-të njihen ose rimerren vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme të kredisë.

Për aktivitetet financiare për të cilat Banka nuk ka pritshmëri për rikuperimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e aktivitetit financiar zvogëlohet. Ky zvogëlim konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i aktivitetit financiar.

Banka ka klasifikuar të gjitha aktivitetet financiare të zhvlerësuar të përfituara nëpërmjet kombinimit të biznesit në të njëjtin klasifikim si më parë dhe jo si POCI, sa kohë që Banka ka blerë dhe më pas është bashkuar me një biznes si një i tërë.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.12. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

4.12.2. Përlllogaritja e HPK-ve

Banka llogarit HPK-të duke përdorur skenarët të ponderuar me probabilitet të ndodhjes për të vlerësuar mungesat e flukseve të pritshëm të arkëtimeve, të skontuara në një përafrim me NEI. Një mungesë e arkëtimeve të pritshme është diferenca midis flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të pritshme dhe atyre që Banka pret të arkëtoje.

Parametrat kryesorë të përdorur në llogaritjet HPK janë përshkruar më poshtë dhe elementet kryesore janë si vijon:

- **PM – Mundësia e mospagesës (“PM”)** është një vlerësim i mundësisë që një kredimarrës të dështojë gjatë një horizonti kohor të dhënë. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësimit, nëse aktivi nuk është çregjistruar dhe vazhdon të qëndrojë në portofolin e Bankës. Koncepti i PM-së shpjegohet më tej në Shënimin 38.1.2.4.1.
- **EM – Ekspozimi në rast mospagese (“EM”)** përfaqëson ekspozimin e pritshëm në një datë të ardhshme dështimi, duke marrë në konsideratë ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit. Kjo përfshin parapagimet e principalit dhe interesit, të skeduluara në kontratë apo jo, tërheqjet e pritshme në angazhime për financim të dhëna, dhe interesa të përlllogaritur nga pagesat e pakryera, duke zbritur vlerën e drejtë të skontuar të kolateralit.. EM shpjegohet më tej në Shënimin 38.1.2.4.3.
- **HM – Humbja në rast mospagese (“HM”)** përfaqëson humbjen e pritshme në një ngjarje dështimi në një kohë të dhënë. Ai përlllogaritet si diferenca midis flukseve kontraktuale të arkëtimeve dhe atyre që Banka pret të arkëtojë, duke përfshirë dhe realizimet e atyre që vijnë nga ndonjë kolateral i marrë. Kur EM vlerësohet neto nga kolateralit, asnjë fluks monetar nga realizimi i kolateralit nuk përfshihet në HM. Zakonisht shprehet në përqindje të EM-së. HM shpjegohet më tej në Shënimin 38.1.2.4.4.

Këto parametra rreziku rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara brenda Bankës dhe të dhëna të tjera historike. Ato janë rregulluar për të përfshirë informacionin për ndikimet të elementëve potencial të ardhshëm siç shpjegohet në Shënimin 38.1.2.4.2. Humbjet nga zhvlerësimi dhe rimarrjet janë llogaritur dhe tregohen veçmas nga humbjet e modifikimit ose fitimet që llogariten si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivitetit financiar.

Mekanika e metodës HPK është përmbledhur më poshtë:

- **Klasa 1:** HPK12m përfaqëson pjesën e HPK-ve që lindin nga ngjarjet e dështimit të mundshëm brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Banka vlerëson PM në 12 muajt pas datës së raportimit, e aplikon mbi një EM të parashikuar dhe shumëzon rezultatin me HM-në e pritshme.
- **Klasa 2:** Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi i saj, Banka njuh një fond për HPK përgjatë gjithë jetës. Mekanika është e ngjashme me ato të shpjeguara më sipër, por PM-të dhe HM-të vlerësohen gjatë gjithë jetës së instrumentit. Mungesat e arkëtimeve të pritura të parave skontohen me NEI origjinale.
- **Klasa 3:** Për huatë që janë të zhvlerësuar (siç përcaktohet në Shënimin 38.1.2.1), Banka njuh HPK përgjatë gjithë jetës. Metoda është e ngjashme me atë për aktivet e Klasës 2, me PM të supozuar në 100%.
- **POCI:** Aktivet POCI janë aktive financiare që janë të zhvlerësuar që në njohjen fillestare. Banka njuh vetëm ndryshimet kumulative në HPK përgjatë gjithë jetës që nga njohja fillestare, skontuar nga NEI e rregulluar.
- **Angazhimet e huasë dhe letrat e kreditit:** Gjatë vlerësimit të HPK-ve për angazhimet e huazuara, Banka vlerëson pjesën e pritshme të angazhimit të huasë që do të tërhiqet gjatë jetës së tij të pritshme. HPK pastaj bazohet në vlerën aktuale të mungesave të pritura në flukset e mjeteve monetare nëse kredia është tërhequr. Mungesat e arkëtimeve të pritshme skontohen me NEI e pritshme të huasë. Për kartat e kreditit dhe kreditë rrotulluese që përfshijnë si një hua dhe një angazhim të patërhequr, HPK llogariten dhe paraqiten së bashku me huanë. Për angazhimet e kredisë dhe letrat e kreditit, HPK njihet brenda Provizioneve.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.12. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

4.12.2 Përlllogaritja e HPK-ve (vazhdim)

- Kontratat e garancisë financiare: Detyrimi i Bankës sipas secilës çdo garanci matet me vlerën më të lartë të: (1) shumës së njohur fillimisht, pakësuar me amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave, dhe (2) provizioneve HPK. Për këtë qëllim, Banka vlerëson HPK-të bazuar në vlerën aktuale të pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin për një humbje kredie që ajo shkakton. Mungesat e arkëtimeve skontoohen me një normë interesi të rregulluar nga rreziku që lidhet me ekspozimin. HPK-të që lidhen me kontratat e garancisë financiare njihen brenda Provizioneve.

4.12.3. Instrumentet e matura me vlerën e drejtë përmes ATGJ

HPK për instrumentet e borxhit të matura në VDATGJ nuk ul vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila mbetet në vlerën e drejtë. Në vend të kësaj, një shumë e barabartë me zhvlerësimin që do të lindte nëse aktivet mateshin me koston e amortizuar njihet në ATGJ si një shumë e akumuluar e zhvlerësimit, me një ngarkesë korresponduese për fitimin ose humbjen. Humbja e akumuluar e njohur në ATGJ riciklohet në fitim dhe humbje me çregjistrimin e aktiveve.

4.12.4. Informacion për ngjarje që priten të ndodhin

Në modelet e saj HPK, Banka mbështetet në një gamë të gjerë të informatave të ardhshme, si input ekonomik, si:

- Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto (“PBB”)
- Normat e papunësisë
- Inflacioni
- Normat e interesit
- Kurset e këmbimit dhe tregues të tjerë të rëndësishëm ekonomike

Inputet dhe modelet e përdorura për llogaritjen e HPK-ve mund të mos pasqyrojnë gjithnjë plotësisht të gjitha karakteristikat e tregut në datën e raportimit. Për të adresuar këtë, mund të aplikohen rregullime cilësore, kur dallimet e tilla janë dukshëm materiale. Informata të hollësishme rreth këtyre inputeve dhe analizës së ndjeshmerisë lidhur me to, jepen në Shënimin 38.1.2.4.2.

4.12.5. Paraqitja e fondit për zhvlerësim HPK në pasqyrën e pozicionit financiar

Fondet e zhvlerësimit për HPK janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës si më poshtë:

- Aktivet financiare të matura me koston e amortizuar: si zbritje nga vlera kontabël bruto e aktivitet;
- Kontratat e angazhimeve të huasë dhe kontratat e garancive financiare: përgjithësisht si një provizion;
- Kur një instrument financiar përfshin si një komponent të tërhequr dhe një komponent të patërhequr angazhimi, dhe Banka nuk mund të identifikojë HPK-në për komponentin e angazhimit të kredisë veças nga ato për pjesën e tërhequr: Banka paraqet një fond të kombinuar zhvlerësimi për të dy komponentet. Shuma e kombinuar paraqitet si një zbritje nga vlera kontabël bruto e komponentit të tërhequr.

4.13. Përmirësimet e kredisë: vlerësimi i kolateralit dhe garancitë financiare

Për të zbutur riskun e kredisë në aktivet financiare, Banka synon të marrë kolaterale dhe përmirësimet të pranueshme të kredisë, kur është e mundur. Kolaterali është i formave të ndryshme, si depozita, letra me vlerë, garanci, pasuri e patundshme, dhe marrëveshje për ndarjen e rrezikut me institucione financiare të njohura si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“BERZH”) dhe Albanian Development Guarantee Fund (“ADGF”).

Kolaterali, përveç atij të sekuestruar, nuk njihet në pasqyrat financiare të Bankës. Flukset e pritshme nga përmirësimet e kredisë të cilat, në bazë të SNRF-ve, nuk kërkohen të njihen më vete dhe që konsiderohen pjesë e kushteve kontraktuale të një instrumenti i cili është subjekt i zhvlerësimit, përfshihen në matjen e atij zhvlerësimi. Në këto kushte, vlera e drejtë e kolateralit ndikon përlllogaritjen e HPK-ve. Kolaterali zakonisht vlerësohet të paktën në lindjen e kredisë dhe në varesi të llojit të tij, rivlerësohet një herë në vit ose një herë në tre vjet. Megjithatë, disa kolaterale, për shembull, depozitat apo letrat me vlerë vlerësohen në bazë ditore. Detajet e ndikimit të përmirësimeve të kredisë të Bankës, jepen në Shënimin 38.1.4.

Për aq sa është e mundur, Banka përdor të dhënat e tregjeve aktive për të vlerësuar aktivet financiare të mbajtura si kolateral. Aktivet e tjera të cilat nuk kanë vlera tregu të matshme, vlerësohen duke përdorur

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.13 Përmirësimet e kredisë: vlerësimi i kolateralit dhe garancitë financiare (vazhdim)

teknikat e vlerësimit. Kolaterale jo-financiare, si pasuritë e patundshme, vlerësohen në bazë të të dhënave të siguruara nga palë të treta, si vlerësues të pavarur, ose bazuar në indeksin e çmimeve të shtëpive.

Garancitë, marrëveshjet për ndarjen e rrezikut dhe përmirësimet e tjera të kredisë përfshihen në matjen e kredisë HPK kur ato ose specifikohen në Kushtet kontraktuale të kredisë ose përndryshe janë pjesë përbërëse e procesit të aprovimit të kredisë, në atë që ato formonin një pjesë të bazës mbi të cilën kredia u dha.

4.14. Kreditë e ristrukturuara dhe të modifikuara

Banka në disa raste bën modifikime në Kushtet fillestare të kredisë si një përgjigje ndaj vështirësive financiare të kredimarrësit, në vend që të ekzekutojë kolaterale të kredisë ose të nisë procedurat e rikuperimit të saj. Një ekspozim konsiderohet i ristrukturuar kur këto modifikime bëhen si rezultat i vështirësive financiare aktuale apo të pritshme të kredimarrësit dhe Banka nuk do të kishte rënë dakord për to, nëse kredimarrësi do të kishte një situatë të shëndetshme financiare. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, shkelje të kufijve të treguesve financiar të dakorduar në marrëveshje, ose shqetësime të ngritura nga Departamenti i Riskut të Kredisë. Masat e ristrukturimit mund të përfshijnë zgjatjen e afateve të pagesës, riskedulime të pagesave të dakorduara, rifinancimin ose modifikime të tjera të kushteve kontraktuale fillestare. Ristrukturimi në përgjithësi rezulton në një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë (SIICR); në varësi të rastit, ekspozimet e ristrukturuara zakonisht klasifikohen në Klasën 2, përveç nëse plotësojnë kriteret e Bankës për zhvlerësim të kredisë, në të cilin rast ato klasifikohen në Klasën 3

Pasi kushtet rinegociohen pa çregjistrim të ekspozimit, zhvlerësimi matet duke përdorur normën fillestare NEI të përlllogaritur përpara modifikimit të kushteve. Ekspozimet e ristrukturuara mbeten në një status ristrukturimi për një periudhë prove 24-mujore, gjatë së cilës performanca monitorohet, dhe humarrësi duhet të demonstrojë përmirësim të qëndrueshëm përpara se të dalë nga ky status. Gjatë gjithë kësaj periudhe, Banka rivlerëson klasën dhe mat HPK (përgjatë jetës, kur është e aplikueshme).

Përcaktimi i Klasës (përfshirë cdo lëvizje midis Klasës 2 dhe Klasës 3) dhe vendimet për çregjistrim vlerësohen rast pas rasti. Nëse këto vlerësime tregojnë se ekspozimi është me zhvlerësim kredie, ai klasifikohet dhe menaxhohet si një hua e ristrukturuar në Klasën 3 deri në mbledhjen e plotë të tij apo në fshirjen e tij nga librat kontabël.

Kur një hua është ristrukturuar ose modifikuar por nuk është çregjistruar, Banka gjithashtu rivlerëson nëse ka patur një rritje të rëndësishme të rrezikut të saj të huasë, siç tregohet në Shënimin 38.1.2.2.

Detajet për aktivet e ristrukturuara shpalosen në Shënimin 38.1.2.1.

Nëse modifikimet janë thelbësore, kredia çregjistrohet siç tregohet në Shënimin 4.11.

4.15. Kompesimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompesuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si për shembull ato të aktivitetit tregtar të Bankës.

4.16. Fshirja

Aktivitet financiare fshihen pjesërisht ose tërësisht vetëm kur Banka nuk më pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e flukseve monetare kontraktuale. Fshirja konsiston në një ngjarje çregjistrimi për qëllime kontabël.

Në përputhje me sa më sipër, Banka zbaton procedurën e saj të brendshme për fshirjen e kredive të miratuar nga Këshilli Drejtues dhe në përputhje me rregulloren Nr. 62) të Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”. Sipas kësaj rregulloreje, kreditë e klasifikuara si “Të humbura” fshihen nga bilanci jo më vonë se dy vjet nga data e një klasifikimi të tillë.

Përfshirjet nga kjo kërkesë zbatohen për rastet e mëposhtme:

1. Kreditë për të cilat, bazuar në vlerësimin e gjendjes financiare të kredimarrësit dhe cilësisë së kolateralit, demonstroi një mundësi reale rikuperimi dhe merr miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë.
2. Kreditë që janë në proces ristrukturimi, për të cilat zgjatja e afatit për t'u fshirë, nuk mund të kalojnë periudhën 6 mujore nga dita që kanë plotësuar kushtet për t'u fshirë.

Nëse shuma që duhet të fshihet është më e madhe se fondi i zhvlerësimit të akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtesë e këtij fondi i cili më pas zerohet ndaj vlerës kontabël bruto.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.17. Matja me koston e amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi. Çdo rikuperim i mëvonshëm kreditohet në të ardhura të tjera.

4.18. Matja e vlerës së drejtë

‘Vlera e drejtë’ është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose do të paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka akses në atë datë.

Për të treguar se si janë nxjerrë vlerat e drejta, instrumentet financiare janë riklasifikuar bazuar në një hierarki të teknikave të vlerësimit, siç përmbledhet më poshtë:

- Niveli 1: Ato ku inputet e përdorura në vlerësim janë çmimet e kuotuar të parregulluara në tregjet aktive për një instrument identik në të cilat Banka ka qasje në datën e matjes.
- Niveli 2: Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuar të tregut në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak së aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet ku teknikat e vlerësimi përfshijnë inpute të cilat nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pavëzhgueshme mund të ketë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme, ku rregullime të rëndësishme të pavëzhgueshme ose supozime janë të nevojshme për të reflektuar diferencat midis instrumenteve.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmim të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë së transaksionet në lidhje me aktivin apo detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të çmimeve në baza të vazhdueshme.

Nëse nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të kishin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni. Vlera e drejtë tregohet në Shënimin 39.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - dmth vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë.

Nëse Banka përcakton së vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe së vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik e as nuk është e bazuar në një teknikë vlerësimi e cila përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencen midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë është njohur në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetëgjatësinë e instrumentit, por jo me vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Në qoftë së një aktiv ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofruar dhe një çmim të kërkuar, atëherë Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata në çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra në çmimin e kërkuar. Vlera e drejtë e një llogarie kursimi nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë kur mund të kërkohej pagimi i shumës. Banka njih transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë të cilës ky ndryshim ka ndodhur.

4.19. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë para në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.20. Depozita dhe llogari me bankat dhe Hua dhe paradhënie për klientët

“Depozita dhe llogari me bankat” dhe “Hua dhe paradhënie për klientët” në pasqyrën e pozicionit financiar, përfshijnë hua dhe paradhënie të matura me koston e amortizuar (Shënimi 4.8.4). Fillimisht ato maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv thelbësisht të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo të anasjellta), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivi i lidhur me të nuk njihet në pasqyrat e veçanta financiare të Bankës.

4.21. Letra me vlerë investimi

“Letra me vlerë investimi” përfshijnë letra me vlerë që maten me koston e amortizuar ose ato që maten me vlerë të drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ose ato që maten me vlerë të drejtë në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse (Shënimi 4.8.4). Letrat me vlerë investimi maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Letrat me vlerë që mbahen VDATGJ, më pas maten me vlerën e tyre të drejtë, duke regjistruar fitim humbjen që krijohen nga ndryshimi i vlerës së tyre të drejtë në “të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse”. Letrat me vlerë që mbahen për tregtim, më pas maten me vlerën e tyre të drejtë, duke regjistruar fitim humbjen që krijohen nga ndryshimi i vlerës së tyre të drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.22. Qiratë

Banka vlerëson në lindjen e kontratës nëse një kontratë është apo përmban një qira. Që do të thotë nëse kontrata jep të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohë në këmbim të një shume.

4.22.1. Banka si qiramarrëse

Banka zbaton një qasje të vetme për njohjen dhe matjen e të gjitha qirave me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të vogël. Banka njeh detyrimin për qiratë për të kryer pagesat e qirave dhe të drejtën e përdorimit të aktivitetit që përfaqëson të drejtën për të përdorur aktivin bazë.

4.22.1.1. Aktiv me të drejtë përdorimi

Banka njeh aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (data në të cilën aktivi bazë është i vlefshëm për t'u përdorur). Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto, duke i zbritur ndonjë amortizim të akumuluar apo ndonjë humbje nga zhvlerësimi, dhe të rregulluar për ndonjë rimatje të detyrimit për qira. Kosto e aktivitetit me të drejtë përdorimi përfshin vlerën e detyrimit për qira të njohur, kostot e drejtpërdrejta fillestare të kryera, dhe pagesat e qirave të kryera në apo para datës së fillimit të qirasë, pakësuar me çdo stimul qiraje të marrë. Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet në bazë lineare gjatë jetës së qirasë. Aktivitetet me të drejtë përdorimi paraqiten brenda Shënimit 13.1.1.

4.22.1.2. Detyrimet për qira

Banka njeh detyrimin për qira në datën e fillimit të qirasë, të matur si vlerë aktuale e pagesave për t'u kryer të qirave gjatë gjithë jetës së qirasë. Pagesat e qirave përfshijnë pagesat fikse (pakësuar me ndonjë stimul të marrë për qiratë), pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen në një indeks ose një normë, dhe pagesat e pritshme sipas vlerës së mbetur të garancive. Pagesat e qirasë gjithashtu përfshijnë dhe çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Banka ka siguri në arsyeshme në ushtrimin e tij dhe pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë reflekton ushtrimin e një opsioni për përfundimin e qirasë. Qiratë e ndryshueshme të cilat nuk varen nga një indeks apo normë, njihen si shpenzime të periudhës në të cilën ndodh ngjarja apo kushtet për shkaktimin e tyre.

Banka në përlllogaritjen e vlerës aktuale të pagesave të qirasë përdor normën rritëse të huamarrjes në datën e fillimit të qirasë, pasi norma e interesit e përcaktuar e qirasë nuk mund të jetë lehtësisht e gjatshme. Pas datës së fillimit, vlera e detyrimit për qira rritet për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë dhe pakësohet për të reflektuar pagesat e kryera të qirasë.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.22. Qiratë (vazhdim)

4.22.1 Banka si qiramarrëse (vazhdim)

4.22.1.2. Detyrimet për qira (vazhdim)

Përveç kësaj, vlera kontabël e detyrimit për qira rimatet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatet e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (psh. ndryshim i pagesave të ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa të qirave) ose ndryshim në vlerësimin e opsionit për të blerë aktivin bazë. Kur detyrimi për qira rimatet në këtë mënyrë, regjistrohet dhe një rregullim korrespondues i vlerës kontabël të aktivitetit me të drejtë përdorimi, ose regjistrohet në fitim humbje në rast se vlera kontabël e aktivitetit me të drejtë përdorimi është zero.

Detyrimet për qiratë paraqiten në një zë më vete në bilancin e veçantë të Bankës dhe shpalosen në Shënimin 13.1.2.

4.22.1.3. Qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët

Banka zbaton lehtësirat e njohjes për qiratë afatshkurtra për qiratë e disa degeve të saj (ato qira që kanë maturimin deri në 12 muaj nga data e fillimit dhe nuk kanë një opsion për blerje). Po ashtu zbaton dhe lehtësirat e njohjes për disa pajisje zyre të cilat janë konsideruar si me vlerë të ulët. Pagesat e qirasë për qiratë afatshkurtra dhe ato të aktiveve me vlerë të ulët njihen si shpenzime gjatë afatit të kontratave të qirave përkatëse.

4.22.2. Banka si qiradhënëse

Qiratë në të cilat Banka nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit bazë klasifikohen si qira operacionale. Të ardhurat nga këto qira njihen në bazë lineare përgjatë jetës së qirasë dhe përfshihen në të ardhurat në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për shkak të natyrës së tyre operacionale. Kostot fillestare direkte të bëra për të negociuar dhe përfunduar një qira operacionale i shtohen vlerës kontabël të aktivitetit bazë dhe njihen si shpenzim gjatë jetës së qirasë në të njëjtën bazë si e ardhura e qirasë. Të ardhurat nga qiratë në kontigjencë njihen në periudhën në të cilën ato janë fituar.

4.22.3. Nënqiraja

Banka në disa raste është nënqiradhënëse (qiradhënësi i ndërmjetëm) i aktivitetit me të drejtë përdorimi. Si një qiradhënësi i ndërmjetëm, Banka e klasifikon nën qiranë si një qira financiare apo operacionale si më poshtë:

- Nëse qiraja kryesore është qira afatshkurtër që Banka, si qiramarrëse, e ka njohur si të tillë, nënqiraja klasifikohet si qira operacionale,
- Në të kundërt, nënqiraja klasifikohet duke iu referuar aktivitetit me të drejtë përdorimi që vjen nga qiraja kryesore, dhe jo duke iu referuar aktivitetit bazë. Një qira klasifikohet si qira financiare nëse transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë nga aktiviteti me të drejtë përdorimi që rrjedhin nga qiraja kryesore; në të kundërt, ajo klasifikohet si një qira operacionale.

Për nënqiratë të klasifikuara si qira financiare, Banka çregjistron Aktivin me të drejtë përdorimi dhe një Investimin neto në nënqira; çdo diferencë midis Aktivitetit me të drejtë përdorimi dhe investimit neto në nënqira, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në datën e fillimit, Investimi neto në nënqira financiare matet me një vlerë të barabartë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të Aktivitetit me të drejtë përdorimi bazë përgjatë afatit të qirasë.

Investimi neto në qira paraqitet nën “Aktive të tjera” në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar.

Për nënqiratë e klasifikuara si qira operacionale, Banka njih të ardhurat nga qiraja financiare në baza lineare përgjatë afatit të qirasë. Aktiviteti respektiv i dhënë me qira përfshihet në pasqyrën e pozicionit financiar bazuar në natyrën e tij.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.23. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

4.23.1. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara maten me kosto pakësuar me amortizimin e akumuluar dhe ndonjë zhvlerësim të akumuluar për humbje.

Kosto përfshin shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin dhe koston e materialeve dhe punën direkte, kosto të tjera direkt të atribuueshme në bërjen e aktivitetit të gatshëm për punë, dhe kur Banka ka detyrimin për të hequr një aktiv apo ta restaurojë atë, kosto e vlerësuar e çmontimit dhe heqjes së pjesë si dhe restaurimi i vendit në të cilin ato ndodhen. Programet kompjuterike që janë pjesë e funksionimit të pajisjes në të cilën ato janë instaluar, kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Në rast se pjesë të një aktivi kanë afate përdorimi të ndryshme, ato regjistrohen si njësi më vete (përbërësit kryesorë) të aktiveve të trupëzuara.

Të ardhurat apo humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një aktivi të trupëzuar (llogaritur si diferencë midis arkëtimit nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël të aktivitetit) njihen si të ardhura të tjera në pasqyrën e fitim humbjeve.

4.23.2. Kostot e mëpasshme

Kostot e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike që i atribuohen atyre do të rrjedhin te Banka në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes regjistrohen në shpenzimet kur ndodhin.

4.23.3. Amortizimi

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara amortizohen duke filluar nga dita që ato janë vënë në përdorim, ose përsa i përket aktiveve të ndërtuar vetë, nga dita e përfundimit dhe e bërjes gati për përdorim. Amortizimi llogaritet për të gjithë jetën e aktivitetit mbi koston e asetit minus vlerën e tij të mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e fitim humbjeve.

Amortizimi i vitit është llogaritur sipas metodës së vlerës së mbetur në përputhje me normat e mëposhtme:

	Norma vjetore
Pajisje kompjuterike	25%
Pajisje zyre	20%
Pajisje elektronike dhe elektrike	20%
Instalime	20%

Përmirësimet në ambjentet e marra me qira nga Banka amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë kohës me të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së tyre. Afati i përdorimit të këtyre përmirësimeve varion nga 3 në 15 vjet. Aktivitetet në proces nuk amortizohen. Metodatat e amortizimit, jeta dhe vlera e tyre e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen në rast se ka nevojë.

4.24. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Programet kompjuterike të blera nga Banka maten me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin kur është i aplikueshëm. Shpenzimet e mëpasshme në programe kompjuterike kapitalizohen vetëm nëse ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të aktivitetit për të cilin bëhen. Të gjitha shpenzimet e tjera regjistrohen kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim humbje gjatë jetës së dobishme të aktivitetit, duke u nisur nga data në të cilën është i vlefshëm për punë. Aktivitetet në proces nuk amortizohen.

Programet kompjuterike amortizohen sipas metodës së vlerës së mbetur me normë vjetore amortizimi 25%, ndërkohë aktivitetet e tjera të patrupëzuara, që përfshijnë licenca dhe komisione të paguara për qasje në sisteme elektronike e shërbime të përdorura nga Banka, amortizohen sipas metodës lineare me normë vjetore amortizimi 15%.

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e tyre e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen në rast se ka nevojë.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.25. Investime në pasuri të paluajtshme

Investimet në pasuri të paluajtshme janë aktive të mbajtura ose për të fituar të ardhura nga qiraja ose për rivlerësime të vlerës së tyre ose për të dyja, por jo për përdorim në prodhim apo furnizim me të mira materiale, shërbime apo për qëllime administrative. Banka mban investime në pasuritë e paluajtshme si pasojë e përfitimit të tyre nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve mbi kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve. Pasuritë e paluajtshme për investim maten fillimisht me kosto dhe më pas me vlerën e drejtë, ku çdo ndryshim i tyre njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në zërin “të ardhura të tjera”.

Çdo fitim apo humbje e gjeneruar gjatë shitjes së pasurive të paluajtshme të mbajtura për investim (të llogaritur si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të këtij aktivi) njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Në rast se përdorimi i këtij aktivi ndryshon në mënyrë të tillë që riklasifikohet si aktiv i trupëzuar ose aktiv i mbajtur për shitje, vlera e drejtë e tij në momentin e riklasifikimit bëhet kosto e tij për regjistrimet kontabël të mëpasshme.

4.26. Inventarët dhe aktivet e marra në pronësi

Inventarët dhe aktivet e marra në pronësi fillimisht maten me kosto dhe më pas me më të voglën e kostos dhe vlerës neto të realizueshme (“VNR”). Kosto përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kosto të tjera që mund të ndodhin për të sjellë inventarin në vendndodhjen aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë një situatë normale biznesi, pakësuar me kostot e vlerësuar për realizimin dhe ato të vlerësuar të nevojshme për të bërë shitjen.

Inventarët përfshihen në Aktive të tjera në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar. Banka mban inventarët në formën e inventarëve për konsum. Inventarët për konsum janë materiale të blera me qëllim konsumin e tyre gjatë ofrimit të shërbimeve bankare.

Kolateralet e marra në pronësi janë pasuri të paluajtshme të përfituara nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve mbi kreditë dhe paradhëniet të klientëve. Për transferimet nga Investime në pasuri të paluajtshme që mbahen me vlerë të drejtë tek Inventarët, si kosto për kontabilizimin në këtë kategori do të jetë vlera e drejtë në datën në të cilën bëhet transferimi.

Çdo zvogëlim në VNR njihet si një shpenzim në periudhën në të cilën ky zvogëlim ndodh; çdo rimarrje njihet në pasqyrën e veçantë të të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën rimarrja ndodh.

4.27. Humbje nga zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jofinanciare të Bankës, përveç tatimeve të shtyra, rishikohen çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Në rast se ka një tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në rast se vlera kontabël e aktivit është më e madhe se vlera e tij e rikuperueshme.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë duke zbritur koston për shitje. Në përcaktimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar të pritshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerën në kohë të parasë në treg dhe risqet specifike të aktivit. Humbjet për zhvlerësim njihen në pasqyrën e veçantë të fitim humbjeve.

Humbja për zhvlerësim kthehet mbrapsht deri në masën që vlera kontabël nuk kalon vlerën e mbartur të aktivit, neto nga zhvlerësimet e amortizimet, e cila do të ishte në rast se nuk do të ishin njohur humbje nga zhvlerësimi.

4.28. Depozitat, marrëveshjet e riblerjes dhe borxhi i varur

Depozitat, marrëveshjet e riblerjes dhe borxhi i varur janë burimet e Bankës për financim.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo), marrëveshja kontabilizohet si një detyrim financiar, dhe aktiv i vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.29. Provizionet

Provizioni është njohur nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të mjeteve monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, rreziqet specifike ndaj detyrimit. Efektet e vlerës kohore nepërmjet skontimeve njihen si kosto financiare.

4.30. Garancitë financiare, letërkreditë dhe angazhimet e patërhequra për kreditë

Si pjesë e biznesit të saj, Banka lëshon garanci financiare, të përbërë nga letra kredie, garanci dhe pranime.

Garancitë financiare fillimisht njihen në pasqyrat financiare (brenda Provigjoneve) me vlerë të drejtë, duke qënë primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës sipas secilës garanci matet me vlerën më të madhe mes shumës së njohur fillimisht pakësuar me amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe një fond zhvlerësimi HPK siç përcaktohet në Shënimin 37.

Primi i marrë njihet në pasqyrën e të ardhurave në Të ardhurat nga komisionet në përpjesëtim të drejtë gjatë jetës së garancisë.

Angazhimet për kredi dhe letrat e kredive janë angazhime nën të cilat, gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, Bankës i kërkohej të ofrojë një hua me terma të paracaktuar për klientin. Ngjashëm me kontratat e garancisë financiare këto kontrata janë në kuadër të kërkesave të HPK.

Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare, letrave të kreditit dhe angazhimeve të kredisë, ku huatë e dakorduara për t'u ofruar janë në terma të tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlerat nominale të këtyre instrumentëve së bashku me HPK-të përkatëse janë shpalosur në Shënimin 37.

4.31. Kapitali

Elementet e Kapitalit janë kapitali aksionar, primet e aksioneve dhe rezervat. Rezervat përfshijnë rezervat ligjore dhe të përgjithshme (Shënimi 22.1), rezervën nga bashkimi dhe rezervën nga vlera e drejtë. Rezerva për vlerën e drejtë përfshin ndryshimin neto në vlerën e drejtë për instrumentet e klasifikuara si VDATGJ, pakësuar me zhvlerësimin për HPK. Lëvizjet në elementet e kapitalit janë treguar në Shënimin 22.

4.32. Përfitimet e punonjësve

Planet e përcaktuara të kontributeve

Detyrimet për kontributet për planet e përcaktuara të pensioneve njihen si një shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute të detyrueshme për sigurimet shoqërore për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra për përfitimet e punonjësve maten në një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime kur ofrohet shërbimi. Një provigjon është njohur për shumën që pritet të paguhet si bonus afatshkurtër në para ose planeve me ndarje fitimi nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi, dhe detyrimi mund të matet me besueshmëri.

4.33. Adaptimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara

Standardet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standardeve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale, por adaptimi i tyre nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Bankës:

- **SNK 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor: Mungesa e këmbyeshmërisë (Ndryshimet)**

4. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

4.34. Impakti i standardeve të reja ende të pa adaptuara

- **SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacionit - Klasifikimi dhe Matja e Instrumenteve Financiare (Ndryshime).** Në maj 2024, BSNK publikoi ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare të cilat ndryshuan SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe ato hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2026, me aplikim më të hershëm të lejuar. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE. Menaxhimi do të analizojë kërkesat e këtij standardi të sapobotuar dhe do të vlerësojë ndikimin e tij.
- **SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese - Kontratat që i referohen energjisë elektrike të varur nga natyra (Ndryshime).** Në dhjetor 2024, BSNK publikoi ndryshime të synuara për një reflektim më të mirë të kontratave që referojnë energjinë elektrike të varur nga natyra, të cilat ndryshuan SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe ato hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2026, me aplikim më të hershëm, të lejuar. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE. Menaxhimi ka vlerësuar ndryshimet dhe nuk ka ndikim në pasqyrat financiare.
- **SNRF 18 Paraqitja dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare.** Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 - Paraqitja dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare, i cili zëvendëson SNK 1 - Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe ai hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2027, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Standardi ende nuk është miratuar nga BE-ja. Në periudhat e mëposhtme të raportimit, Menaxhimi do të analizojë kërkesat e këtij standardi të sapobotuar dhe do të vlerësojë ndikimin e tij.
- **SNRF 19 Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese.** Në maj 2024, BSNK publikoi SNRF 19 - Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe ai hyn në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2027, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Standardi ende nuk është miratuar nga BE-ja. Menaxhimi ka vlerësuar ndryshimet dhe nuk ka ndikim në pasqyrat financiare.
- **Përmirësimet vjetore të standardeve të kontabilitetit të SNRF - Vëllimi 11.** Në korrik 2024, BSNK publikoi Përmirësimet Vjetore të Standardeve të Kontabilitetit të SNRF - Vëllimi 11. Një njësi ekonomike duhet t'i zbatojë ato ndryshime për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2026. Zbatimi lejohet më herët. Standardi nuk është miratuar nga BE-ja. Menaxhimi ka vlerësuar ndryshimet dhe nuk ka ndikim në pasqyrat financiare.
- **Amendamenti në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta: Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët** - Në dhjetor 2015, BSNK shtyu datën efektive të këtij ndryshimi për një kohë të pacaktuar, në pritje të përfundimit të metodës së kërkimit. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE.
- **SNK 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor: Përkthimi në një Monedhë Paraqitjeje Hiperinflacioniste (Ndryshimet)** - Ndryshimet janë në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 Janar 2027 ose më pas, me lejim të zbatimit më të hershëm. Ndryshimet kërkojnë përkthimin nga një monedhë funksionale jo-hiperinflacioniste në një monedhë të paraqitjes hiperinflacioniste me kursin e mbylljes. Ndryshimet nuk janë miratuar ende nga BE. Menaxhimi i ka vlerësuar ndryshimet dhe nuk ka ndikim në pasqyrat financiare.

5. PËRDORIMI I GJYKIMEVE, VLERËSIMEVE DHE SUPOZIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF kërkon nga drejtimi që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe shënimet shpjeguese, si dhe dhënien e shënimeve shpjeguese të detyrimeve të kushtëzuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rrethanat ekzistuese dhe supozimet për zhvillimet e ardhshme mund të ndryshojnë për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të Bankës dhe pasqyrohen në supozimet nëse dhe kur ato ndodhin. Drejtimi diskuton me Komitetin e Auditimit, zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kritike kontabël të Bankës dhe aplikimin e tyre, si dhe supozimet e bera në lidhje me paqartësitë kryesore të vlerësimit. Informacioni rreth pasigurisë së supozimeve dhe vlerësimeve që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material brenda vitit të ardhshëm financiar, dhe rreth gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare të veçanta është sqaruar më poshtë.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shih Shënimin 38).

5.1. Vlerësimi i modelit të biznesit

Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare varen nga rezultatet e testeve SPPI dhe vlerësimi i modelit të biznesit të Bankës. Banka përcakton modelin e biznesit në një nivel që reflekton mënyrën sesi grupe të aktiveve financiare menaxhohen së bashku për të arritur një objektiv të caktuar të biznesit. Ky vlerësim përfshin gjykime bazuar në të gjithë evidencat e vlefshme, duke përfshirë dhe mënyrën se si vlerësohet dhe raportohet performanca e aktiveve financiare, rreziqet që ndikojnë në performancën e këtyre aktiveve dhe, si menaxherët e aktiveve kompesohen. Banka monitoron aktivet financiare të matura me koston e amortizuar të cilat janë çregjistruar para datës së maturimit për të kuptuar arsyen e këtij çregjistrimi dhe nëse këto çregjistrime janë konsistente me objektivin e biznesit për të cilin është mbajtur ky aktiv. Shitjet e rastësishme të aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar afër maturitetit të tyre nuk konsiderohen si një ndryshim në këtë model biznesi. Një monitorim i tillë përbën pjesë të vlerësimit të vazhdueshëm të Bankës për të përcaktuar nëse modeli i biznesit mbetet i përshtatshëm. Kur ai nuk konsiderohet më i përshtatshëm, Banka përcakton nëse ka ndodhur një ndryshim në modelin e biznesit dhe, nëse po, zbaton riklasifikimin e kërkuar të aktiveve financiare në mënyrë prospektive.

5.2. Zhvlerësimi

Matja e humbjes nga zhvlerësimi nën SNRF 9 për të gjitha kategoritë e aktiveve financiare kërkon një gjykim të konsiderueshëm. Kjo përfshin vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve të arkëtimeve të pritshme, vlerave të kolateraleve si dhe përcaktimin nëse ka ndodhur një rritje e rëndësishme në rrezikun e kredisë. Këto vlerësime varen nga një numër faktorësh, ndryshimet e të cilëve mund të çojnë në nivele të ndryshme të fondeve të zhvlerësimit.

Përlllogaritjet për HPK që bën Banka janë rezultat i modeleve komplekse me një sërë supozimesh lidhur me përgjedhjen e inuteve të ndryshme dhe varësinë e tyre nga njëri-tjetri.

Gjykimet dhe vlerësimet kryesore kontabël brenda kuadrit të HPK përfshijnë:

- Kriteret e Bankës për identifikimin e një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë, përcaktimin se kur aktivet financiare duhet të kalojnë në bazën e matetjes si HPK përgjatë gjithë jetës, si dhe përdorimin e treguesve cilësorë,
- Segmentimi i aktiveve financiare kur HPK e tyre vlerësohet në baza kolektive,
- Zhvillimin dhe kalibrimin e modeleve për HPK, duke përfshirë formulat dhe përgjedhjen e inuteve të modelit,
- Përcaktimin e korelacioneve midis skenarëve makroekonomik dhe variablave ekonomike si rritja e PBB, dhe ndikimin e tyre në PM-të, EM-të dhe HM-të,
- Përgjedhjen dhe peshimin e skenarëve makroekonomik që pritet të ndodhin për të përcaktuar inputet ekonomike për t'u përdorur në modelet e HMK-së.

Vlerësimi nëse një investim në borxhin qeveritar është zhvlerësuar mund të jetë i veçanërisht i ndërlikuar. Në bërjen e një vlerësimi të tillë, Banka merr në konsideratë disa faktorë, përfshirë perceptimet e tregut mbi aftësinë kreditore të emetuesit të reflektuara në yield-in e obligacioneve, vlerësimet e kreditit të dhëna nga agjencitë e jashtme, aftësia e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për lëshimin e borxhit të ri, mundësinë e ristrukturimit të borxhit që mund të përfshijë humbje vullnetare ose të detyrueshme për mbajtësit e obligacioneve. Vlerësimi përfshin gjithashtu analizën e mekanizmave ndërkombëtare mbështetëse të disponueshëm si “huadhënës i fundit” synimet e deklaruara të qeverive ose institucioneve për përdorimin e këtyre mekanizmave, kapacitetin e tyre financiar dhe qëndrueshmërinë e këtyre marrëveshjeve

5. PËRDORIMI I GJYKIMEVE, VLERËSIMEVE DHE SUPOZIMEVE (VAZHDIM)

5.3. Vlera e drejtë

5.3.1. Vlera e drejtë e instrumentëve financiar

‘Vlera e drejtë’ e një instrumenti financiar është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në një treg primar në datën e matjes, nën kushtet aktuale të tregut, pavarësisht faktit nëse çmimi është drejtpërdrejt i kuotuar apo vlerësohet nëpërmjet teknikave të matjes. Kur vlera e drejtë e një aktivi financiar dhe detyrimit financiar të regjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të derivohet nga tregjet aktive, ajo përcaktohet duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi që përfshijnë përdorimin e modeleve të vlerësimit të përshkruara në Shënimin 37. Inputet në këto modele, aty ku munden, merren nga tregjet aktive, por në rastet kur këto nuk janë të mundshme, përcaktimi i vlerës së drejtë bëhet nëpërmjet vlerësimit. Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë transparencë të paktë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon shkallë të ndryshme të gjykimit në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik.

5.3.2. Vlera e drejtë e aktiveve jofinanciare

Vlera e drejtë e investimeve në pasuri të paluajtshme dhe Vlera neto e realizueshme e kolateraleve të sekuestruara përcaktohet nga vlerësues pasurie të jashtëm ose të brendshëm, të cilët kanë kualifikime të duhura të njohura profesionale dhe njohuritë e nevojshme të vendndodhjes dhe kategorisë të pronës që vlerësohet. Matja e vlerës së drejtë për të gjitha pronat në këto kategori, bazuar në teknikat e vlerësimit të përdorura (Shënimi 4.18), klasifikohen si Niveli 3 i vlerës së drejtë. Përveç vlerësimeve të pasurive disa vlerësime bëhen për të përcaktuar mundësinë e shitjes së aktiveve nën kategorinë e aktiveve të sekuestruara.

5.4. Përcaktimi i afatit të qirasë për kontratat me opsinin e rinovimit dhe të përfundimit para afatit (Banka si qiramarrëse)

Banka përcakton afatin e qirasë si periudha e paanullueshme e qirasë së bashku me periudhat e mbuluara nga një opsin për të zgjatur qiranë nëse ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë, ose periudhave të mbuluara nga një opsin për të përfunduar qiranë nëse ka sigurinë e arsyeshme për të mos e ushtruar atë. Banka ka disa kontrata që kanë opsionet për të zgjatur apo përfunduar afatin e qirasë. Banka bën gjykime gjatë vlerësimit nëse është e sigurt në mënyrë të arsyeshme nëse do të ushtrojë apo jo opsionet për të zgjatur apo përfunduar qiratë. Kjo do të thotë që konsideron të gjithë faktorët e rëndësishëm që krijojnë një nxitje ekonomike për Bankën për ushtruar ose rinovimin ose përfundimin. Pas datës së fillimit, Banka rivlerëson afatet e qirave nëse ka patur ndonjë ngjarje të rëndësishme ose ndryshim në rrethana që janë në kontrollin e saj që ndikojnë mundësinë e saj për të ushtruar ose jo opsinin e rinovimit apo përfundimit (psh. përmirësime të rëndësishme të ambientëve ose përshtatje të rëndësishme në aktivitet të marrë me qira).

5.5. Përcaktimi i normës rritëse të huamarrjes

Banka nuk mund të përcaktojë normën e interesit të nënkuptuar të qirasë, për këtë, ajo përdor normën rritëse të huamarrjes (‘IBR’) për të matur detyrimet për qiratë. IBR është norma e interesit që Banka do kishte paguar për të marrë hua në afate të ngjashme fondet e nevojshme për të përfituar një aktiv në vlerë të njëjtë me vlerën e aktivitet me të drejtë përdorimi në një ambient të ngjashëm ekonomik. Për këtë IBR reflekton atë çfarë Banka ‘do duhej të paguajë’, e cila kërkon një vlerësim kur mungojnë normat e vëzhgueshme në treg (si p.sh. për filialet që nuk hyjnë në transaksione financimi) ose kur ato do duhet të rregullohen për të reflektuar kushtet e qirasë (psh, kur qiraja është në monedhë të ndryshme nga ajo e normave të listuara). Banka vlerëson IBR duke përdorur inputet e vëzhgueshme (siç janë normat e interesit në treg) kur ato janë të mundshme dhe i duhet të bëjë disa rregullime specifike për to.

6. ARKA DHE LLOGARI ME BANKËN QENDRORE

Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Arka	3,769,869	2,943,230
<i>Banka Qendrore:</i>		
Llogari rrjedhëse	3,090,672	1,423,930
Rezerva e detyrueshme	7,467,830	6,540,939
Interesi i përlllogaritur	991	851
Fond për zhvlerësim	(11,854)	(10,178)
Totali	14,317,508	10,898,772

Rezerva e detyrueshme përfaqëson një minimum shumë të depozituar të mbajtur në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë.

Kjo rezervë nuk është për përdorim ditor, megjithatë bazuar në rregulloret e aplikueshme, gjatë muajit Banka mund të përdorë deri në 70% (2024:70%) të rezervës së detyrueshme në LEK, duke siguruar që gjendja mesatare mujore e llogarive me Bankën Qendrore (llogaritë rrjedhëse plus rezerva e detyrueshme) të mos jetë më poshtë së niveli i rezervës së detyrueshme. Kjo rezervë përlllogaritet si një përqindje mbi "bazën e rezervës". Baza e rezervës përfshin detyrimet që rrjedhin nga pranimi i fondeve nga Banka në lekë dhe në valutë të huaj. Baza e rezervës valutore përbëhet nga detyrimet në dollarë dhe euro, ku detyrimet në euro përfshijnë të gjitha detyrimet në monedha të tjera (përveç USD) të konvertuara me kursin fikse të Bankës së Shqipërisë. Normat e rezervës aplikohen në atë pjesë të bazës së rezervës ku maturimi fillestar nuk i kalon 24 muaj dhe janë të ndryshme në varësi të maturimit dhe monedhës së depozitave të klientëve. Raporti i rezervës është:

- 7.5% për depozitat në Lek të klientëve me një maturim fillestar deri në 12 muaj,
- 5.0% për depozitat në Lek të klientëve me një maturim fillestar mbi 12 muaj por deri në 24 muaj,
- 12.5% për depozitat në monedhë të huaj, kur raporti i “ Depozitave në monedhë të huaj me totalin e depozitave” është deri në 50%,
- 20% për depozitat në monedhë të huaj, kur raporti i “ Depozitave në monedhë të huaj me totalin e depozitave” është më i madh së 50%.

Një analizë e ndryshimeve në vlerën bruto dhe vlerat korresponduese të humbjeve të pritshme jepet më poshtë:

	Klasa 1	
	31 dhejtor 2025	31 dhejtor 2024
Vlera e mbartur bruto më 1 janar	10,908,950	14,939,340
Aktive të reja	3,617,565	965,386
Aktive të maturuar ose paguar	(6,847)	(4,403,591)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(190,306)	(592,185)
Vlera e mbartur bruto më 31 dhjetor	14,329,362	10,908,950
	Klasa 1	
	31 dhejtor 2025	31 dhejtor 2024
HPK më 1 janar	10,178	4,318
Aktive të reja	1,676	5,860
Aktive të maturuar ose paguar	-	-
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	-	-
HPK më 31 dhjetor	11,854	10,178

(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

7. DEPOZITA DHE LLOGARI ME BANKAT

Depozitat dhe llogaritë me bankat janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Llogari rrjedhëse:		
Rezidentë	-	7,641
Jo-rezidentë	606,489	1,698,358
	606,489	1,705,999
Depozita:		
Rezidentë	-	100,000
Jo-rezidentë	5,540,790	5,545,475
	5,540,790	5,645,475
Llogari të tjera (Jo-rezidentë)	463,635	317,429
Interesi i përlllogaritur	769	2,272
Zhvlerësimet për humbjet e pritshme	(1,655)	(7,333)
Totali	6,610,028	7,663,842

Llogari të tjera përfaqësojnë llogari te bllokuara (“escrow”) në bankë të cilat përdoren si kolateral për garancitë e lëshuara.

Të gjithë aktivet në depozita dhe llogari me bankat janë në Klasën 1 dhe nuk ka patur transferime ndërmjet klasave që nga fillimi i periudhës krahasuese. Një analizë e ndryshimeve në vlerën bruto dhe vlerat korresponduese të humbjeve të pritshme jepet më poshtë:

	Klasa 1	
	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Vlera e mbartur bruto më 1 janar	7,671,175	2,527,744
Aktive të reja	2,174,839	6,741,209
Aktive të çregjistruar ose paguar	(3,077,783)	(1,514,508)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(156,548)	(83,270)
Vlera e mbartur bruto më 31 dhjetor	6,611,683	7,671,175

	Klasa 1	
	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
HPK më 1 janar	7,333	27,755
Aktive të reja	518	7,010
Aktive të çregjistruar ose paguar	(6,150)	(27,398)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(46)	(34)
HPK më 31 dhjetor	1,655	7,333

8. INVESTIME NË LETRA ME VLERË

Më poshtë jepet një analizë e letrave me vlerë të Bankës të matura me VDFH, VDATGJ dhe me kosto të amortizuar

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Instrumentë borxhi me VDFH:		
Bonde të qeverisë Shqiptare mbajtur për tregtim	42,215	59,702
Totali i instrumentëve me VDFH	42,215	59,702
Instrumentë borxhi me VDATGJ:		
Bonde të qeverisë Shqiptare	2,125,930	1,485,468
Bonde korporative	22,510	-
Totali i instrumentëve me VDATGJ	2,148,440	1,485,468
Instrumentë borxhi me kosto të amortizuar:		
Bono Thesari Shqiptare	1,375,585	1,166,641
Bonde të qeverisë Shqiptare	28,521,305	27,079,765
Bonde të qeverive të huaja	2,498,230	2,365,026
Bonde korporative	2,935,393	2,815,500
Zhvlerësimet për humbjet e pritshme	(153,486)	(134,536)
Totali i instrumentëve me kosto të amortizuar	35,177,027	33,292,396

Instrumente borxhi të mbajtura për tregtim janë bonde të qeverisë Shqiptare të blera nga Banka. Vlera nominale e këtyre instrumenteve është 56,600 mijë Lekë (2024: 56,600 mijë lekë). Banka nuk shiti asnjë pjesë të portofolit të mbajtur për tregtim.

Gjatë vitit 2025, Banka shiti 777.9 milionë Lekë (2024: 583.6 milionë Lekë) letra me vlerë investimi VDATGJ dhe si rezultat u bë një transferim prej 27,813 mijë Lekë (2024: 31,192 mijë Lekë) nga fitimet e porealizuara nga ATGJ (të ardhura të tjera gjithpërfshirëse) në pasqyrën e të ardhurave.

Detajet e këtyre instrumentëve më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 prezantohen më poshtë:

	31 dhjetor 2025				
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interes i përlogaritur	Efekti i rivlerësimit	Vlera kontabël
Qeveria Shqiptare	2,063,013	9,821	29,153	23,943	2,125,930
Bonde korporative	20,753	1,729	140	(112)	22,510
Totali	2,083,766	11,550	29,293	23,831	2,148,440
	31 dhjetor 2024				
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interes i përlogaritur	Efekti i rivlerësimit	Vlera kontabël
Qeveria Shqiptare	1,467,635	1,794	16,434	(395)	1,485,468
Totali	1,467,635	1,794	16,434	(395)	1,485,468

Banka më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 nuk kishte instrumentë borxhi të matura me VDATGJ të cilat të ishin përdorur si kolateral.

Bonot e Thesarit të emtuar nga qeveria Shqiptare sipas maturimit fillestar paraqiten si më poshtë. Vlera kontabël është kosto e amortizuar.

	31 dhjetor 2025			31 dhjetor 2024		
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Vlera kontabël	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Vlera kontabël
6 muaj	-	-	-	-	-	-
12 muaj	1,386,980	(11,395)	1,375,585	1,181,780	(15,139)	1,166,641
Totali	1,386,980	(11,395)	1,375,585	1,181,780	(15,139)	1,166,641

8. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (VAZHDIM)

Bondet me kosto të amortizuar tregohen më poshtë sipas entitetit emetues. Interesi paguhet çdo gjashtë muaj dhe çdo vit.

	31 dhjetor 2025			Vlera bruto
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interes i përlllogaritur	
Qeveria Shqiptare	28,038,682	(36,654)	519,277	28,521,305
Qeveri të huaja	2,477,936	(14,166)	34,460	2,498,230
Korporatat	2,922,651	(13,813)	26,555	2,935,393
Totali	33,439,269	(64,633)	580,292	33,954,928

	31 dhjetor 2024			Vlera bruto
	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interes i përlllogaritur	
Qeveria Shqiptare	26,693,450	(87,018)	473,333	27,079,765
Qeveri të huaja	2,363,261	(20,863)	22,628	2,365,026
Korporatat	2,821,614	(21,435)	15,321	2,815,500
Totali	31,878,325	(129,316)	511,282	32,260,291

Banka ka vendosur si kolateral letrat me vlerë për marrëveshjet e riblerjes me Bankën e Shqipërisë në vlerën 12,855,400 mijë Lekë (2024: 10,886,000 mijë Lekë).

Letrat me vlerë të investimit të matur me koston e amortizuar janë vlerësuar si më poshtë:

Vlerësimet e kompanisë Moody's ose të njëvlefshme	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Qeveria Shqiptare	28,521,305	27,079,765
Vlerësimi Ba3 (në euro)	3,547,652	3,802,230
I pavlerësuar	24,973,653	23,277,535
Qeveri të huaja	2,498,230	2,365,026
Vlerësimi Aa1	480,242	586,546
Vlerësimi Aa2	161,520	-
Vlerësimi Aa3	183,910	237,403
Vlerësimi A1	317,875	-
Vlerësimi A2	95,922	364,954
Vlerësimi A3	312,352	384,697
Vlerësimi Baa1	98,410	-
Vlerësimi Baa2	125,463	128,129
Vlerësimi Baa3	389,047	252,442
Vlerësimi Ba2	137,172	135,150
Vlerësimi Ba3	196,317	205,157
Vlerësimi B1	-	70,548
Korporata	2,935,393	2,815,500
Vlerësimi Aaa	1,005,546	1,223,667
Vlerësimi Aa2	24,853	28,429
Vlerësimi Aa3	203,339	315,536
Vlerësimi A1	577,902	185,582
Vlerësimi A2	139,629	182,228
Vlerësimi A3	343,831	293,819
Vlerësimi Baa1	476,313	386,843
Vlerësimi Baa2	147,137	179,896
Vlerësimi Baa3	16,843	19,500
Totali	33,954,928	32,260,291

(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (VAZHDIM)

Letrat me vlerë me koto te amortizuar janë grupuar me poshte sipas vendit emetues:

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Qeveria Shqiptare	28,521,305	27,079,765
Qeveri të huaja	2,498,230	2,365,026
Evropë	1,482,138	1,785,141
Azia dhe Paqësori	125,463	29,807
Lindje e Mesme	479,395	122,913
Amerika e Jugut	328,807	189,762
Amerika e Veriut	82,427	237,403
Korporata	2,935,393	2,815,500
Evropë	1,387,042	1,415,970
Amerika e Veriut	1,036,399	620,162
Azia dhe Paqësori	453,787	687,167
Lindje e Mesme	58,165	92,201

Të gjitha letrat me vlerë të investimit janë në Klasën 1 dhe nuk ka transferime ndërmjet klasave që nga fillimi i periudhave krahasuese.

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e drejtë për Letrat me vlerë të mbajtura me VDFH paraqitet më poshtë:

	Klasa 1	
	2025	2024
Vlera e drejtë më 1 janar	59,702	55,833
Aktive të reja	-	-
Aktive të maturuar ose paguar	-	-
Ndryshime në Vlerën e drejtë	(17,487)	3,869
Transferime ndërmjet Klasave	-	-
Vlera e drejtë më 31 dhjetor	42,215	59,702

Një analizë e ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe vlerat korresponduese të humbjeve të pritshme për Instrumentet e borxhit të matura me VDATGJ jepet më poshtë:

	Klasa 1	
	2025	2024
Vlera e drejtë më 1 janar	1,485,468	1,061,589
Aktive të reja	1,415,819	959,945
Aktive të maturuar ose paguar	(786,192)	(594,336)
Ndryshime në Vlerën e drejtë	23,869	74,433
Shuma të fshira	-	-
Interesa të përlllogaritur	18,557	18,749
Efekt i ndryshimit të kursit të këmbimit	(9,081)	(34,912)
Vlera e drejtë më 31 dhjetor	2,148,440	1,485,468

	Klasa 1	
	2025	2024
HPK më 1 janar	6,732	3,183
Aktive të reja	3,693	2,538
Aktive të çregjistruar, paguar ose të fshira	(477)	(385)
Transferime ndërmjet Klasave	-	-
Rimatje neto e HPK	490	1,505
Efekt i ndryshimit të kursit të këmbimit	(44)	(109)
HPK më 31 dhjetor	10,394	6,732

(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (VAZHDIM)

Një analizë e ndryshimeve në vlerën bruto dhe vlerat korresponduese të humbjeve të pritshme për Instrumentet e borxhit të matura me koston e amortizuar jepet më poshtë:

	Klasa 1	
	2025	2024
Vlera e mbartur bruto më 1 janar	33,426,932	32,057,397
Aktive të reja	11,509,324	10,343,819
Aktive të maturuar ose paguar	(9,258,167)	(8,612,366)
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(347,576)	(361,918)
Vlera e mbartur bruto më 31 dhjetor	35,330,513	33,426,932

	Klasa 1	
	2025	2024
HPK më 1 janar	134,536	80,168
Aktive të reja	44,621	33,250
Aktive të maturuar ose paguar	(33,292)	(14,603)
Rimatja neto e HPK	8,050	36,469
Shuma të fshira	-	-
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(429)	(748)
HPK më 31 dhjetor	153,486	134,536

9. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT

Hua dhe paradhënie për klientët detajohen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Hua dhe paradhënie	61,364,962	52,692,401
Interesa të përlogaritur	250,306	248,628
Të ardhura të shtyra pjesë e NEI	(325,817)	(306,405)
Vlera Bruto	61,289,451	52,634,624
Zhvlerësimet për humbjet e pritshme	(2,402,395)	(2,266,027)
Totali	58,887,056	50,368,597

Tabela më poshtë tregon levizjen në humbjet e pritshme (HPK):

	2025	2024
HPK më 1 janar	2,266,027	2,034,929
Shtesat gjatë vitit	558,564	369,975
Shuma të fshira	(401,331)	(74,136)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(20,865)	(64,741)
HPK më 31 dhjetor	2,402,395	2,266,027

Huatë dhe paradhëniet për klientët fitojnë interesa me normat si më poshtë:

Monedha	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
LEK	3.60% - 25.0% në vit	3.90% - 25.0% në vit
EUR	2.70% - 19.5% në vit	3.00% - 19.0% në vit
USD	6.50% - 8.7% në vit	7.00% - 9.82% në vit

Banka ka dhënë disa hua me norma interesi nën nivelet më të ulta të treguara më lart, të cilat janë nën normat që janë ofruar në përgjithësi nga Banka, të cilat janë të mbrojtura me kolateral.

9. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Huatë e dhëna personelit të Bankës më 31 dhjetor 2025 janë 1,134,960 mijë Lekë (2024 : 951,363 mijë Lekë) dhe mbartin norma interesi vjetore që janë 1.8% deri në 3.4% nën normat e ofruara klientëve të saj per kredite me hipotekë dhe konsumatore.

Banka ka dhënë hua për institucione financiare rezidentë. Këto kredi maturohen një periudhë nga 1 në 10 vite (2024: 1 deri 5 vjet) dhe mbartin interesa që variojnë nga 2.7% deri në 17.0% në vit. (2024: 3.3% deri në 10.0% në vit).

Kredia sipas klientëve dhe produkteve paraqitet më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2025		
	Vlera e mbartur bruto	Fondi HPK	Vlera neto
Klientët individë			
Kredi me hipotekë	16,095,001	(144,712)	15,950,289
Kredi konsumatore	11,203,578	(543,687)	10,659,891
Overdraft dhe karta	557,903	(61,052)	496,851
Kredi për individë	27,856,482	(749,451)	27,107,031
Kredi për biznese	33,432,969	(1,652,944)	31,780,025
Totali	61,289,451	(2,402,395)	58,887,056

	Më 31 dhjetor 2024		
Më 31 dhjetor 2024

	Shërbime financiare	Qeveria	Individë	Shitje me pakicë dhe shumicë	Ndërtim	Shërbime	Agrikulturë dhe industria përpunuese	Totali
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	10,898,772	-	-	-	-	-	-	10,898,772
Depozita dhe llogari me bankat	7,663,842	-	-	-	-	-	-	7,663,842
Letra me vlerë investimi	2,162,873	32,023,858		28,383		249,132	373,320	34,837,566
Hua dhe paradhënie për klientet								
<i>Kredi për biznese</i>	5,155,619	-	-	5,009,295	5,009,452	8,239,493	3,263,035	26,676,894
<i>Kredi konsumatore</i>	-	-	9,341,173	-	-	-	-	9,341,173
<i>Overdraft dhe karta</i>	-	-	426,426	-	-	-	-	426,426
<i>Kredi me hipotekë</i>	-	-	13,924,104	-	-	-	-	13,924,104
Totali i huave dhe paradhënieve	5,155,619	-	23,691,703	5,009,295	5,009,452	8,239,493	3,263,035	50,368,597
	25,881,106	32,023,858	23,691,703	5,037,678	5,009,452	8,488,625	3,636,355	103,768,777
Garancitë financiare	15,540	-	1,650	284,076	186,666	124,741	5,298	617,971
Letër kreditë	-	-	-	-	-	-	12,879	12,879
Angazhime për kredi	334,092	-	820,381	601,665	249,034	309,748	333,302	2,648,222
	349,632	-	822,031	885,741	435,700	434,489	351,479	3,279,072
Totali	26,230,738	32,023,858	24,513,734	5,923,419	5,445,152	8,923,114	3,987,834	107,047,849

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**38.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)****38.1.4 Analiza e përqendrimeve të rreziqeve (vazhdim)**

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë administrohet gjithashtu pjesërisht nga marrja e kolateraleve dhe garancive. Llojet kryesore të kolateraleve janë:

- Prona hipotekore ose rezidenciale
- Pengje mbi aktivet dhe inventaret e bizneseve
- Depozita dhe llogari të vendosura në bankë (kolateral në mjete monetare)
- Garanci personale për kredinë
- Skemat e ndarjes së rrezikut kreditor (risk sharing)

Përveç kredive me afat dhe overdrafteve të biznesit që janë siguruar nga llojet e mesipërme të kolateralit, Banka jep gjithashtu overdrafte në llogaritë e pagës për individët. Për sa kohë që pagesat mujore të pagave kompensojnë pjesën e përdorur të limitit të dhënë për këto lloj paradhëniesh nuk merren pengje. Garancitë financiare dhe letrat në pritje të kredisë janë të kolateralizuara pasuri të paluajtshme dhe/ose mjete monetare.

Kredi dhe paradhënie të zhvlerësuara

Kreditë dhe paradhëniet të zhvlerësuara janë kredi dhe paradhënie për të cilat Banka përcakton së është e mundshme së ajo do jetë e paaftë të mbledhë tërë principalin dhe interesat sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes(ve) të kredisë.

Kredi në vonesë por jo të zhvlerësuara

Kreditë dhe paradhëniet për të cilat interesi kontraktual ose pagesat e principalit janë në vonesë, por Banka beson së zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/ kolateralit të vlefshëm, dhe/ ose fazës së mbledhjes së shumave në detyrim të klientit karshi Bankës.

Kreditë me kushte të rinegociueshme

Kreditë me kushte të rinegociueshme janë kredi që janë ristrukturuar si pasojë e përkeqësimit të pozitive financiare të klientit dhe për të cilat Banka ka bërë lëshime të cilat përndryshe nuk do t'i kishte konsideruar. Në momentin që kredia është ristrukturuar, ajo qëndron në këtë kategori pavarësisht nga performanca e kënaqshme eventuale pas ristrukturimit.

Fondet rezervë për zhvlerësim

Banka vendos një fond rezervë për humbjet nga zhvlerësimet e kredive që përfaqësojnë vlerësimin e nivelit të humbjeve të pësuar në portofolin e saj të kredisë. Kjo ka të bëjë me përbërësit specifikë të humbjes që u takojnë ekspozimeve individualisht domethënëse.

Kredi dhe paradhënie të zhvlerësuara

Kreditë dhe paradhëniet e zhvlerësuara përpara marrjes në konsideratë të fluksit të mjeteve monetare nga kolaterali i mbajtur është 2,828,609 mijë Lekë (2024: 2,972,768 mijë Lekë).

Më poshtë jepet thyerja e vlerës së mbartur të kredive dhe paradhënieve të zhvlerësuar sipas kategorive së bashku me vlerën e drejtë të kolateralit të marrë nga Banka për të siguruar këto kredi:

Më 31 dhjetor 2025

	Portofol i mbikolateralizuar		Portofol i nënkolateralizuar	
	Kredi të zhvlerësuara	Vlera e drejtë e kolateralit	Kredi të zhvlerësuara	Vlera e drejtë e kolateralit
Kredi me hipotekë	317,572	827,674	16,175	1,139
Kredi konsumatore	202,562	614,443	326,953	-
Overdrafte dhe karta	403	511	36,220	23
Kredi për biznese	1,737,814	4,836,619	190,910	9,983
Totali	2,258,351	6,279,247	570,258	11,145

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**38.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)****38.1.4 Analiza e përqëndrimeve të rreziqeve (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2024	Portofol i mbikolateralizuar		Portofol i nënkolateralizuar	
	Kredi të zhvlerësuar	Vlera e drejtë e kolateralit	Kredi të zhvlerësuar	Vlera e drejtë e kolateralit
Kredi me hipotekë	340,281	1,094,390	23,010	-
Kredi konsumatore	115,884	581,825	307,446	-
Overdrafte dhe karta	1,214	1,155	44,655	6
Kredi për biznese	1,999,860	8,261,357	140,418	8,769
Totali	2,457,239	9,938,727	515,529	8,775

Kredi dhe paradhënie të ristrukturuara

Veprimtaritë ristrukturoese përfshijnë marrëveshje pagesash me shtyrje afati, modifikimin dhe shtyrjen e pagesave. Në vijim të ristrukturimit, një kredi që më herët ishte në vonesë rivendoset në status normal dhe menaxhohet së bashku me kredi të tjera të ngjashme. Portofoli total i ristrukturuar gjatë vitit 2025 është 491,680 mijë Lekë (2024: 476,055 mijë Lekë). Në vitet e fundit, menaxhimi ka vendosur të rrisë ristrukturimin për kreditë e disa huamarrësve të cilët kishin vështirësi financiare me ndikime negative në flukset e parasë, ndërkohë që ristrukturimi pritet të rrisë mundësitë që huamarrësi të jetë në gjendje të paguajë detyrimin e tij dhe planpagesa e re të jetë në përputhje me kapacitetin pagues aktual dhe të pritshëm të huamarrësit.

Politikat e fshirjes

Banka fshin një kredi/ balancën e letrave me vlerë (dhe çdo provigjion përkatës për humbjet nga zhvlerësimi) nëpërmjet një vendimi Bordi, kur Komiteti respektiv vendos se kreditë/ letrat me vlerë janë të pambledhshme. Ky vendim arrihet pas konsiderimit të të dhënave si ndodhja e ndryshimeve domethënëse në pozitën financiare të huamarrësit/ lëshuesit është e tillë që huamarrësi/ lëshuesi nuk mundet më të paguajë detyrimin, ose si të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme të mbulojnë tërë ekspozimin. Totali i shumës së fshirë gjatë 2025, është 401,331 mijë Lekë (2024: 74,136 mijë Lekë).

Banka mban kolaterale si garanci për kredi dhe paradhënie për klientet në formën e bllokimeve hipotekore mbi pasuri të patundshme, regjistrimin si pengje në zyrat përkatëse të pajisjeve / mjeteve, dhe garancive. Vlerësimi i vlerës së drejtë behet mbi vlerësimin e kolateralit në momentin e huamarrjes, dhe zakonisht nuk përditësohet, përveç rasteve kur kredia individualisht vlerësohet për zhvlerësim. Zakonisht nuk mbahet kolateral për kredi dhe paradhënie ndaj bankave, përveç rasteve kur letrat me vlerë mbahen si pjesë e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes dhe aktiviteti i huamarrjes së letrave me vlerë.

Më poshtë jepet struktura e kolateralit për kredi në Klasa të ndryshme:

31 dhjetor 2025	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Totali
Pasuri të patundshme	94,464,140	5,101,731	4,860,522	104,426,393
Pengje	23,167,433	3,510,476	1,426,793	28,104,702
Mjete monetare	2,635,863	42,439	3,077	2,681,379
Totali	120,267,436	8,654,646	6,290,392	135,212,474

31 dhjetor 2024	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Totali
Pasuri të patundshme	72,216,706	5,766,224	5,445,632	83,428,562
Pengje	21,541,444	1,015,093	4,493,659	27,050,196
Mjete monetare	2,590,800	896	8,211	2,599,907
Totali	96,348,950	6,782,213	9,947,502	113,078,665

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**38.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)****38.1.4 Analiza e përqendrimeve të rreziqeve (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme tregon ndarjen e vlerës së kredive dhënë klientëve dhe institucioneve financiare sipas mbulimit të tyre me kolateral:

31 dhjetor 2025	Portofol i mbikolateralizuar		Portofol i nënkolateralizuar	
	Vlera e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit
Kredi me hipotekë	14,793,261	37,377,235	1,301,740	570,432
Kredi konsumatore	5,925,728	14,369,009	5,277,850	292,733
Overdrafte dhe karta	816	926	557,087	96,222
Kredi për biznese	27,962,957	80,583,250	5,470,012	1,922,667
Totali	48,682,762	132,330,420	12,606,689	2,882,054

31 dhjetor 2024	Portofol i mbikolateralizuar		Portofol i nënkolateralizuar	
	Vlera e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit
Kredi me hipotekë	13,129,487	32,214,029	955,499	382,531
Kredi konsumatore	4,975,687	12,568,672	4,877,238	319,234
Overdrafte dhe karta	1,919	1,861	494,544	87,388
Kredi për biznese	22,984,741	65,328,541	5,215,509	2,176,409
Totali	41,091,834	110,113,103	11,542,790	2,965,562

38.2 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka të ndeshet me vështirësi për të siguruar fonde dhe për të plotësuar detyrimet që burojnë nga instrumentat financiare, dhe në përgjithësi për të ruajtur vazhdimësinë e linjave thelbësore të biznesit. Në bazë operative, Banka monitoron depozitat e klientëve të saj, dhe kështu korrigjon gjendjet dhe aksesin ndaj fondeve të aktiveve të saj korrentë, në mënyrë që të mbajë një kapacitet të kenaqshëm pagesash. Bazuar në këtë monitorim, Banka përshtat strukturën e saj të aktiveve - pasiveve dhe aksesin në fonde në mënyrë që të ruajë një rezervë të mjaftueshme likuiditeti për të përmbushur detyrimet e saj, në përputhje me limitet e brendshme dhe rregullatore të përcaktuara. Në një nivel me strategjik, Banka nëpërmjet Komitetit të Menaxhimit të Aktiveve dhe Pasiveve ("KMAP") menaxhon këtë rrezik duke monitoruar vazhdimisht flukset e pritshme të parasë prej instrumenteve financiare dhe axhustuar investimet e veta për të sinkronizuar momentet e pagesave dhe arkëtimeve.

Çdo degë operative është subjekt i limiteve të vendosura të likuiditetit dhe është përgjegjëse për menaxhimin e likuiditetit të saj brenda këtyre limiteve, në koordinim me Njësinë e Administrimit të Parasë (Departamenti i Operacioneve), e cila menaxhon procesin e transferimit të parave brenda degëve të Bankës. Kjo njësi monitoron gjithashtu në bazë ditore përputhshmërinë e çdo dege operative me limitet e vendosura dhe siguron menaxhimin e niveleve të përshtatshme të rezervave për të mbështetur degët e Bankës kur/nëse nevojitet.

Të gjitha politikat, kufijtë e oreksit për rrezik dhe strategjia e menaxhimit të likuiditetit i nënshtrohen rishikimit nga KMAP dhe miratohen çdo vit nga Këshilli Drejtues. Raportime ditore bëhen për të matur likuiditetin e degëve operative dhe Bankës në tërësi.

Banka mbështetet kryesisht në depozitat e klientëve si burimi kryesor i financimit, ndërsa përdor gjithashtu, marrëveshje repo dhe huamarrije afatshkurtra. Natyra afatshkurtër e një pjese të madhe të këtyre fondeve rrit rrezikun e likuiditetit të Bankës dhe Banka e menaxhon këtë rrezik nëpërmjet mbajtjes nivelit të nevojshëm të likuiditetit, shoqëruar me çmime konkurruese, përputhjes ndërmjet hyrjeve dhe daljeve të flukseve monetare sipas natyrës së tyre, dhe monitorimit të vazhdueshëm të prirjeve të tregut.

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

38.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Një nga mjetet kryesore të monitorimit të përdorura nga Banka për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit është raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, i llogaritur çdo ditë për monedhat vendase dhe të huaja, si dhe në total. Këto raporte llogariten sipas kuadrit rregullator të Bankës Qendrore, dhe Banka ka qenë në përputhje me të gjatë gjithë viteve 2025 dhe 2024, si dhe në fund të vitit.

Për të menaxhuar rrezikun e likuiditetit që vjen nga detyrimet financiare, Banka mban aktive likuide duke përfshirë dhe paranë dhe ekuivalentet e saj dhe letrat me vlerë, për të cilat ka një treg aktiv likuid. Këto aktive mund të shiten në rast nevoje për të arritur kërkesat për likuiditet. Banka ruan likuiditetin në një nivel, strukturë dhe raporte që i lejojnë asaj të përmbushë detyrimet dhe angazhimet e saj sipas maturimeve të tyre, si dhe të mbështesë rritjen e buxhetuar të aktivitetit të saj, me një kosto të arsyeshme dhe brenda nivelit të rrezikut të ndërmarrë nga Banka. Banka gjithashtu monitoron vazhdimisht, merr vendimet për investime bazuar në dhe në përputhje me nivelet rregullatore të vendosura për raportin e mbulimit me likuiditet (LCR). LCR përlllogaritet si raporti i aktiveve me cilësi të larta likuide me flukset dalëse neto të pritshme në 30 ditët e mëpasshme kalendarike.

Funksioni i monitorimit dhe kontrollit të investimeve të Bankës kryhet nëpërmjet KMAP. Politikat e KMAP përfshijnë sete raportësh ditore, javore dhe mujore që përgatiten dhe analizohen. Raportet mujore përfshijnë tregues të likuiditetit si raporti i Aktiveve Likuide ndaj Detyrimeve Afatshkurtra, nivelin e LCR, NSFR, analiza të Hendekut të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të Bankës dhe disa skenarë të stress-testimit të aplikuar mbi treguesit e likuiditetit, përfshirë identifikimin e periudhës së mbijetesës në skenarë të ndryshëm krize, si dhe Pozicionin Neto të Likuiditetit. Raportet përgatiten për secilën monedhë të rëndësishme veçmas (p.sh. LEK dhe EUR), si edhe për monedhat e kombinuara. Kufij specifikë për likuiditetin përcaktohen dhe monitorohen në baza mujore dhe ditore.

Si pjesë e një kuadri të plotë të administrimit të rrezikut të likuiditetit, Banka ka vendosur Planin e Financimit të Vazhdueshëm, i cili përcakton ngjarjet nxitëse dhe plane të detajuara veprimi, të cilat përfshijnë masat që duhen marrë dhe përgjegjësitë, për të menaxhuar çdo krizë likuiditeti që Banka mund të hasë. Gjithashtu, , plani përfshin treguesit e rrezikut të likuiditetit dhe pragjet përkatëse të Planit të Rimëkëmbjes, bazuar në kërkesat specifike rregullatore të Bankës së Shqipërisë. Të dy planet e tilla janë pjesë e rishikimit vjetor nga KMAP dhe i nënshtrohen miratimit të Këshillit Drejtues.

Banka ndjek një qasje të kujdesshme lidhur me cilësinë e investimeve, duke siguruar gjithashtu menaxhimin e përshtatshëm të niveleve të likuiditetit nëpër degë dhe në përputhje me nevojat e klientëve.

Union Bank sh.a**Shënime për pasqyrat financiare të vecanta me dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025***(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)***38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****38.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Më poshtë jepet një analizë të flukseve të paskontuara (përfshihen interesat sipas kontratave deri në maturim të instrumentëve) sipas maturimit të mbetur kontraktual të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës:

31 dhjetor 2025	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Aktivet							
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	8,116,158	-	-	-	-	-	8,116,158
Depozita dhe llogari me bankat	6,149,289	-	-	231,181	72,674	159,780	6,612,924
Letra me vlerë investimi	1,998,021	2,646,373	1,431,923	2,613,415	23,079,963	13,939,020	45,708,715
Hua dhe paradhënie për klientët	1,797,785	2,839,239	4,608,303	9,435,113	33,979,017	24,174,856	76,834,313
Tatim fitim i parapaguar	8,174	-	-	-	-	-	8,174
Aktive të tjera	328,084	1,758	2,637	5,274	29,775	-	367,528
Totali i aktiveve financiare të paskontuara	18,397,511	5,487,370	6,042,863	12,284,983	57,161,429	38,273,656	137,647,812
Detyrimet							
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	10,246,576	51,459	-	-	-	-	10,298,035
Detyrime bankave e institucioneve financiare	4,075,919	224,754	281,768	778,406	1,211,034	310,910	6,882,791
Detyrime ndaj klientëve	44,224,578	4,630,654	5,301,195	16,477,253	17,488,591	5,513	88,127,784
Detyrime për qira	18,379	36,758	54,760	115,328	561,550	84,395	871,170
Detyrime të tjera	432,303	1,162	580	1,160	4,058	-	439,263
Borxhi i varur	-	217,055	25,512	45,882	1,166,805	1,043,790	2,499,044
Totali i detyrimeve financiare të paskontuara	58,997,755	5,161,842	5,663,815	17,418,029	20,432,038	1,444,608	109,118,087
Aktive dhe detyrime financiare të paskontuara, neto	(40,600,244)	325,528	379,048	(5,133,046)	36,729,391	36,829,048	28,529,725

Është në natyrën e aktiviteteve të Bankës, veçanërisht kur financohen nga fondet e klientëve, të marrë hua afatshkurtër dhe afatmesme dhe të investojë në terma më të gjatë. Duke qenë se shumica e depozitave qarkullojnë tradicionalisht, hendeku i mbetur i likuiditetit është vetëm një tregues, por nuk pasqyron rrezikun e likuiditetit të Bankës. Siç u shpjegua në detaje më sipër, Banka ka të gjitha mjetet për të monitoruar dhe menaxhuar likuiditetin sipas monedhës, bazuar në maturimin kontraktual dhe të pritshëm, dhe është vazhdimisht brenda kufijve rregullatore dhe të brendshme të likuiditetit.

Union Bank sh.a

Shënime për pasqyrat financiare të vecanta me dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

38.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
31 dhjetor 2024							
Aktivët							
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	5,346,343	-	-	-	-	-	5,346,343
Depozita dhe llogari me bankat	7,359,972	-	-	186,485	9,426	121,518	7,677,401
Letra me vlerë investimi	1,219,404	3,668,408	1,584,094	3,125,462	19,689,237	11,244,054	40,530,659
Hua dhe paradhënie për klientët	1,977,561	3,048,714	3,742,135	8,723,962	29,513,103	20,420,965	67,426,440
Aktive të tjera	147,214	1,783	2,674	5,349	40,897	-	197,917
Totali i aktiveve financiare të paskontuara	16,050,494	6,718,905	5,328,903	12,041,258	49,252,663	31,786,537	121,178,760
Detyrimet							
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	9,596,975	-	-	-	-	-	9,596,975
Detyrime bankave e institucioneve financiare	4,073,494	225,366	299,931	1,200,555	1,234,492	40,000	7,073,838
Detyrime ndaj klientëve	39,720,441	4,321,375	4,652,696	13,001,668	17,197,987	1,430	78,895,597
Detyrime për qira	16,735	33,316	58,121	105,984	611,125	108,986	934,267
Detyrime të tjera	774,202	3,362	1,120	1,398	6,474	-	786,556
Borxhi i varur	-	23,850	8,330	32,181	915,827	900,011	1,880,199
Detyrime tatimore	-	18,291	-	-	-	-	18,291
Totali i detyrimeve financiare të paskontuara	54,181,847	4,625,560	5,020,198	14,341,786	19,965,905	1,050,427	99,185,723
Aktive dhe detyrime financiare të paskontuara, neto	(38,131,353)	2,093,345	308,705	(2,300,528)	29,286,758	30,736,110	21,993,037

Union Bank sh.a**Shënime për pasqyrat financiare të vecanta me dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025***(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)***38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****38.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Tabela më poshtë tregon maturimin kontraktual të angazhimeve të Bankës. Çdo angazhim për kredi është përfshirë në datën më të afert në të cilën ai mund të tërhiqet. Për garancitë financiare të lëshuara, vlera maksimale e garancisë është alokuar në periudhën me të parë në të cilën ajo mund të ekzekutohet.

31 dhjetor 2025	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Garancitë financiare	3,300	123,073	47,007	282,362	233,757	9,366	698,865
Letër kredi	-	-	-	-	-	-	-
Angazhime të tjera për kredi	875,959	176,733	628,688	2,522,560	454,739	-	4,658,679
Totali i garancive dhe angazhimeve	879,259	299,806	675,695	2,804,922	688,496	9,366	5,357,544

31 dhjetor 2024	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Garancitë financiare	3,613	155,163	53,080	241,979	158,967	9,366	622,168
Letër kredi	-	-	13,222	-	-	-	13,222
Angazhime të tjera për kredi	53,705	107,847	644,594	1,435,861	406,215	-	2,648,222
Totali i garancive dhe angazhimeve	57,318	263,010	710,896	1,677,840	565,182	9,366	3,283,612

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

38.3 Rreziku i tregut

Banka ekspozohet ndaj rreziqeve të tregut sa herë që vlera e tregut ose flukset e ardhme të parasë të një instrumenti financiar luhatet si pasojë e ndryshimeve në çmimet e tregut. Rreziqet e tregut burojnë nga pozicione të hapura të bilancit në norma interesi dhe monedha, të cilat janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe të veçanta të tregut, si dhe ndaj ndryshimeve në nivelin e volatilitetit të normave ose çmimeve të tregut si norma e interesit, marzhet e kredisë, dhe kurset e këmbimit të valutave.

Rreziku i monedhës së huaj

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhave nepërmjet transaksioneve në valuta të huaja. Rreziku i monedhës së huaj është rreziku sipas të cilit vlera e instrumentit financiar të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kursin e këmbimit në treg. Banka përpiqet ta administrojë rrezikun duke mbyllur pozicionet e hapura valutore ditore dhe duke vendosur dhe monitoruar limite mbi pozicionet e hapura dhe kufijtë e humbjes maksimale. Monedha e paraqitjes së pasqyrave financiare të Bankës është LEK, në këtë mënyrë ato janë të ndikuara nga lëvizjet në kurset e këmbimit valutor midis monedhës LEK dhe monedhave të tjera. Ekspozimet e transaksioneve të Bankës çojnë në humbje ose fitime nga valutat e huaja që njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Departamenti i Thesarit është përgjegjësi kryesor dhe linja e parë e kontrollit për monitorimin dhe mbikëqyrjen e përditshme të këtij rreziku, veçanërisht në lidhje me ruajtjen e limiteve të përcaktuara në politikat përkatëse. Funkcionet e monitorimit dhe të kontrollit të rrezikut të monedhës kryhen nga Departamenti i Rrezikut mbi baza ditore dhe është pjesë e përgjegjësisë të KMAP. Politika e KMAP përfshin një set të raportëve ditore të cilat përgatitën dhe analizohen. Banka ka vendosur limite të brendshme për pozicionin e hapur valuator të cilat janë shumë me konservatore së limitet rregullatore. Këto limite monitorohen dhe respektohen me frekuencë ditore. Këto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës që nuk janë të emëruara në valutën funksionale të Bankës. Kurset e këmbimit për monedhat kryesore janë si më poshtë:

	2025	2024
EUR:LEK	96.77	98.15
USD:LEK	82.46	94.26

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare më 31 dhjetor 2025 dhe 2024 sipas valutave të huaja në të cilat ato janë emëruar jepet si më poshtë:

31 dhjetor 2025	LEK	USD	EUR	Të tjera	Totali
Aktivet					
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	3,581,740	667,557	9,639,187	429,024	14,317,508
Depozita dhe llogari me bankat	-	872,212	5,450,764	287,052	6,610,028
Letra me vlerë investimi	27,721,381	1,756,219	6,915,849	974,233	37,367,682
Hua dhe paradhënie për klientët	26,076,512	40,266	32,770,278	-	58,887,056
Tatim fitim i parapaguar	8,174	-	-	-	8,174
Aktive të tjera	62,750	2,103	294,772	2,627	362,252
Totali	57,450,557	3,338,357	55,070,850	1,692,936	117,552,700
Detyrimet					
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	10,295,120	-	-	-	10,295,120
Detyrime bankave e institucioneve financiare	4,685,811	150,865	4,928,923	33,093	9,798,692
Detyrime ndaj klientëve	37,595,834	2,930,607	44,962,906	1,543,722	87,033,069
Detyrime për qira	76,788	1,695	702,107	-	780,590
Detyrime të tjera	264,654	33,510	140,940	141	439,245
Borxhi i varur	-	-	2,006,593	-	2,006,593
Totali	52,918,207	3,116,677	52,741,469	1,576,956	110,353,309
Angazhime e këmbime spot, neto	294,696	(332,530)	(13,064)	50,056	(842)
Pozicioni neto	4,827,046	(110,850)	2,316,317	166,036	7,198,549

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)***Rreziku i monedhës së huaj (vazhdim)*

31 dhjetor 2024	LEK	USD	EUR	Të tjerë	Totali
Aktivët					
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	3,419,288	600,097	6,435,415	443,972	10,898,772
Depozita dhe llogari me bankat Letra me vlerë investimi	100,859	353,537	6,970,056	239,390	7,663,842
	25,232,754	1,506,371	6,990,946	1,107,495	34,837,566
Hua dhe paradhënie për klientet	20,754,735	50,348	29,563,514	-	50,368,597
Aktive të tjera	54,247	1,543	127,968	5,919	189,677
Total	49,561,883	2,511,896	50,087,899	1,796,776	103,958,454
Detyrimet					
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	9,593,294	-	-	-	9,593,294
Detyrime bankave e institucioneve financiare	2,481,086	59,697	4,373,552	33,680	6,948,015
Detyrime ndaj klientëve	33,259,140	2,510,978	40,352,384	1,623,341	77,745,843
Detyrime për qira	53,643	4,362	711,950	-	769,955
Detyrime të tjera	337,070	224,678	223,808	964	786,520
Borxhi i varur	-	-	1,542,818	-	1,542,818
Detyrime tatimore	18,291	-	-	-	18,291
Totali	45,742,524	2,799,715	47,204,512	1,657,985	97,404,736
Angazhime e kembime spot, neto	128,355	219,271	(268,931)	(77,883)	812
Pozicioni neto	3,947,714	(68,548)	2,614,456	60,908	6,554,530

Në çdo rast, pozicionet e brendshme të hapura në valutë të Bankës janë të kujdesshme dhe mjaft poshtë kufijve rregullatore.

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është përcaktuar si ndjeshmëria e fitimit dhe kapitalit të Bankës ndaj ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Rreziku i normës së interesit në librat e Bankës i referohet rrezikut aktual dhe të pritshëm në kapitalin dhe fitimet e Bankës si pasojë e ndryshimit të pafavorshëm në normat e interesit. Në rast të ndryshimit të interesit, ndryshojnë vlera aktuale dhe koha e flukseve të pritshme.

Banka përpiqet ta zbusë këtë rrezik duke mbushur plotësisht hendekun midis aktiveve dhe detyrimeve, në mënyrë që edhe aktivet edhe detyrimet, të maturohen dhe të ripërcaktohet çmimi njëkohësisht. Kjo ndihmon që Banka të mos jetë tepër e ndjeshme ndaj ndryshimeve të normave të interesit. Funkcioni i monitorimit dhe kontrollit për rreziqet e normës së interesit të Bankës është i KMAP. Politika e KMAP e Bankës përmban sete limitesh, metodash matjeje dhe raporte mujore që përgatiten dhe analizohen.

Hendeku i normave të interesit më 31 dhjetor 2025 është analizuar më poshtë. Më 31 dhjetor 2025 shumica e aktiveve afat-shkurtra financiare të Bankës dhe detyrimeve, përveç portofolit të kredisë, mbartin norma fikse interesi.

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

i. Informacion për normat e interesit

Normat mesatare të ponderuara të interesit të kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës janë paraqitur më poshtë:

	Normat mesatare të ponderuara							
	LEK		USD		EUR		Të tjera	
	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024
Aktivet:								
Rezerva e detyrueshme	2.50%	2.75%	P/A	P/A	P/A	P/A	P/A	P/A
Depozita dhe llogaritë me bankat	3.70%	2.83%	P/A	P/A	1.64%	2.63%	P/A	P/A
Letrat me vlerë të investimeve	5.19%	5.17%	3.75%	3.92%	3.29%	3.75%	3.84%	3.74%
Hua dhe paradhënie për klientët	7.67%	7.95%	6.67%	6.93%	5.66%	5.91%	P/A	P/A
Detyrimet:								
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	2.87%	3.50%	2.00%	2.50%	2.81%	2.94%	P/A	P/A
Detyrime ndaj klientëve	2.75%	2.93%	1.55%	1.87%	1.72%	1.84%	0.69%	1.01%
Repo	2.54%	2.80%	P/A	P/A	P/A	P/A	P/A	P/A
Kredi nga qeveria	P/A	P/A	P/A	P/A	0.20%	0.20%	P/A	P/A
Detyrime për qira	8.43%	8.67%	7.25%	7.25%	7.73%	7.66%	P/A	P/A
Borxhi i varur	P/A	P/A	P/A	P/A	4.92%	3.86%	P/A	P/A

ii. Analiza e ndryshimit të normës së interesit

Tabela e mëposhtme paraqet datat e ndryshimit të normës së interesit të aktiveve dhe detyrimeve të Bankës. Aktivet dhe detyrimet me norma interesi të ndryshueshme janë raportuar deri në datën tjetër të ndryshimit të normës së interesit.

Aktivët dhe detyrimet me norma fikse janë raportuar sipas datave të caktuara të pagesës së principalit.

Union Bank sh.a

Shënime për pasqyrat financiare të vecanta me dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

	Deri në 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit	Që nuk mbartin interes	Totali
31 dhjetor 2025							
Aktivët							
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	1,810,249	-	-	-	-	12,507,259	14,317,508
Depozita dhe llogari me bankat	5,540,790	-	-	-	-	1,069,238	6,610,028
Investime në letra me vlerë	1,927,880	2,539,938	1,294,773	1,859,065	29,833,466	(87,440)	37,367,682
Hua dhe paradhënie për klientet	3,487,084	7,743,401	14,053,397	27,946,396	8,384,990	(2,728,212)	58,887,056
Tatim fitim i parapaguar	-	-	-	-	-	8,174	8,174
Aktive të tjera	667	1,346	2,050	4,214	26,768	327,207	362,252
Totali	12,766,670	10,284,685	15,350,220	29,809,675	38,245,224	11,096,226	117,552,700
Detyrimet							
Detyrime ndaj Bankës qendrore	10,295,120	-	-	-	-	-	10,295,120
Detyrime bankave e institucioneve financiare	2,625,255	828,076	621,803	690,865	1,037,525	3,995,168	9,798,692
Detyrime ndaj klientëve	11,034,130	5,267,203	6,507,989	18,601,214	35,550,652	10,071,881	87,033,069
Detyrime për qira	14,443	29,168	44,200	97,511	595,268	-	780,590
Detyrime të tjera	577	577	577	1,155	4,050	432,309	439,245
Borxhi i varur	-	193,540	483,850	-	1,306,395	22,808	2,006,593
Totali	23,969,525	6,318,564	7,658,419	19,390,745	38,493,890	14,522,166	110,353,309
Hendeku	(11,202,855)	3,966,121	7,691,801	10,418,930	(248,666)	(3,425,940)	7,199,391
Hendeku i akumuluar	(11,202,855)	(7,236,734)	455,067	10,873,997	10,625,331	7,199,391	-

Union Bank sh.a**Shënime për pasqyrat financiare të vecanta me dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025***(Të gjitha vlerat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)***38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)***Rreziku i normës së interesit (vazhdim)*

31 dhjetor 2024	Deri në 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit	Që nuk mbartin interes	Totali
Aktivët							
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	1,413,007	-	-	-	-	9,485,765	10,898,772
Depozita dhe llogari me bankat	5,647,747	-	-	-	-	2,016,095	7,663,842
Investime në letra me vlerë	1,179,601	3,945,224	1,649,199	2,604,966	25,532,497	(73,921)	34,837,566
Hua dhe paradhënie për klientet	3,199,631	7,429,194	11,581,241	23,326,112	7,404,851	(2,572,432)	50,368,597
Aktive të tjera	630	1,270	1,935	3,976	35,545	146,321	189,677
Totali	11,440,616	11,375,688	13,232,375	25,935,054	32,972,893	9,001,828	103,958,454
Detyrimet							
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	9,593,294	-	-	-	-	-	9,593,294
Detyrime bankave e institucioneve financiare	712,272	224,203	309,220	1,169,943	1,188,375	3,344,002	6,948,015
Detyrime ndaj klientëve	9,738,639	4,898,221	5,822,468	15,048,366	34,100,002	8,138,147	77,745,843
Detyrime për qira	11,762	23,597	44,111	74,312	616,173	-	769,955
Detyrime të tjera	2,230	1,115	1,115	1,395	6,451	774,214	786,520
Borxhi i varur	-	-	-	-	1,521,325	21,493	1,542,818
Detyrime tatimore	-	-	-	-	-	18,291	18,291
Totali	20,058,197	5,147,136	6,176,914	16,294,016	37,432,326	12,296,147	97,404,736
Hendeku	(8,617,581)	6,228,552	7,055,461	9,641,038	(4,459,433)	(3,294,319)	6,553,718
Hendeku i akumuluar	(8,617,581)	(2,389,029)	4,666,432	14,307,470	9,848,037	6,553,718	-

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**38.3 Rreziku i tregut (vazhdim)***Analiza e ndjeshmërisë*

Analiza e ndjeshmërisë më poshtë është kryer bazuar në ekspozimet ndaj interesit në datën e raportimit dhe ndryshimi i përcaktuar që do të ndodhte në fillim të vitit financiar është mbajtur konstant përgjatë periudhës raportuese. Më poshtë jepet një përcaktim i efekteve që ndryshimet në normat e interesit kanë në fitimin neto dhe kapital, duke supozuar së gjithë variablat e tjera janë mbajtur të pandryshuara:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Norma e interesit rritet me 2%	212,507	196,961
Norma e interesit rritet me 1.5%	159,380	147,721
Norma e interesit rritet me 1%	106,253	98,480
Norma e interesit ulet me 1%	(106,253)	(98,480)
Norma e interesit ulet me 1.5%	(159,380)	(147,721)
Norma e interesit ulet me 2%	(212,507)	(196,961)

Analiza e ndjeshmërisë të ndryshimit të kurseve të këmbimit është pjesë e raportimit të rrezikut të kurseve të këmbimit tek drejtuesit dhe paraqet vlerësimin e Drejtimit për ndryshimet e mundshme në kurset e këmbimit bazuar mbi informacionin e vlefshëm pas përgatitjes së bilancit. Analiza e ndjeshmërisë përfshin zërat kryesore monetare në monedhë të huaj dhe rregullon vlerat e konvertuara në fund të periudhës për ndryshimet në kurset e këmbimit të përshkruara më sipër.

Më poshtë jepet një përcaktim i efekteve që ndryshimi i kurseve të këmbimit ka në fitimin neto, duke supozuar së të gjitha variablat e tjera janë mbajtur të pandryshuara:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Lek zhvlerësohet kundrejt USD me 5%	(5,542)	(3,427)
Lek forcohet kundrejt USD me 5%	5,542	3,427
Lek zhvlerësohet kundrejt EUR me 5%	115,816	130,723
Lek forcohet kundrejt EUR me 5%	(115,816)	(130,723)
Lek zhvlerësohet kundrejt monedhave të tjera me 5%	8,302	3,045
Lek forcohet kundrejt monedhave të tjera me 5%	(8,302)	(3,045)

38.4 Rreziku operacional

Rreziku Operacional ndeshet përgjatë lëvrimit të të gjitha produkteve dhe shërbimeve bankare dhe shfaqet në baza ditore ndërsa transaksionet procesohen. Ai mund të rezultojë gjithashtu nga sisteme të papërshtatshme informacioni, dështime teknologjike, dëmtimit të kontrolleve të brendshme, dhe mashtrimeve apo ngjarjeve katastrofike të paparashikuara.

Për të menaxhuar rrezikun operacional, Banka ka hartuar një kuadër gjithëpërfshirës që përfshin përkufizime të qarta të rrezikut operacional në të gjithë organizatën, së bashku me një filozofi të vetë-vlerësimit të proceseve të biznesit. Gjithashtu ka zhvilluar dhe monitoron në mënyrë aktive performancën e treguesve kryesorë të rrezikut, si të brendshëm ashtu edhe rregullatorë. Eventet e rrezikut operacional analizohen dhe monitorohen me kujdes, në kuadër të ekspozimit kundrejt rreziqeve të paparashikuara ose dështimeve të mundshme të kontrolleve.

Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Rreziqeve të Tjera (KRORT) i Bankës monitoron periodikisht rastet e humbjeve operationale dhe ngjarjeve të rrezikut operacional, duke u fokusuar në identifikimin e shkaqeve rrënjësore të tyre, përmirësimin e proceseve ekzistuese me qëllim e humbjeve operationale dhe dhënien e zgjidhjeve rezervë për mbrojtjen nga rreziku për ato aktivitete që janë subjekt i rrezikut operacional.

Përveç kësaj, Banka ka krijuar Komitetin e Përputhshmërisë, i cili trajton periodikisht kërkesat dhe çështjet që lidhen me përputhshmërinë.

Provigjonet për riskun operacional janë përfshirë nën Provigjone për risk dhe shpenzime nën Detyrime të tjera.

38. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

38.5 Rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (“ESG”)

Rreziku ESG përfaqëson mundësinë e pësimit të humbjeve, kostove shtesë ose mosrealizimit të të ardhurave të pritshme për shkak të ekspozimit ndaj faktorëve mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes. Faktorët aktualë ose të ardhshëm ESG mund të ndikojnë në performancën financiare të Bankës, reputacionin e saj dhe marrëdhëniet e saj me palët e treta, duke përfshirë investitorët, klientët dhe autoritetet rregullatore.

Rreziqet që rrjedhin nga ndryshimet klimatike dhe faktorët mjedisorë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme. Si një kanal për qarkullimin e kapitalit, sistemi bankar luan një rol kyç në tranzicionin drejt një ekonomie më të qëndrueshme. Në këtë kontekst, si ndikimet klimatike ashtu edhe tranzicioni drejt aktiviteteve të qëndrueshme përbëjnë një burim rreziku për Bankën.

Është e rëndësishme të theksohet se kjo fazë zhvillimi nuk është specifike vetëm për Bankën, por pasqyron një realitet më të gjerë në të gjithë sistemin bankar, i cili aktualisht është në fazat e hershme të ndërtimit dhe konsolidimit të një kuadri për menaxhimin e rrezikut ESG. Fillimisht, Banka është e përqendruar në identifikimin e rreziqeve materiale dhe, mbi këtë bazë, vlerësimin e ndikimit të tyre të mundshëm në modelin e biznesit. Më pas, strukturat e saj të brendshme pritet të përshtaten për të menaxhuar dhe zbutur këto rreziqe duke integruar dimensionin ESG në të gjitha kategoritë e rreziqeve të Bankës, siç janë rreziqet kreditore, të tregut, operacionale, etj. Banka ka ndërmarrë hapa konkretë drejt përfshirjes së rrezikut ESG në procesin e kreditimit, duke synuar ta zgjerojë gradualisht këtë proces edhe në kategori të tjera të rreziqeve, përmes zgjerimit të Kuadrit të Oreksit për Rrezik (RAF) sipas një plani veprimi 1-3-vjeçar. Ky plan bazohet në Udhëzuesin mbi Rreziqet Financiare të Lidhura me Klimën dhe Mjedisin, të miratuar nga autoriteti mbikëqyrës.

39. PARAQITJA DHE VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË (VAZHDIM)

Hua dhe paradhëniet për klientet dhe institucionet financiare

Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve dhënë klientëve dhe institucioneve financiare vlerësohet duke përdorur teknika të skontimit të flukseve të arkëtimeve, duke aplikuar norma që ofrohen për kredi për maturitete të ngjashme sipas produkteve apo klientëve. Vlera e drejtë e overdrafteve përafrojnë me vlerën e tyre kontabël.

Investime në letra me vlerë

Letrat me vlerë të investimit përfshijnë Bono Thesari dhe Obligacione të cilat janë blerë me qëllimin për t'u mbajtur deri në maturim. Përderisa nuk ekziston një treg aktiv për letrat me vlerë të denominuara në lekë, vlera e tyre e drejtë është përcaktuar duke përdorur metoda të ndryshme vlerësimi. Për llogaritjen e vlerës së drejtë të Bonove të Thesarit, zbatohet metoda e skontimit të principalit në maturim, duke qenë se këto janë instrumente me kupon zero; prandaj, vetëm principalit skontohet duke përdorur yield-in aktual të tregut. Për Obligacionet e denominuara në Lek, përdoret metoda e interpolimit të kurbës së normës së interesit. Llogaritja e yield-it merr në konsideratë rezultatet më të fundit të ankandit për letrat me vlerë të emetuara në maturimet e tyre përkatëse (siç publikohen nga Banka e Shqipërisë). Yield-i që rezulton përdoret më pas për të përcaktuar çmimin tregues të secilës letër me vlerë në portofol.

Obligacionet e denominuara në monedhë të huaj që kuotohen në tregje aktive përfshihen në Nivelin 1 të hierarkisë së vlerës së drejtë, ndërsa ato letra me vlerë për të cilat janë përdorur të dhëna të vëzhgueshme të tregut për të përcaktuar vlerën e tyre të drejtë klasifikohen në Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë.

Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare dhe klientëve

Vlera e drejtë e depozitave nga bankat dhe klientët vlerësohet duke përdorur teknikën e skontimit të fluksit të parasë duke përdorur normat e ofruara për depozita me maturime dhe kushte të njëjta. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme me kërkesë është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

40. MENAXHIMI I KAPITALIT

Kapitali Rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur, përveç masave të tjera, rregulla dhe përqindje të vendosura nga rregullatori Shqiptar, Banka e Shqipërisë, e cila në mënyrë përfundimtare përcakton kapitalin statutor që duhet për të përforcuar biznesin. Rregullorja "Mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit" është lëshuar duke u mbështetur në ligjin nr. 8269 datë 23.12.1997 "Ligji për Bankën e Shqipërisë", dhe atij nr. 8365 datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Raporti i Mjaftueshmerise së Kapitalit

Duke nisur më 1 prill 2015, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) është ajo pjesë e kapitalit rregullator ndaj ekspozimeve të përgjithshme të ponderuara me rrezikun, e shprehur në përqindje. Ky raport duhet jetë jo më i vogël së 12%.

Ekspozimet e përgjithshme të ponderuara me rrezikun.

Ekspozimet e përgjithshme të ponderuara me rrezikun llogariten si shuma e të mëposhtme:

- Ekspozimet e ponderuara me rrezik për mbulimin e rrezikut të kredisë dhe kundërpatisë, në të cilin ekspozimet brenda dhe jashtë bilancit janë ponderuar bazuar në metodën standarde të rregullores së Bankës së Shqipërisë mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit. Sipas kësaj metode, të gjitha ekspozimet dhe ekspozimet e mundshme grupohen në disa kategori të caktuara ekspozimi dhe brenda tyre grupohen në grupe me të vogla sipas rrezikut të lidhur me to.
- Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun e tregut
- Kërkesa për kapital për të mbuluar rrezikun operacional, duke zbatuar metodën e treguesit të thjeshtë

40. MENAXHIMI I KAPITALIT (VAZHDIM)

Tabela e mëposhtme tregon koeficientët e mjaftueshmërisë së kapitalit në fundvitet:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Ekspozimet e përgjithshme të ponderuar me riskun	64,691,101	55,944,798
Kapitali rregullator	11,677,382	10,019,953
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	18.05%	17.91%

Politika e Bankës është që të mbajë një bazë optimale kapitali në mënyrë që të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit dhe të ruajë konfidencën e tregut. Ndikimi i nivelit të kapitalit në fitimin e ardhshëm aksionar njihet dhe pranohet dhe Banka njeh dhe pranon nevojën për të mbajtur një ekuilibër ndërmjet fitimit të lartë që mund të jetë i mundur me më shumë manovrim brenda limiteve rregullatore dhe prudenciale, si dhe avantazheve dhe sigurisë që përballohet me një pozicion të shëndoshë kapitali.

Banka vlerëson dhe monitoron kërkesat e kapitalit referuar Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (ICAAP), duke qenë në përputhje me udhëzimin përkatës të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë përmes vendimit nr. 41, datë 5.6.2019. Sipas kërkesave të tilla, raporti i brendshëm i synuar për shkallën e mjaftueshmërisë së kapitalit është vendosur nga Bordi në 12.95%.

Për më tepër, Banka zbaton dhe është në përputhje me rregulloren për masat makroprudenciale, të miratuar me vendimin nr. 41 datë 5.6.2019 nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Banka i përmbahet vendimit të komunikuar nga Guvernatori dhe ka mbajtur raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit në përputhje me raportin e Shtesave të kërkuara nga kuadri aktual makroprudencial, i cili për vitin 2025 kishte qenë +3% mbi nivelin e ICAAP.

Për sa i përket kërkesave për MREL, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, Banka është kualifikuar për të mos zbatuar këto kërkesa, duke marrë parasysh pozicionin e saj në treg dhe produktet dhe shërbimet që ofron.

Banka monitoron të gjitha kërkesat e vendosura nga rregullatori për kapital gjatë gjithë periudhës dhe parashikon nevojat e ardhshme në mënyrë të vazhdueshme.

41. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Pas datës së raportimit, nuk kanë ndodhur ngjarje që do të kërkonin rregullime dhe shënime shtesë në pasqyrat financiare të veçanta.

